

BANKA E SHQIPERISË

**DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT DHE I STATISTIKËS**

Sektori i Statistikave Monetare dhe Financiare

**METODIKA E
STATISTIKAVE MONETARE
DHE FINANCIARE**

Korrik, 2003

PËRMBAJTJA:

| | |
|--|----------|
| PËRMBAJTJA: | 2 |
| 1. ÇFARË JANË STATISTIKAT MONETARE DHE FINANCIARE | 4 |
| 2. MBI ÇFARË MBËSHTETEN STATISTIKAT MONETARE DHE FINANCIARE; METODOLOGJIA E HARTIMIT; KONCEPTET BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHEN | 6 |
| 2.1 NJËSITË INSTITUCIONALE DHE SEKTORËT E EKONOMISË | 8 |
| 2.1.1 <i>Njësitë institucionale</i> | 8 |
| 2.1.2 <i>Rezidentët (sektorët e brendshëm) dhe jorezidentët (pjesa tjetër e botës)</i> | 11 |
| 2.1.2.1 <i>Rezidenca</i> | 11 |
| 2.1.2.2 <i>Territori ekonomik</i> | 11 |
| 2.1.2.3 <i>Qendra e interesit ekonomik</i> | 12 |
| 2.1.2.4 <i>Raste të veçanta</i> | 12 |
| 2.1.3 <i>Sektorët e ekonomisë</i> | 13 |
| 2.2 SEKTORËT E EKONOMISË; PESË SEKTORË (SNA) | 15 |
| 2.2.1 <i>Korporatat Financiare</i> | 15 |
| 2.2.2 <i>Qeveria</i> | 16 |
| 2.2.2.1 <i>Qeveria Qendrore</i> | 17 |
| 2.2.2.2 <i>Qeveria Lokale dhe Rajonale (Federale)</i> | 17 |
| 2.2.2.3 <i>Sigurimi Shoqëror (i përfshirë ose jo në sektorët e tjerë)</i> | 18 |
| 2.2.3 <i>Korporatat Jofinanciare</i> | 18 |
| 2.2.3.1 <i>Korporatat Jofinanciare Publike</i> | 18 |
| 2.2.3.2 <i>Korporatat e Tjera Jofinanciare</i> | 18 |
| 2.2.4 <i>Ekonomitë familjare (Individët)</i> | 19 |
| 2.2.5 <i>Institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë ekonomive familjare</i> | 20 |
| 2.2.6 <i>Rigrupimi në statistikat monetare dhe financiare</i> | 21 |
| 2.3 NËNSEKTORËT E KORPORATAVE FINANCIARE | 21 |
| 2.3.1 <i>Pesë nënsektorë (SNA)</i> | 22 |
| 2.3.1.1 <i>Banka Qendrore</i> | 22 |
| 2.3.1.2 <i>Korporatat e Tjera Depozituese</i> | 24 |
| 2.3.1.3 <i>Ndërmjetës të Tjerë Financiarë (duke përfshirë Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e pensionit)</i> | 27 |
| 2.3.1.4 <i>Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit</i> | 31 |
| 2.3.1.5 <i>Ndihmësit Financiarë</i> | 32 |
| 2.3.2 <i>Përkufizimi kombëtar i parasë së gjerë: koncept kyç për identifikimin e korporatave depozituese</i> | 34 |
| 2.4 MJETET DHE DETYRIMET FINANCIARE; VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM | 35 |
| 2.4.1 <i>Karakteristikat e instrumenteve financiare</i> | 35 |
| 2.4.1.1 <i>Mjetet financiare të SNA</i> | 35 |
| 2.4.1.2 <i>Transaksionet financiare</i> | 38 |
| 2.4.2 <i>Karakteristikat e instrumenteve financiare</i> | 39 |
| 2.4.2.1 <i>Matrica e karakteristikave të instrumenteve financiare</i> | 39 |
| 2.4.2.2 <i>Tregtueshmëria dhe transferueshmëria</i> | 40 |
| 2.4.2.3 <i>Emërtimi i instrumentit</i> | 42 |
| 2.4.2.4 <i>Maturimi dhe kohëzgjatja</i> | 42 |
| 2.4.2.5 <i>Ripagimi dhe modeli rrjedhës</i> | 42 |
| 2.4.2.6 <i>Kushtet speciale</i> | 43 |
| 2.5 MJETET DHE DETYRIMET; KATEGORITË | 45 |
| 2.5.1 <i>Ari Monetar dhe SDR</i> | 45 |
| 2.5.2 <i>Monedha dhe depozitat</i> | 45 |
| 2.5.3 <i>Letrat me vlerë përveç aksioneve</i> | 47 |
| 2.5.4 <i>Huatë</i> | 48 |
| 2.5.5 <i>Aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit</i> | 48 |
| 2.5.6 <i>Derivatet financiare</i> | 49 |
| 2.5.7 <i>Llogari të tjera të arkëtueshme ose të pagueshme</i> | 50 |
| 2.5.8 <i>Mjetet jofinanciare</i> | 50 |
| 2.5.9 <i>Mjetet dhe detyrimet; raste të veçanta</i> | 51 |
| 2.5.9.1 <i>Marrëveshjet e riblerjes</i> | 51 |
| 2.5.9.2 <i>Huadhëniet e letrave me vlerë</i> | 51 |
| 2.5.9.3 <i>Swaps-et e arit</i> | 52 |

| | |
|---|------------|
| 2.5.9.4 Titullizimi..... | 52 |
| 2.5.9.5 Transferimi (Defeasance) dhe transferimi në substancë | 53 |
| 2.6 GJENDJET, FLUKSET DHE RREGULLAT E KONTABILIZIMIT; KONCEPTET KYÇE..... | 54 |
| 2.6.1 Gjendjet dhe flukset financiare | 54 |
| 2.6.2 Vlerësimi i mjeteve financiare dhe i detyrimeve..... | 55 |
| 2.6.3 Koha e regjistrimit të transaksioneve..... | 56 |
| 2.6.4 Agregimi, Konsolidimi, Netimi | 57 |
| 2.7 AGREGATËT MONETARË..... | 60 |
| 2.7.1 Tre dimensione të agregatëve monetarë..... | 60 |
| 2.7.3 Agregatë të tjerë..... | 64 |
| 3. STATISTIKAT MONETARE; HALLKAT PËRBËRËSE | 68 |
| 3.1 BILANCI SEKTORIAL..... | 69 |
| 3.2 PARAQITJET E KORPORATAVE FINANCIARE..... | 69 |
| 3.3 LIDHJA MIDIS SISTEMEVE STATISTIKORE MAKROEKONOMIKE..... | 71 |
| ANEKSE PER TABELAT E STATISTKAVE MONETARE..... | 72 |
| ANEKS 1: BILANCI SEKTORIAL – BANKA E SHQIPËRISË | 73 |
| ANEKS 2 : BILANCI SEKTORIAL – BANKAT PARA DEPOZITUESE..... | 81 |
| ANEKS 3 : BILANCI SEKTORIAL – SHOQËRITË E KURSIM -KREDITIT | 91 |
| ANEKS 4: BILANCI SEKTORIAL – KORPORATAT E TJERA DEPOZITUESE | 93 |
| ANEKS 5: PARAQITJA E BANKËS SË SHQIPËRISË..... | 95 |
| ANEKS 6: PARAQITJA E KORPORATAVE TË TJERA DEPOZITUESE..... | 97 |
| ANEKS 7 : PARAQITJA E KORPORATAVE DEPOZITUESE..... | 100 |
| LITERATURA: | 103 |

1. Çfarë janë statistikat monetare dhe financiare.

“Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare” ka për qëllim të përshkruajë konceptet, parimet dhe standardet për hartimin dhe leximin e statistikave monetare dhe financiare. Gjithashtu duke qenë se si standard në hartimin e saj shërben “*Manuali mbi Statistikat Monetare dhe Financiare*” i Fondit Monetar Ndërkombëtar, edicioni i vitit 2000, ajo shërben njëkohësisht për leximin dhe për krahasimin e të dhënave të statistikave monetare dhe financiare në mbarë botën.

Më poshtë në material, për lehtësi të shprehuri, “Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare” është quajtur shkurtimisht “Metodika”.

Statistikat monetare dhe financiare përbëhen nga një grup pasqyrash të cilat kanë për qëllim të tregojnë marrëdhëniet e sistemit bankar dhe financiar vendas me ekonominë e brendshme dhe me pjesën tjetër të botës.

Këto marrëdhënie tregohen nëpërmjet paraqitjes së flukseve financiare ndërmjet të gjithë sektorëve të një ekonomie dhe pozicioneve korresponduese në mjetet dhe detyrimet financiare.

Flukset financiare më tej detajohen sipas origjinës së tyre, në “*Transaksione*”, “*Rivlerësime*”, dhe “*Ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve dhe të detyrimeve*”.

Në Shqipëri, deri tani janë trajtuar vetëm statistikat monetare, që do të thotë statistikat e institucioneve që krijojnë para, të cilat përbëhen nga *Banka Qendrore* dhe *Korporatat e Tjera Depozituese*.

Statistikat Monetare dhe Financiare japin informacion edhe për tregues të tjerë të ekonomisë, si për shembull *Agregatët Monetarë M1, M2, M3, Paraja në Qarkullim, Kredia për ekonominë* (e cila nuk trajtohet plotësisht nga Statistikat Monetare pasi mungon pjesa e kredisë që financohet nga institucione të tjera financiare të papërfshira), *Mjetet Valutore Neto*, etj.

Statistikat Monetare dhe Financiare përbëhen nga dy grupe tabelash të cilat përbëjnë edhe hallkat e Statistikave Monetare: *Bilancet Sektoriale* dhe *Paraqitjet Monetare*.

Bilanci Sektorial, i cili përbën dhe hallkën e parë të kompilimit të Statistikave Monetare, është një pasqyrë, e cila tregon në mënyrë të detajuar gjendjet dhe flukset për të gjitha kategoritë e mjeteve dhe detyrimeve të çdo sektori në sistemin financiar.

Në Paraqitjen Monetare, të dhënat nga Bilancet Sektoriale të një ose disa nënsektorëve të korporatave financiare, kombinohen në kategori më të agreguara mjetesh dhe detyrimesh të cilat përdoren kryesisht për qëllime analize.

Paraqitjet monetare përbëhen nga:

- Tre paraqitje që mbulojnë nënsektorët e korporatave financiare – *Paraqitja e Bankës Qendrore, Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese* dhe *Paraqitja e*

*Korporatave të Tjera Financiare*¹. Paraqitja e Bankës Qendrore përmban të dhëna mbi të gjithë komponentët e Bazës Monetare.

- *Paraqitja e Korporatave Depozituese*, në të cilën konsolidohen *Paraqitja e Bankës Qendrore* dhe *Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese*. Paraqitja e Korporatave Depozituese përmban të dhëna mbi të gjithë detyrimet e Korporatave Depozituese që përfshihen në Paranë e Gjerë. Identiteti i bilancit në Paraqitjen Monetare të Korporatave Depozituese jep një lidhje të drejtpërdrejtë midis ofertës së parasë dhe pretendimeve të Korporatave Depozituese mbi sektorët rezidentë dhe jorezidentë të ekonomisë.
- *Paraqitja e Korporatave Financiare*, e cila përmban të dhënat e konsoliduara për të gjithë sektorin financiar. Në të konsolidohen *Paraqitja e Korporatave Depozituese* dhe *Paraqitja e Korporatave të Tjera Financiare*. Paraqitja e Korporatave Financiare është paraqitja më e gjerë përse i përket mbulimit institucional. Të dhënat e Paraqitjes së Korporatave Financiare janë veçanërisht të përdorshme për analizën e pretendimeve të sektorit financiar (kreditë) ndaj sektorëve të ekonomisë dhe jorezidentëve.

¹ Kjo e fundit nuk përfshihet në Statistikat Monetare në Shqipëri pasi Sektori i Korporatave të Tjera Financiare aktualisht nuk mbulohet.

2. Mbi çfarë mbështeten statistikat monetare dhe financiare; metodologjia e hartimit; konceptet bazë mbi të cilat ndërtohen.

Ky kapitull shpjegon parimet dhe konceptet mbi të cilat ndërtohen statistikat monetare dhe financiare. Më poshtë do të jepen më me hollësi aspektet e veçanta të tyre.

- Në pjesën e parë, do të trajtohen konceptet bazë mbi të cilat fillon përpunimi i statistikave monetare dhe financiare: përkufizimi i *njësive institucionale*, përkufizimi i rezidencës, dhe një përshkrim i shkurtër i grupimit të sektorëve sipas standardeve të SNA 1993.
- Në përkufizimin e Agregatëve Monetarë dhe të kredisë është e nevojshme të identifikohen sektorët emetues dhe mbajtës të parasë (kredisë).
- *Sektorizimi* është gjithashtu i rëndësishëm në kompilimin e statistikave monetare dhe financiare dhe në veçanti për analizën e lëvizjes së flukseve financiare në një ekonomi.
- Sektori i *Korporatave Financiare* përmban pesë nënsektorë: (i) Banka Qendrore, (ii) Korporatat e Tjera Depozituese, (iii) Ndërmjetës të Tjerë Financiarë, duke përfshirë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit, (iv) Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit dhe (v) Ndihmësit financiarë.
- Si bazë për identifikimin e sektorit të Korporatave të Tjera Depozituese, shërben përkufizimi kombëtar i parasë së gjerë. Të gjitha ato institucione financiare që krijojnë detyrime që përfshihen në paranë e gjerë klasifikohen si Korporata të Tjera Depozituese.
- *Mjetet dhe detyrimet e sektorit të korporatave financiare* klasifikohen gjerësisht në këto kategori:
 - Ari Monetar dhe SDR.
 - Monedha dhe depozitat.
 - Letrat me vlerë përveç aksioneve.
 - Huatë.
 - Aksionet dhe instrumentet e tjerë të Kapitalit.
 - Derivatet financiare.
 - Llogari të tjera të arkëtueshme ose të pagueshme.
 - Mjetet jofinanciare.
- Klasifikim tjetër është ai sipas monedhës, në monedhë kombëtare dhe në valutë të huaj, si dhe klasifikime të tjera brenda grupeve të mësipërme. Gjithashtu, në përputhje me MMFS trajtohen edhe disa instrumente “kufi” midis kategorive.

- Statistikat monetare dhe financiare përbëhen nga *gjendjet dhe nga flukset financiare*. Në vazhdim tregohen lidhjet midis gjendjeve dhe flukseve si dhe ndarja e flukseve në elementet përbërës sipas origjinës së krijimit.
- Për regjistrimin e transaksioneve, të flukseve të tjera financiare dhe të gjendjeve (tepricave të bilancit) shpjegohen rregullat që kanë të bëjnë me vlerësimin, kontabilizimin, agregimin, konsolidimin, dhe netimin e tyre.
- Trajtohen disa çështje kyçe që kanë lidhje me *agregatet e parasë, të kredisë dhe borxhit*.
- Këtu do të shpjegohen lidhjet midis tyre dhe dimensionet baze të tyre.
- Së fundi, konceptet e shprehura në këtë metodikë do të përdoren nga Banka e Shqipërisë me qëllim të sqarimit të këtyre koncepteve për efekte të statistikave monetare dhe financiare, dhe nuk kane fuqi detyruese dhe për t'u zbatuar nga të tretët.

2.1 Njësitë institucionale dhe sektorët e ekonomisë.

Së pari jepet përkufizimi i njësive institucionale dhe grupimi i tyre në sektorë sipas standardeve të statistikave monetare dhe financiare.

Së dyti dallohen njësitë rezidente nga ato jorezidente sipas koncepteve të *territorit ekonomik* dhe *qendrës së interesit ekonomik*, si dhe përshkruhen disa raste të veçanta.

Më tej jepet një përshkrim i shkurtër i sektorëve rezidentë të ekonomisë.

2.1.1 Njësitë institucionale.

Përkufizimi:

Me njësi institucionale kuptojmë çdo njësi ekonomike, e cila është e aftë të zotërojë mjete, të marrë përsipër detyrime dhe të angazhohet në aktivitete ekonomike dhe në transaksione me njësi të tjera.

Sipas SNA 1993 katër karakteristikat dalluese të njësive institucionale janë:

- Është e aftë të ndryshojë pronësinë e mallrave apo të mjeteve që disponon, nëpërmjet transaksioneve me njësi të tjera institucionale.
- Është e aftë të marrë vendime ekonomike dhe të angazhohet në aktivitete ekonomike, për të cilat mban përgjegjësi dhe jep llogari sipas ligjit.
- Është e aftë të marrë përsipër detyrime për llogari të saj, të angazhohet në marrëveshje për të ardhmen dhe të hyjë në kontratë.
- Për njësinë ekziston, ose do të ishte e mundur dhe do të kishte kuptim nga pikëpamja ekonomike dhe ligjore, të përpunohej një grup llogarish, përfshirë bilancin kontabël.

Njësitë institucionale ndahen në:

- *Ekonomi familjare*, të cilat përbëhen nga individë, familje ose grupe të tjera, të cilat ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet. Ekonomitë familjare mund të angazhohen në prodhim.
- *Njësi ligjore ose sociale* të vetëangazhuara në aktivitete ekonomike dhe të njohura ligjërisht ose nga shoqëria si subjekte që ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga njësitë që i kanë në pronësi ose i kontrollojnë ato.

Njësitë ligjore ose sociale përfshijnë korporatat, thujsekorporatat, njësitë qeveritare dhe institucionet jo me qëllim fitimi.

Korporatat janë njësi ligjore të krijuara me qëllim prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve për tregun. Ato identifikohen nga karakteristikat e mëposhtme:

- Korporata konsiderohet nga ligji si e përhershme dhe që ekziston e pavarur nga njesia që e kontrollon atë. Korporata është një njësi institucionale e ndarë nga pronarët.
- Korporata është ligjërisht përgjegjëse për veprimet e saj. Pronarët kanë detyrime të kufizuara.
- Korporatat angazhohen në aktivitete tregu dhe fitimi mund t'u shpërndahet pronarëve. Vlera e tregut e kapitalit të pronarëve mbi korporatën mund të luhatet dhe të rezultojë në fitim ose humbje kapitali për pronarët.
- Korporata mund të mbajë një pjesë të fitimit të saj për ta përdorur si kapital punues ose për çështje të tjera të vetat.

Korporatat shpesh zotërojnë aksione dhe mund të ushtrojnë kontroll të pjesëshëm ose të plotë mbi korporata të tjera. Kontrolli ekziston kur një korporatë zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave votuese ose mund të emërojë më shumë se gjysmën e drejtorëve të një korporate tjetër. Në këto raste, korporata e kontrolluar është një degë.

Thuajsekorporatat janë ndërmarrje joaksionere të cilat funksionojnë si korporata.

Që një thuajsekorporatë të ekzistojë, ajo duhet të jetë e aftë të krijojë një plan të plotë llogarish, duke përfshirë bilancin kontabël, për të dalluar thuajsekorporatën nga pronarët e saj. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me biznesin të thuajsekorporatës duhen ndarë nga mjetet dhe detyrimet e pronarëve.

Për më tepër, duhet të ekzistojë mundësia e identifikimit të flukseve të kapitalit dhe të ardhurave që shkaktohen midis thuajsekorporatës dhe pronarëve të saj.

Thuajsekorporatat përfshijnë:

- Ndërmarrje joaksionere qeveritare të angazhuara në prodhim tregu dhe që veprojnë si korporata private.
- Njësi joaksionere të krijuara nga ekonomitë familjare të angazhuara në prodhim tregtar dhe që veprojnë si korporata private
- Njësi rezidente² joaksionere në pronësi të plotë ose të pjesëshme të njësive jorezidente (duke përfshirë projektet e përbashkëta, degët, zyrat, agjencitë), të cilat angazhohen në aktivitet domethënës brenda vendit, për një kohë të gjatë ose të pacaktuar.

Njësitë qeveritare janë një lloj i veçantë njësish ligjore, që themelohen nga procese politike dhe kanë autoritet ligjor, juridik ose ekzekutiv mbi njësitë e tjera institucionale, brenda një territori të caktuar.

Funksionet kryesore të njësive qeveritare janë:

² Konceptet e rezidencës dhe jorezidencës së një njësie do të shpjegohen në vazhdim.

- Të sigurojnë mallra dhe shërbime për komunitetin ose për ekonomitë familjare, duke u angazhuar në prodhim jotregtar ose nëpërmjet transfertave dhe duke u financuar nëpërmjet taksave dhe të ardhurave të tjera
- Të rishpërndajnë të ardhurat dhe mirëqënien nëpërmjet transfertave.

Njësitë qeveritare mund të kenë nën pronësi ndërmarrje joaksionere, kryesisht të angazhuara në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve.

Këto ndërmarrje duhet të trajtohen si thuajse korporatë, nëse ato administrohen në mënyrë të ngjashme me një korporatë dhe kanë një plan të plotë llogarish, që lejon identifikimin veçmas të fitimit operativ, të kursimit, të mjeteve dhe të detyrimeve. Ndërmarrjet që nuk i plotësojnë këto kërkesa nuk trajtohen si njësi institucionale të ndara por si pjesë e njësite qeveritare.

Institucionet jo me qëllim fitimi janë njësi ligjore ose sociale të krijuara me qëllim prodhimin e mallrave dhe shërbimeve, statusi i të cilave nuk i lejon ato të jenë burim të ardhurash apo fitimi për njësitë që i themelojnë, i kontrollojnë ose i financojnë ato.

Arsyet për të cilat krijohen institucionet jo me qëllim fitimi janë:

- Të sigurojnë shërbime në përfitim të personave apo të korporatave, të cilat i kontrollojnë apo i financojnë ato.
- T'u sigurojnë mallra apo shërbime personave në nevojë për arsye bamirësie, filantropike etj.
- Të sigurojnë shërbime edukimi dhe shëndetësore kundrejt pagesës por jo për qëllim fitimi.
- Të promovojnë interesat e grupeve me influencë në biznes apo në politikë.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis institucioneve jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhim tregtar dhe institucioneve jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhim jotregtar (që pjesën më të madhe të prodhimit e japin falas ose për çmime jo të rëndësishme, ose çmime që nuk influencojnë sasinë e ofruar dhe atë të kërkuar).

Kategoria e dytë ndahet më tej në dy grupe:

- institucionet jo me qëllim fitimi të kontrolluara dhe të financuara kryesisht nga qeveria; dhe
- institucionet jo me qëllim fitimi që financohen nga burime joqeveritare.

Grupi i fundit përbën një sektor të veçantë të ekonomisë "Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë ekonomive familjare.

Institucionet jo me qëllim fitimi që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria klasifikohen në nënsektorin e qeverisë së përgjithshme.

Institucionet jo me qëllim fitimi të cilat kontrollohen nga qeveria duhet të jenë njësi ligjore që ekzistojnë të ndara nga qeveria.

Kontrolli nga qeveria do të thotë që njësitë qeveritare kanë aftësinë të përcaktojnë politikën e përgjithshme të njësisë nëpërmjet emërimit të zyrtarëve.

Institucionet jo me qëllim fitimi konsiderohen të financuara kryesisht nga qeveria, nëse qeveria i siguron fonde ose kontribute në natyrë të barabarta me 50 për qind ose më shumë të shpenzimeve të tyre.

Institucione të tilla angazhohen në kërkim dhe zhvillim në përfitim të prodhuesve si për shembull fermerët. Ato mund të kenë të bëjnë gjithashtu me vendosjen e standardeve si për shëndetin, për sigurinë, për mjedisin, për kontabilitetin, për financën, për edukimin etj. Këto institucione klasifikohen në sektorin e Qeverisë Qendrore pavarësisht nga njësitë institucionale që përfitojnë prej aktiviteteve të tyre.

Institucionet jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhim tregtar klasifikohen si korporata. Ato që kryesisht angazhohen në prodhimin e shërbimeve financiare (si për shembull shoqëritë e kursim-kreditit), klasifikohen si korporata financiare. Këto njësi ofrojnë produktet e tyre kundrejt një pagese, e cila bazohet në koston e prodhimit. Për shkak të statusit të tyre, këto institucione mund të marrin fonde edhe nëpërmjet donacioneve nga persona, nga qeveria ose nga korporatat.

2.1.2 Rezidentët (sektorët e brendshëm) dhe jorezidentët (pjesa tjetër e botës).

Ndarja midis *rezidentëve dhe jorezidentëve* është një karakteristikë kryesore e të gjithë sistemeve makrostatistikore, ku përfshihen edhe statistikat monetare dhe financiare.

Identifikimi i gjendjeve dhe i flukseve të lidhura me pretendimet dhe detyrimet ndaj jorezidentëve është i nevojshëm për matjen e borxhit të jashtëm dhe rezervës valutore. Gjithashtu, meqë agregatët monetarë përfshijnë vetëm detyrimet ndaj rezidentëve, dallimi midis rezidentëve dhe jorezidentëve është një faktor kyç.

2.1.2.1 Rezidenca.

Përcaktimi i rezidencës bazohet në konceptet e territorit ekonomik dhe qendrës së interesit ekonomik dhe është i njëjtë më atë të përdorur në edicionin e pestë të Manualit të Bilancit të Pagesave dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare SNA 1993.

Koncepti i rezidences nuk bazohet në kombësinë apo në kriterin ligjor. Për më tepër, kufijtë politikë të një vendi mund të mos jenë të përshtatshëm për qëllimet statistikore dhe është e domosdoshme të prezantohet koncepti i "*Territorit ekonomik*" të një vendi si sipërfaqja gjeografike përkatëse, në të cilën të zbatohet koncepti i rezidencës.

Thuhet që një njësi institucionale është një njësi rezidente kur ajo ka një qendër të interesit ekonomik në territorin ekonomik të vendit në fjalë.

2.1.2.2 Territori ekonomik.

Territori ekonomik i një vendi konsiston në territorin gjeografik të administruar nga qeveria në të cilin personat, mallrat dhe kapitali qarkullojnë lirisht.

Kufijtë ekonomikë të një vendi nuk bazohen gjithmonë në kufijtë fizikë ose politikë, megjithëse midis tyre ka lidhje.

Territori ekonomik i një vendi përfshin sa më poshtë:

- Hapësirën e ajrit, ujërat territoriale dhe çdo pjesë kontinentale të shtrirë në ujërat ndërkombëtare mbi të cilin vendi gëzon të drejta ekskluzive, ose mbi të cilin ka ose

pretendon të ketë të drejtën për të shfrytëzuar burimet natyrore si peshkimi, mineralet apo karburantet.

- Zona territoriale të kufizuara që ndodhen në pjesën tjetër të botës, për të cilat ekzistojnë marrëveshje formale me qeveritë e vendeve në të cilat ndodhen. Këto zona përdoren për qëllime ushtarake, diplomatike ose për qëllime të tjera.
- Zona të lira tregtare, magazina, ferma, etj, që ndodhen brenda kufijve të një vendi. Ato konsiderohen të jenë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendit në të cilin ndodhen edhe pse mund të administrohen nga njësi të huaja, ose mund të ketë kufizim në qarkullimin e mallrave dhe personave brenda dhe jashtë zonës.

Territori ekonomik i një organizate ndërkombëtare konsiston në zona të kufizuara, nën pronësi, ose të marra me qira nga organizata.

Vendi në të cilin ndodhen fizikisht këto zona, i njeh ato formalisht dhe i përjashton nga territori i tij ekonomik.

2.1.2.3 Qendra e interesit ekonomik.

Një njësi institucionale ka një qendër të interesit ekonomik brenda një vendi, kur ajo ka një seli, një vend prodhimi ose kryhen aktivitete brenda territorit ekonomik të këtij vendi, në të cilin ajo angazhohet dhe do të vazhdojë të angazhohet në aktivitete dhe transaksione ekonomike, në një shkallë të konsiderueshme.

Në shumicën e rasteve, supozohet se një njësi institucionale ka një qendër të interesit ekonomik në një vend, nëse është angazhuar apo synon të angazhohet në transaksione dhe aktivitete ekonomike, në një shkallë të konsiderueshme për një vit ose më shumë.

2.1.2.4 Raste të veçanta.

Punonjësit e organizatave ndërkombëtare janë rezidentë të ekonomive lokale në të cilat jetojnë dhe jo të zonave në të cilat punojnë.

Një ndërmarrje nën pronësi të një ose më shumë qeverive nuk është një organizatë ndërkombëtare dhe konsiderohet si rezidente e vendit në të cilin ushtron veprimtarinë.

Pronësia mbi tokën dhe mbi strukturat brenda territorit ekonomik të një vendi nuk është një kusht i mjaftueshëm për të paturit e një qendre të interesit ekonomik.

Toka dhe ndërtesat mund të përdoren për prodhim në vendin ku ato janë fizikisht dhe pronarët e tyre janë subjekte të rregullimit dhe të ligjeve të atij vendi.

Megjithatë, mund të ndodhë që pronari është rezident në një vend tjetër dhe nuk ka asnjë interes ekonomik në vendin në të cilin ai ka tokën ose ndërtesën. Në këtë rast, pronari trajtohet sikur t'ia kishte transferuar pronësinë e tij një njësie institucionale rezidente (fiktive) të vendit.

Njësi rezidente (fiktive) trajtohet si të ishte nën pronësinë e pronarit jorezident, njëlloj si në rastin e një thujse korporate.

Në këtë mënyrë, renta e paguar nga mbajtësit e tokës i jepet njësisë rezidente që nga ana tjetër ia transferon të ardhurat pronarit jorezident.

Korporatat dhe thujse korporatat kanë qendër të interesit ekonomik dhe janë rezidente të një vendi, kur ato synojnë të angazhohen në vëllim të konsiderueshëm prodhimi mallrash dhe shërbimesh, ose kanë nën pronësi tokë dhe ndërtesa (duke përfshirë të paktën një vend prodhimi) për një periudhë të pacaktuar apo të gjatë kohe.

Kriteret shtesë për të paturit e një qendre të interesit ekonomik, konsistojnë në mbajtjen e një grupi llogarish që dokumentojnë aktivitetin prodhues lokal, taksat e paguara qeverisë lokale ose ekzistencën e një pranije fizike domethënëse.

Ekonomitë familjare janë rezidente të vendeve në të cilat anëtarët kanë rezidencë të përhershme.

Vendi në të cilin anëtarët punojnë nuk është kriter për përcaktimin e rezidencës.

Anëtarët të cilët kalojnë kufijtë për të punuar mbeten rezidentë të vendeve të tyre me përjashtim të rasteve kur ata punojnë jashtë për më shumë se një vit, fitojnë të ardhura, konsumojnë, mbajnë rezidencë të rregullt jashtë dhe kthehen për periudha të shkurtra kohe në familjet e tyre.

Ndryshe ndodh për personelin ushtarak dhe diplomatik të punësuar në zona si për shembull zonat ushtarake dhe ambasadat.

Këto zona janë pjesë e territorit ekonomik të shtetit të tyre dhe punonjësit janë rezidentë, pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit të tyre.

Studentët dhe personat që kurohen jashtë shtetit trajtohen si rezidentë të ekonomive nga të cilat vijnë, pavarësisht nga kohëqëndrimi i tyre jashtë.

2.1.3 Sektorët e ekonomisë.

Një sektor është një ndarje bazë e ekonomisë, e cila grupon njësitë sipas aktivitetit të tyre parësor. Çdo sektor ka karakteristika ekonomike të cilat e dallojnë nga sektorët e tjerë.

Sektorët ndahen në nënsektorë dhe në nëndarje më të vogla, të cilat i klasifikojnë njësitë në grupe akoma më homogjene.

Në një ekonomi përfshihen pesë sektorë reciprokisht të përjashtueshëm.

- Ekonomitë familjare.
- Korporatat jofinanciare.
- Korporatat financiare.
- Qeveria e përgjithshme.
- Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë ekonomive familjare.
- Jorezidentët ose pjesa tjetër e botës, të cilët mund të kenë transaksione me këdo nga sektorët e brendshëm.

Njësitë institucionale klasifikohen në sektorë sipas aktivitetit të tyre parësor.

Aktivitet parësor është ai në të cilin përqendrohet një njësi dhe matet sipas kontributit të aktivitetit në vlerën e shtuar totale të një njësie. Aktivitetet e tjera janë aktivitete dytësore.

Njësitë institucionale nuk ndahen sipas aktivitetiteve duke shpërndarë pjesë të njësisë në sektorë të ndryshëm.

Për shembull, aktiviteti i kufizuar i Bankës Qendrore si bankë tregtare, klasifikohet nën Bankën Qendrore dhe jo tek Korporatat e Tjera Depozituese.

Identifikimi i aktivitetit parësor të ndërmjetësve financiarë mbi bazën e vlerës së shtuar mund të jetë i vështirë: ndërmjetësit mund t'i ndryshojnë aktivitetet e tyre relativisht shpejt dhe ndryshimet në normat e interesit mund të ndryshojnë vlerën e shtuar relative të aktiviteve të ndryshme. Shumë ndërmjetës angazhohen në shumë aktivitete, duke vështirësuar matjen e vlerës së shtuar të çdo shërbimi.

Si alternativë për përcaktimin e aktivitetit primar, mund të përdoret dhe vlera relative në bilancin kontabël.

Në përcaktimin e aktiviteve parësore apo dytësore merren në konsideratë vetëm shërbimet e shitura njësive të tjera institucionale.

Shërbimet që një njësi prodhon për veten e saj, quhen shërbime anësore ose ndihmëse dhe nuk janë prodhim në vetvete, por pjesë e prodhimeve dytësore apo parësore për njësitë e tjera.

Një shembull është shërbimi i mbajtjes së kontabilitetit, i cili, nëse konsumohet vetëm brenda njësisë dhe nuk u shitet njësive të tjera, konsiderohet si aktivitet ndihmës.

2.2 Sektorët e ekonomisë; pesë sektorë (SNA).

Njësitë institucionale ndryshojnë nga objektivat ekonomike, nga funksionet dhe nga sjellja, dhe sipas SNA 1993, grupohen në *sektorë* që përfshijnë njësi institucionale me karakteristika të ngjashme.

Njësitë rezidente të një ekonomie grupohen në këta sektorë:

- Korporata Financiare.
- Qeveria e Përgjithshme.
- Korporatat Jofinanciare.
- Ekonomitë Familjare.
- Instiucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë ekonomive familjare
- Jorezidentët.

2.2.1 Korporatat Financiare.

Sektori i Korporatave Financiare përfshin ndërmjetësit financiarë dhe ndihmësit financiarë.

Ndërmjetësit financiarë janë njësi që mbledhin fonde duke shkaktuar detyrime për llogari të tyre, me qëllim huadhënien ose blerjen e mjeteve financiare.

Ndërmjetësit i kanalizojnë fondet nga huadhënësit tek huamarrësit, duke ndërhyrë drejtpërdrejt në flukset financiare dhe në këtë mënyrë ato transformojnë karakteristikat e fondeve.

Ndërmjetësit transformojnë natyrën e fondeve në terma të monedhës, të maturitetit dhe të normave të interesit.

Një ndërmjetës ekspozohet ndaj rrezikut kur u shkakton detyrime njërive të cilave u jep hua. Eficienca ekonomike rritet nëpërmjet uljes së kostove të transaksionit, sigurimit të kredisë në sasinë dhe në karakteristikat e kërkuara nga kredikërkuarit dhe administrimit të një rreziku që njësitë e tjera nuk do të ishin të afta ta administrojnë.

Administrimi i rrezikut financiar kryhet nëpërmjet teknikave të ndryshme si për shembull: krijimi i portofoleve të instrumenteve me korrelacion negativ, sigurimi i mjeteve dhe i detyrimeve, vlerësimi i besueshmërisë së kredikërkuarit, mbajtja e kolateraleve dhe mbajtja e kapitalit bazë dhe rezervave në një nivel të tillë sa të mbulojnë detyrimet.

Meqenëse aktivitetet e huadhënies e huamarrjes mund të ndërmerren edhe nga njësi të tjera, si për shembull Qeveria e Përgjithshme, ndërmjetësit mund të identifikohen vetëm nga pesha relative e aktivitetit të ndërmjetësimit krahasuar me aktivitetet e tjera.

Përgjithësisht tek ndërmjetësit financiarë huadhënia/huamarrja neto është e vogël krahasuar me atë të sektorëve të tjerë, ndërsa gjendjet dhe transaksionet në mjetet financiare dhe detyrimet janë krahasimisht të mëdha, gjë që reflekton rolin e ndërmjetësimit.

Ndihmësit financiarë janë njësi që prokurojnë shërbime të specializuara të lidhura ngushtë me ndërmjetësimin, por që nuk krijojnë fonde dhe nuk japin kredi për llogari të tyre si aktivitetin e tyre parësor.

Sektori i Korporatave financiare përfshin: Banken Qendrore, Korporatat e Tjera Depozituese, Ndërmjetës të Tjerë Financiarë duke përfshirë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit, Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit dhe Ndihmësit Financiarë.

2.2.2 Qeveria.

Njësitë qeveritare janë ato njësi që si aktivitet të tyre primar kanë ushtrimin e funksioneve qeverisëse.

Kjo do të thotë se ato kanë autoritet legjislativ, gjyqësor ose ekzekutiv mbi njësitë e tjera brenda një territori të dhënë; kanë përgjegjësinë për prokurimin e mallrave komunitetit në tërësi, ose individëve në baza jo-tregtare; rishpërndajnë mirëqenien dhe të ardhurat nëpërmjet transfertave dhe i financojnë aktivitetet e tyre kryesisht me anë të taksave ose të pagesave të tjera të detyrueshme nga njësitë e sektorëve të tjerë.

Sektori i Qeverisë së Përgjithshme përfshin të gjitha njësitë qeveritare dhe institucionet jofitimprurëse që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria.

Këto të fundit ligjërisht janë njësi joqeveritare por duke qenë se u përmbahen politikave qeveritare efektivisht janë pjesë e qeverisë. Fushat në të cilat angazhohen institucionet jofitimprurëse janë për shembull kërkim zhvillimi dhe vendosja e standardeve në fusha si shëndeti, mbrojtja, mjedisi dhe arsimit.

Thuhet se njësitë qeveritare i kontrollojnë institucionet jo me qëllim fitimi, nëse kanë aftësinë për të përcaktuar politikën e tyre të përgjithshme nëpërmjet emërimit të drejtuesve apo nëpërmjet kontrollit financiar.

Njësitë qeveritare mund të implikohen në prodhimin e mallrave, të cilat jepen falas ose shiten, mbi ose nën koston e prodhimit, në varësi të qëllimeve politike.

Megjithatë nëse njësi të tilla kanë karakteristikat e mëposhtme:

- janë të organizuara në njësi më vete,
- veprojnë dhe administrohen si korporatat,
- vendosin çmime ekonomikisht të rëndësishme³,
- kanë një grup të plotë llogarish,

klasifikohen si korporata financiare ose jofinanciare, në varësi të produktit që ofrojnë.

Qeveria e përgjithshme sektorizohet në:

- qeveri qendrore,
- qeveri lokale dhe rajonale,
- sigurimet shoqërore.

³ Që çmimi të jetë ekonomikisht domethënës ai duhet të jetë aq i lartë sa të mund të ndikojë kërkesën ose ofertën e një malli.

2.2.2.1 Qeveria Qendrore.

Autoriteti politik i Qeverisë Qendrore të një vendi shtrihet mbi tërë territorin e tij. Qeveria Qendrore mund të vendosë taksa mbi të gjitha njësitë institucionale rezidente dhe mbi të gjitha njësitë jorezidente të angazhuara në aktivitet ekonomik brenda vendit.

Qeveria Qendrore kryesisht është përgjegjëse për prokurimin e shërbimeve kolektive komunitetit si të tërë, si për shembull mbrojtja kombëtare, marrëdhëniet me vendet e tjera dhe rendi publik.

Ajo mund të shpenzojë në shërbime si edukimi apo shëndetësia, kryesisht në përfitim të individëve dhe mund të kryejë transfertat në dobi të njërive të tjera institucionale, duke përfshirë nivelet e tjera të qeverisë.

Identifikimi i këtij sektori në statistikat monetare dhe financiare është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të rolit të veçantë të tij në analizën ekonomike.

Në nivelin e Qeverisë Qendrore organet vendimarrëse formulojnë dhe ndërmarrin politikat që ndikojnë objektivat ekonomike të një vendi.

Nivelet e tjera të qeverisë nuk kanë për objektiva politikat ekonomike kombëtare dhe nuk kanë të drejta në kreditim nga Banka Qendrore.

Qeveria Qendrore përbëhet nga grupi qendror i departamenteve dhe i ministrive, që së bashku formojnë një njësi të vetme institucionale⁴ dhe njësi të tjera, që veprojnë nën autoritetin e Qeverisë Qendrore, që kanë identitet ligjor më vete dhe pavarësi të mjaftueshme.

2.2.2.2 Qeveria Lokale dhe Rajonale (Federale).

Për qëllime politike ose administrative, një shtet mund të ndahet në provinca, rajone (prefektura), ose federata.

Autoriteti legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv i qeverisë lokale dhe rajonale, shtrihet mbi të gjithë territorin e një rajoni të veçantë, por jo mbi rajonet e tjera.

Një qeveri lokale/rajonale mund të ketë autoritetin të mbledhë taksa nga njësitë institucionale që janë rezidente, ose angazhohen në aktivitet ekonomik në zonën e saj të kompetencës.

Ato shpesh përfitojnë grante nga nivele më të larta qeverisjeje. Për t'u trajtuar si njësi institucionale qeveria lokale/rajonale duhet të ketë të drejtë të zotërojë mjete, të krijojë fonde dhe të marrë përsipër detyrime për llogari të saj.

Gjithashtu një kusht tjetër është mbajtja e një grupi llogarish, që tregon se si shpenzohen fondet si dhe e drejta për të emëruar drejtuesit pa ndërhyrjen e niveleve të tjera.

Disa nga funksionet tipike të qeverive lokale përfshijnë mirëmbajtjen e rrugëve, të varrezave, të ujësjellësave, të teatrove etj.

⁴ Shumica e ministrive, departamenteve, agjencive, autoriteteve gjyqësore, organeve legjislative dhe njërive të tjera që formojnë një qeveri, nuk janë njësi institucionale, sepse në përgjithësi ato nuk kanë të drejtë të zotërojnë mjete dhe të marrin përsipër detyrime, apo të ndërmarrin transaksione në të drejtë të tyre. Përgjithësisht, të gjitha njësitë e financuara sipas buxhetit të kontrolluar nga parlamenti, mblihen në një njësi të vetme.

2.2.2.3 Sigurimi Shoqëror (i përfshirë ose jo në sektorët e tjerë).

Fondi i Sigurimeve Shoqërore është një lloj i veçantë i njësive qeveritare që vepron sipas një ose më shumë skemave të sigurimit shoqëror.

Që të klasifikohet si njësi në sektorin e qeverisë, ai duhet të përmbushë kërkesat për të qënë një njësi institucionale, pra të jetë i organizuar më vete, të ketë mjetet dhe detyrimet e veta dhe të angazhohet në transaksione financiare për llogari të vet.

Në statistikat monetare dhe financiare sigurimet shoqërore klasifikohen si nënsektor më vete në qeverinë e përgjithshme ose përfshihen në njërin nga sektorët e tjerë, për arsye se shpesh sigurimet shoqërore integrohen në programin fiskal të qeverisë.

2.2.3 Korporatat Jofinanciare.

Korporatat Jofinanciare përfshijnë korporatat që prodhojnë mallra dhe shërbime jofinanciare për tregun dhe për të gjitha njësitë e tjera që veprojnë si korporata dhe angazhohen në prodhim tregu.

Korporatat jofinanciare ndahen në dy grupe reciprokisht të përjashtueshme:

2.2.3.1 Korporatat Jofinanciare Publike.

Korporatat Jofinanciare Publike janë korporata jofinanciare rezidente, thuajsekorporata dhe institucione jo me qëllim fitimi, të angazhuara në prodhim tregu, që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria.

Kontrolli mund të ushtrohet nga zotërimi i më tepër se gjysmës së të drejtave votuese ose nëpërmjet ligjit, me dekrete ose me rregullore, të cilat vendosin politikën nëpërmjet të cilës qeveria mund të emërojë drejtuesit.

Këtu përjashtohen institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat nuk angazhohen në prodhim tregu.

2.2.3.2 Korporatat e Tjera Jofinanciare.

Korporatat e Tjera Jofinanciare përfshijnë korporatat e kontrolluara nga të huajt dhe Korporatat Jofinanciare Private vendase.

Korporatat e kontrolluara nga të huajt, janë korporata jofinanciare rezidente, thuajsekorporata dhe institucione jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhim tregu, të cilat kontrollohen nga jorezidentët. Kontrolli bazohet në zotërimin e shumicës së të drejtave votuese.

Këtu përfshihen të gjitha degët rezidente të korporatave, të kontrolluara nga jorezidentët (duke përjashtuar *ndërmarrjet e asociuara*⁵) dhe të gjitha thuajsekorporatat e kontrolluara nga jorezidentët, duke përfshirë degët, ndërmarrjet me kapital të përbashkët dhe të gjitha njësitë e tjera joaksionere.

⁵ Ndryshe nga bilanci i pagesave ndërmarrjet e asociuara (ku jorezidentët kane 10-50 për qind të pronësisë) nuk përfshihen në këtë grup.

Korporatat Jofinanciare Private vendase janë korporata jofinanciare rezidente dhe institucione jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhim tregu, që nuk janë Korporata Jofinanciare Publike dhe as korporata jofinanciare të kontrolluara nga të huajt.

Meqënëse është e vështirë të përcaktohet shkalla e kontrollit efektiv të korporatave standardi i pëgjithshëm është që pronarët duhet të kenë të paktën 50 për qind të të drejtave votuese.

Kështu që ndërmarrjet e asociuara që kontrollohen për më pak se 50 për qind nuk përfshihen në korporatat jofinanciare të kontrolluara nga të huajt, por në Korporatat Jofinanciare Private vendase.

2.2.4 Ekonomitë familjare (Individët).

Një ekonomi familjare është një grup i vogël personash, të cilët ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin të gjitha ose një pjesë të të ardhurave të tyre dhe konsumojnë mallrat kolektivisht.

Individë të veçantë, gjithashtu, konsiderohen ekonomi familjare.

Grupet e tjera si manastiret, azilet etj. do të konsiderohen ekonomi familjare, nëse ata ndajnë burimet dhe konsumin për një periudhë të gjatë kohe.

Shërbëtorët dhe punëtorët e shtëpive, që banojnë në vendet ku punojnë, por që nuk kanë pretendime mbi burimet, trajtohen si ekonomi familjare më vete.

Individët që udhëtojnë nga një vend në tjetrin, konsiderohen si rezidentë të atdheut të tyre, përveç rastit kur vendosin një qendër të interesit ekonomik në një vend tjetër.

Ekonomitë familjare mund të angazhohen në aktivitet ekonomik; për shitje në treg, për konsumin e vetë ekonomisë familjare dhe për akumulimin e kapitalit fizik.

Aktivitetet prodhuese të integruara në sektorin e ekonomive familjare, quhen *ndërmarrje të patrupëzuara*.

Ato angazhohen në biznes nëpërmjet punës, kapitalit fizik dhe burimeve financiare të ekonomisë familjare.

Gjithashtu, ato mund të marrin borxh për të financuar aktivitetet prodhuese.

Kapitali fizik dhe mjetet financiare të përdorura nga ndërmarrjet e patrupëzuara, i përkasin ekonomisë familjare, e cila është plotësisht përgjegjëse për borxhin dhe për detyrimet në lidhje me të.

Ky biznes, nuk mund të angazhohet në transaksione me njësi të tjera për llogari të tij dhe nuk mund të zotërojë mjete apo të marrë përsipër detyrime në emër të tij.

Përkufizimi i ndërmarrjeve të patrupëzuara, lidhet ngushtë me përkufizimin e ekonomisë informale. Ekonomia informale ekziston në të gjitha vendet, por në vendet në zhvillim ajo përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë.

Ekonomia informale nuk është njësoj si ekonomia ilegale. Ajo është një ndërmarrje ekonomike bazë që prodhon në shkallë të ulët dhe është e papërfshirë në një sistem regjistrimi apo njohjeje nga ligji.

Në ekonomitë me shkallë të lartë ekonomie informale, pjesa më e madhe e flukseve financiare kanalizohet në tregun informal dhe do të ishte e nevojshme matja e aktivitetit financiar informal, për të shpjeguar marrëdhënien midis aktivitetit jofinanciar dhe atij financiar.

2.2.5 Institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë ekonomive familjare.

Megjithëse institucionet jofitimprurëse ekzistojnë në shumë forma, vetëm institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë ekonomive familjare trajtohen si sektor më vete.

Njësitë jo me qëllim fitimi, janë njësi ligjore ose sociale, që prodhojnë mallra dhe shërbime, por që nuk gjenerojnë fitim për njësitë që i kontrollojnë ato. Kjo do të thotë që megjithëse institucionet jo me qëllim fitimi gjenerojnë fitime ose humbje nga veprimet e tyre, fitimi nuk i shpërndalet pronarëve.

Nëndarja e institucioneve jo me qëllim fitimi, bazohet në dy kritere: nëse ato angazhohen në prodhim tregu dhe në cilin sektor shërbejnë.

Institucionet e angazhuara në prodhim tregu klasifikohen në sektorin e korporatave. Ato angazhohen në prodhim tregu nëse (1) shesin prodhimin e tyre me çmime ekonomikisht të larta dhe (2) mbajnë një grup të plotë llogarish.

Institucionet jo me qëllim fitimi që shesin mallrat dhe shërbimet me çmime ekonomikisht të larta përfshijnë spitalet, shkollat etj. Mallrat dhe shërbimet e prodhuara financohen nëpërmjet granteve, kontributeve të bamirësisë apo fitimeve nga mjetet që zotëron institucioni, por çmimet mbeten në një nivel të tillë sa të mund të ndikojnë kërkesën.

Institucionet jo me qëllim fitimi që prokurojnë mallra dhe shërbime me çmime ekonomikisht të ulëta angazhohen në prodhim jo – tregu. Institucionet jofitimprurëse financiare të angazhuara në aktivitete tregu si për shembull unionet e kreditit klasifikohen në sektorin e Korporatave Financiare.

Institucionet jo me qëllim fitimi, që u shërbejnë bizneseve duke u siguruar shërbime, duke u kontrolluar standardet, duke u promovuar interesat e bizneseve etj, trajtohen si t'i prokurorin këto shërbime kundrejt pagesës edhe pse këtë mund ta bëjnë falas.

Supozohet se kuotat dhe grantet e marra nga bizneset, janë pagesat për shërbimet e kryera.

Institucionet jo me qëllim fitimi, të angazhuara në prodhim jotregu, i sigurojnë shërbime qeverisë ose ekonomive familjare falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.

Ato financohen kryesisht nga kontributet, nga kuotat e anëtarëve, apo nga fitimet nga mbajtja e mjeteve financiare ose jofinanciare.

Institucionet jofitimprurëse qeveritare ose financohen nga qeveria, ose janë nën kontrollin e qeverisë nëpërmjet të drejtës së saj për të emëruar drejtuesit. Ato klasifikohen në sektorin e Qeverisë së Përgjithshme.

Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë ekonomive familjare trajtohen si sektor më vete. Ato përbëhen nga tre lloj organizatash;

- Shoqata personash që u prokurojnë përfitime anëtarëve të tyre.
- Organizata bamirësie ose filantropike.
- Organizata informale, të zhvilluara sidomos në vendet në zhvillim, të cilat i prokurojnë shërbime komunitetit.

2.2.6 Rigrupimi në statistikat monetare dhe financiare.

Në statistikat monetare dhe financiare sektorët e përmendur më sipër rigrupohen, duke bashkuar kategoritë “Ndërmjetës të Tjerë Financiarë”, “Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit” dhe “Ndhmësit Financiarë” në një nënsektor të quajtur “Korporata të Tjera Financiare”.

Gjithashtu “Ekonomitë Familjare” dhe “Institucionet Jofitimprurëse që u shërbejnë ekonomive familjare” grupohen duke formuar “Sektorë të Tjerë Rezidentë”. Si përfundim, në statistikat monetare dhe financiare shfaqen këta sektorë:

- Jorezidentët.
- Qeveria Qendrore.
- Korporatat Financiare.
 - o Banka Qendrore;
 - o Korporatat e Tjera Depozituese;
 - o Korporatat e Tjera Financiare;
- Qeveria Lokale dhe Rajonale.
- Korporatat Jofinanciare Publike.
- Korporatat Jofinanciare Private.
- Sektorë të Tjerë Rezidentë.

2.3 Nënsektorët e Korporatave Financiare.

Sektori i Korporatave Financiare, përbëhet nga të gjitha korporatat ose thujse korporatat rezidente të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar ose në aktivitete financiare ndihmëse.

Ndërmjetësimi financiar mund të përkufizohet si aktiviteti i mbledhjes së fondeve duke marrë përsipër detyrime për llogari të tyre, me qëllim kanalizimin e fondeve tek njësi të tjera, nëpërmjet huadhënies, apo blerjes së mjeteve financiare.

Shërbimet e tjera ndihmëse, mund të ushtrohen si aktivitet dytësor nga ndërmjetësit ose të merren përsipër nga agjensitë e specializuara ose brokerat.

Disa agjenci kanë si funksion kryesor garantimin e instrumenteve, si për shembull bonot, për t'i bërë ato të vlefshme për riskontim nga njësitë financiare. Këto agjensi sigurojnë shërbime që përafrojnë shumë me ndërmjetësimin, por që nuk përfaqësojnë ndërmjetësim të vërtetë, pasi nuk mbartin rrezik duke marrë detyrime për llogari të tyre.

Sektori i Korporatave Financiare përfshin dhe institucionet jo me qëllim fitimi që (1) angazhohen kryesisht në prodhimin e shërbimeve financiare si për shembull sigurimi, ose (2) që financohen nga kuotat nga ndërmarrjet financiare dhe kanë si objektivi nxitjen dhe shërbimin në përfitim të këtyre ndërmarrjeve.

Individët dhe ekonomitë familjare mund të angazhohen në aktivitete financiare si për shembull huadhënia, apo shit-blerja e valutës së huaj.

Ndërmarrjet e patrupëzuara të këtij lloji, përfshihen në sektorin financiar vetëm nëse kualifikohen si ndërmjetës financiarë ose si ndihmës financiarë në trajtën e thujse korporatave. Për t'u kualifikuar si thujse korporata duhet të ekzistojë një grup i plotë llogarish që të identifikojë pozicionin e thujse korporatës veçmas pronarëve.

2.3.1 Pesë nënsektorë (SNA).

Sipas SNA 1993 në sektorin e Korporatave Financiare identifikohen pesë nënsektorët e mëposhtëm: Banka Qendrore, Korporatat e Tjera Depozituese, Ndërmjetës të Tjerë Financiarë duke përfshirë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit, Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit, dhe Ndhmësit Financiarë.

Në vijim shpjegohet përbërja e secilit prej tyre.

2.3.1.1 Banka Qendrore.

Banka Qendrore përkufizohet si një institucion financiar kombëtar (ose një grup institucionesh të ndara), që ushtron një kontroll të ngjashëm me atë të qeverisë, mbi aspekte kyçe të sistemit financiar.

Funksionet e bankës qendrore janë:

- emetimi i monedhës,
- rregullimi i ofertës së parasë dhe kreditit,
- mbajtja e rezervave ndërkombëtare të vendit,
- transaksionet me FMN-në dhe me organizatat e tjera financiare ndërkombëtare,
- politika e kursit të këmbimit,
- mbikëqyrja dhe rregullimi i sistemit bankar dhe mbajtja e rezervave të bankave tregtare,
- shërben si bankë dhe ndërmjetës financiar në marrëdhëniet ndërkombëtare për qeverinë,
- kreditimi i sistemit bankar, me qëllim rregullimin e veprimit të sistemit, kontrollin e normave të interesit dhe huadhënies së instancës së fundit për rastet emergjente,
- Kleringu i sistemit bankar.

Disa nga funksionet tipike për një bankë qendrore mund të ushtrohen edhe nga njësi të tjera si për shembull kleringu mund të bëhet nëpërmjet institucioneve private jo me qëllim fitimi, ose bankat e nivelit të dytë mund të veprojnë si agjente të qeverisë.

Të gjitha njësitë private që kryejnë një ose disa nga funksionet e lartpërmendura klasifikohen si korporata financiare private.

Funksionet tipike për një bankë qendrore të ushtruar nga Qeveria e Përgjithshme që nuk mund të veçohen në njësi institucionale të ndara, trajtohen si pjesë e Qeverisë së Përgjithshme.

Banka Qendrore mund të kryejë aktivitete tregtare për publikun si për shembull mbajtja e depozitave të transferueshme, ose operacionet e shkëmbimit valutor.

Nënsektori i Bankës Qendrore përfshin:

- Bankën Qendrore,
- *tryezat e parasë* ose “autoritetet e pavaruara të monedhës” të cilat emetojnë monedhë kombëtare që mbështetet plotësisht me rezervë valutore,
- agjenci të lidhura me qeverinë të cilat janë njësi institucionale që ndërmarrin një ose disa nga funksionet e bankës qendrore të përmendura më sipër si aktivitetin e tyre parësor,
- Bankat Qendrore rajonale të vendeve në një union.

Një nga funksionet e bankës qendrore është edhe funksioni si agjent i qeverisë. Një agjent vepron sipas instruksioneve të një njësie tjetër dhe nuk fiton e as nuk humbet si rezultat i transaksioneve financiare të ndërmarra për llogari të asaj njësie. Transaksionet financiare të një agjenti quhen edhe “në ruajtje” apo “në besim” për një njësi tjetër. Agjentët shpesh paguhen për shërbimin e kryer.

Transaksionet, mjetet financiare dhe detyrimet duhet t'i atribuohen bankës qendrore vetëm nëse ajo është detyruesi kryesor. Kur ajo vepron si agjent, transaksionet dhe pozicionet financiare duhet t'i atribuohen detyruesit kryesor.

Përcaktimi i detyruesit kryesor bazohet në përkufizimin e transaksionit financiar, i cili ua atribuon transaksionet dhe pozicionet financiare njërive, bazuar mbi atë se cila njësi merr fitimet, shkakton kostot dhe mban rrezikun që shoqëron një transaksion ose një instrument financiar.

Të njëjtat kritere që përcaktojnë se kur një bankë vepron si agjent, mund të përdoren për të përcaktuar nëse një transaksion i dhënë duhet përfshirë në llogaritë e Bankës Qendrore apo në llogaritë e njërive të tjera.

Këto kritere janë:

- *Pretendimet financiare dhe detyrimet* – Banka Qendrore nuk është përgjegjëse për ripagesat e detyrimeve dhe nuk përfiton nga arkëtimi i principalit të mjetit
- *Të ardhurat/fitimet dhe humbjet* – Interesat dhe të ardhurat e tjera dhe fitimet/humbjet nga kapitali pasqyrohen në pasqyrat e të ardhura - shpenzimeve të njërive të tjera.
- *Rreziku financiar* – banka qendrore nuk shkakton dhe nuk përgjigjet për rrezikun financiar të lidhur me transaksionin ose instrumentin financiar.
- *Vendimarrja* – Banka Qendrore vepron sipas instruksioneve të qeverisë ose njërive të tjera.
- *Llogaritë financiare* – Transaksionet dhe instrumentet prezantohen në llogari të veçanta dhe nuk përfshihen në bilanc, pasqyrën e të ardhura - shpenzimeve, ose në llogari të tjera financiare të Bankës Qendrore.
- *Transformimi financiar* – Natyra bazë e transaksionit apo e instrumentit nuk ndryshohet nga Banka Qendrore.
- *Pagesat për shërbimin* – Banka Qendrore përfiton pagesa si kompensim për ekzekutimin e transaksionit.

Në disa raste, Banka Qendrore mund të mos jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për transaksionin apo instrumentin, por mund të ketë detyrime financiare të lidhura ngushtë me të.

Për shembull qeveria mund të kryejë pagesa për një huadhënës ndërkombëtar nëpërmjet Bankës Qendrore dhe Banka Qendrore garanton ekspozimin ndaj kursit të këmbimit dhe mban humbjet dhe fitimet e rezultuara nga kursi i këmbimit.

Në këtë rast (1) në bilancin e qeverisë reflektohet transaksioni bazë i huasë, (2) Banka Qendrore vepron si agjent për ripagesat e huasë dhe (3) Banka Qendrore ka siguruar një garanci financiare, e cila është një instrument financiar më vete. Këto instrumente suplementare të ofruara nga Banka Qendrore, trajtohen në bilanc ose jashtë bilancit në varësi të natyrës specifike të instrumentit. Për shembull, një garanci për kursin e këmbimit midis qeverisë dhe Bankës Qendrore zakonisht paraqitet jashtë bilancit, por një opsion me të njëjtin funksion duhet të jetë në bilanc.

Përsa i përket trajtimit të bankave qendrore rajonale, në rastin e unioneve të monedhës, institucioni qendror i cili vepron si një bankë qendrore e përbashkët për shtetet anëtare të unionit, klasifikohet si njësi jorezidente që ka mjetet dhe detyrimet e veta.

Në një lloj unioni monedhe, ekziston një bankë qendrore kombëtare për çdo shtet anëtar dhe është e mundur të kompilohen llogaritë për çdo vend anëtar. Në këto llogari pretendimet e bankës qendrore mbi Bankën Qendrore rajonale trajtohen si pretendime ndaj jorezidentëve.

Në këtë rast bëhet një dallim midis pretendimeve dhe detyrimeve të jorezidentëve; midis jorezidentëve pjesëmarrës në union dhe jorezidentëve të tjerë. Pretendimet dhe detyrimet ndaj institucionit qendror, gjithashtu, identifikohen veçmas.

Në një lloj tjetër unioni monedhe nuk ka banka qendrore për çdo shtet anëtar dhe të gjitha funksionet e bankës qendrore ushtrohen nga Banka Qendrore rajonale. Në këtë rast institucioni qendror i Bankës Qendrore rajonale nuk klasifikohet si njësi institucionale më vete dhe gjendjet dhe flukset për mjetet dhe detyrimet e institucionit qendror, u shpërndahen vendeve anëtare në bazë të pjesës që ka secila në mjetet dhe detyrimet ndaj institucionit qendror.

2.3.1.2 Korporatat e Tjera Depozituese.

Ky nënsektor përmban të gjitha korporatat dhe thuajse—korporatat financiare të cilat pranojnë depozita të transferueshme, depozita të tjera ose zëvendësues të afërt të tyre, që përfshihen në përkufizimin kombëtar të parasë së gjërë.

Në zëvendësuesit e depozitave përfshihen, ndër të tjera, instrumente si çertifikatat e depozitave, marrëveshjet e riblerjes me afat të shkurtër, aksionet në Fondet e tregjeve të parasë, etj.

Emërtimi “Korporata Depozituese”, nënkupton që në këtë nënsektor përfshihen njësi me karakteristika të përbashkëta, pavarësisht nëse quhen banka apo jo. Termi bankë nuk përdoret si bazë për klasifikim sepse ky term mund të marrë kuptime të ndryshme. Disa njësi të quajtura “banka”, të cilat mund të mos i plotësojnë kushtet e mësipërme duhen përjashtuar nga ky nënsektor dhe nga ana tjetër zhvillimi i tregjeve financiare ka bërë të mundur që shumë ndërmjetës financiarë jobanka të mbledhin depozita ose të ofrojnë shërbime që tradicionalisht i ofrojnë bankat.

Megjithatë zakonisht, grupi kryesor i “Korporatave të Tjera Depozituese” janë bankat.

Si një institucion financiar i cili pranon depozitat nga publiku, dhe pastaj u jep hua publikut dhe huamarrësve të tjerë, banka ekspozohet ndaj rrezikut gjatë këtij procesi.

Tradicionalisht është menduar se bankat kanë një rol unik në procesin e krijimit dhe të qarkullimit të parasë dhe në ekspansionin e kredisë. Paraja, në kuptimin e ngushtë, ka kuptimin e një grupi instrumentesh financiare që shërbejnë si ruajtëse të vlerës dhe si mjete pagese të pranuarra gjerësisht. Depozitat e transferueshme të bankave, të cilat janë detyrime të bankave menjëherë të përdorshme nëpërmjet nënshkrimit të çeqeve, i plotësojnë këto kushte dhe përfaqësojnë një pjesë të madhe të parasë në një ekonomi.

Kështu, bankat shikoheshin si karakteristika thelbësore e sistemit monetar në një ekonomi, pasi ato pranojnë depozita të transferueshme, i përdorin këto fonde për të

shtuar kreditimin, mbajnë rezerva për të siguruar depozitat dhe kontribuojnë në rritjen e stokut të parasë nëpërmjet procesit të shumëzimit të parasë.

Në shumë vende, veçanërisht në vendet në zhvillim, sistemi bankar vazhdon të operojë si më sipër. Megjithatë, në këto vende kanalet informale të qarkullimit të parasë mund të jenë shumë të rëndësishme, shpesh duke tregtuar dhe valutën e huaj, kështu rëndësia e bankave brenda strukturës formale institucionale mund të japë një pamje të shtrembër të sjelljes së sistemit monetar dhe të ekonomisë në përgjithësi.

Lidhja e ngushtë midis bankave dhe parasë ka ardhur duke u dobësuar, pasi risitë në instrumentet financiare, kanë krijuar një shumëllojshmëri instrumentesh që kanë karakteristika të ngjashme me paranë dhe janë zëvendësues të afërt të saj.

Për shkak të këtyre risive, shumë vende kanë përshtatur përkufizimet e parasë së gjerë, që përfshijnë llojet e reja të depozitave, instrumente zëvendësues dhe instrumente të emetuara nga një rang më i gjerë institucionesh.

Meqë përkufizimi i parasë së gjërë është baza për klasifikimin si Korporatë Depozituese, institucionet që mund të përfshihen në këtë sektor janë:

- bankat tregtare,
- bankat e kursimeve, shoqëritë e kursim – kreditit,
- unionet e kreditit dhe kooperativat,
- bankat bujqësore/rurale,
- fondet e përbashkëta të tregut të parasë të përfshira në përkufizimin kombëtar të parasë së gjerë.

2.3.1.2.1 Korporatat (Bankat) Para Depozituese.

Bankat Para Depozituese janë një nëndarje opsionale e nënsektorit të Korporatave të Tjera Depozituese, në të cilën përfshihen bankat që pranojnë detyrime të përfshira në paranë e ngushtë. Në disa raste, është e preferueshme që të kompilohet *Paraqitja e Ngushtë Monetare*, e cila mbulon instrumentet që përdoren drejtpërdrejt për transaksione dhe Korporatat Financiare që emetojnë instrumentet e parasë së ngushtë.

Në këto instrumente, përveç depozitave të transferueshme, përfshihen edhe depozitat me të parë, depozitat pa afat që janë të përdorshme nëpërmjet makinave ATM, dhe çeqet e udhëtarëve.

Megjithatë edhe kur përdoret koncepti i parasë së gjerë që përfshin edhe jobankat, një nënkategori që përfshin vetëm bankat do të ishte e rëndësishme për të analizuar faktorë si mbikëqyrja, shkalla e kontrollit mbi rezervën e detyrueshme, zbatueshmëria e rregullave bankare ndërkombëtare mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, etj.

Nëse kompiluesit zgjedhin të përdorin nëndarjen “Korporata Para Depozituese”, të gjitha Korporatat e Tjera Depozituese që mbeten do të quheshin “Korporata të Tjera Depozituese të Tjera”.

2.3.1.2.2 Të tjera.

Korporata të Tjera Depozituese “tej bregut” (offshore).

Disa korporata depozituese hyjnë në transaksione ekskluzivisht me jorezidentët, gjë që njihet si *veprimtari bankare tej bregut*.

Meqë shpesh herë këto kanë karakteristika të veçanta rregulative dhe ligjore, të dhënat për to, jepen në vëmendje me qëllim që llogaritë e tyre të përjashtohen nga agregatët, për të siguruar kështu një lidhje të tyre me aktivitetin e brendshëm financiar.

Të dhënat mbi Korporatat e Tjera Depozituese “*tej bregut*” ndahen nga nënsektori i Korporatave të Tjera Depozituese dhe llogaritë midis tyre dhe Korporatave të Tjera Depozituese identifikohen veçmas.

Ndërmjetësit e specializuar brenda nënsektorit.

Nëndarje të tjera të nënsektorit mund të kenë të bëjnë me ndërmjetës të specializuar si *shoqëritë e kursim – kreditit*. Kjo është karakteristikë e sistemeve financiare më të sofistikuar. Nënsektorizimi i tyre bëhet në bazë të nevojave të përdoruesve të statistikave.

Bankat ndërsektoriale dhe shtëpitë e riskontimit (discount houses).

Disa ndërmjetës të specializuar veprojnë ekskluzivisht me Korporata të Tjera Depozituese.

Për shembull, disa njësi huazojnë fonde kryesisht prej Korporatave të Tjera Depozituese, për të financuar investimet në instrumentet e tregut të parasë, si për shembull bonot e thesarit të qeverisë pranimit bankare, apo certifikatat e depozitave.

Disa prej tyre janë “banka të bankave” të cilat konsolidojnë investimet që bankat nuk do të ishin në gjendje të administrojnë dhe “shtëpitë e riskontimit” (discount houses), që blejnë letra me vlerë nga bankat dhe i riskontojnë ato me bankën qendrore.

Klasifikimi i këtyre institucioneve mund të bëhet në dy mënyra, në varësi të strukturës analitike të përdorur:

- nga njëra anë, këto institucione nuk emetojnë detyrime ndaj publikut dhe kjo bën që këto të mos klasifikohen brenda nënsektorit por si ndihmës financiarë apo institucione të tjera financiare.
- nga ana tjetër, sjellja e tyre ekonomike, mund të jetë kaq e lidhur me sjelljen e Korporatave të Tjera Depozituese, sa që do të ishte e përshtatshme që llogaritë e tyre të konsolidoheshin me ato të Korporatave të Tjera Depozituese. Për shembull operacionet në treg të hapur të bankës qendrore me shtëpitë e riskontimit, mund të rezultojnë në ndryshime të shpejta në likuiditetin e Korporatave të Tjera Depozituese.

Bankat në likuidim.

Ky nënsektor, mund të përmbajë edhe bankat që veprojnë nën likuidim ose që i kanë mbyllur operacionet me publikun.

Disa prej tyre mund të jenë teknikisht të falimentuara, por vazhdojnë të funksionojnë nëpërmjet subvencioneve apo ndihmave nga qeveria, apo marrëveshjeve specifike. Ato mund të vazhdojnë të mbajnë statusin ligjor si banka, por mund të krijohen struktura të veçanta të cilat shërbëjnë për të transferuar huatë e këqija.

Sjellja financiare e këtyre institucioneve ndryshon nga ajo e Korporatave të Tjera Depozituese për këto arsye:

- Depozitat e tyre mund të jenë krejtësisht të bllokuara ose të ngrira. Flukset hyrëse të depozitave të reja janë zero për shkak të kushteve në të cilat ndodhet banka.
- Nuk japin kredi të reja ose mbledhin ato ekzistuese.
- Vlerësimi i mjeteve mund të jetë jorealit.
- Mund të ndodhin riorganizime të llogarive financiare si për shembull fshirjet.
- Mund të ketë transferta ose flukse të veçanta me qeverinë ose me Bankën Qendrore.

Llogaritë e bankave dhe institucioneve të tjera financiare nën likuidim duhet të identifikohen veçmas.

Për shkak të kushteve të veçanta të renditura më sipër huadhënia dhe huamarrja e tyre nuk është e njëjtë me atë të Korporatave të Tjera Depozituese dhe duhen përjashtuar nga agregatët e kredisë dhe parasë. Depozitat e transferueshme dhe detyrimet e ngjashme në bilancet e tyre duhet të riklasifikohen si depozita të bllokuara dhe të përjashtohen nga agregatët e parasë.

2.3.1.3 Ndërmjetës të Tjerë Financiarë (duke përjashtuar Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e pensionit).

Ky nënsektor, grupon të gjithë ndërmjetësit përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit dhe Korporatave të Tjera Depozituese, të cilat krijojnë fonde nëpërmjet instrumenteve të depozitave, instrumenteve të borxhit, dhe të kapitalit, dhe u japin hua vetëm një kategori klientësh apo vetëm nëpërmjet një lloj instrumenti.

Kompanitë e financimit.

Kompanitë e financimit janë njësi institucionale të cilat si aktivitet parësor kanë kreditimin e korporatave jofinanciare dhe të ekonomive familjare.

Korporatat financiare mund të jenë njësi të pavarura ose të kontrolluara nga kompani të tjera.

Kompanitë e financimit të pavarura konkurojnë me bankat përsa i përket kreditimit dhe mbi to ushtrohet më pak kontroll se te bankat.

Kompanitë e financimit kreditojnë pothuajse nëpërmjet të gjitha instrumenteve, duke përfshirë, kredinë konsumatore, kredinë tregtare bizneseve të vogla, kartat e kreditit, kreditë hipotekare, pranimet bankare etj.

Kompanitë e financimit të kontrolluara nga kompani të tjera krijojnë fonde me qëllim huadhënien e tyre kompanisë kontrolluese, ose blerjen e llogarive të arkëtueshme të kompanisë kontrolluese. Fondet krijohen nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë afatshkurtra, si për shembull letrat tregtare.

Disa prej tyre kontrollohen shpesh nga Korporatat e Tjera Depozituese me qëllim angazhimin e tyre në linja të veçanta të aktivitetit apo për qëllime regullative.

Nëse ato nuk kualifikohen si njësi institucionale të pavarura duhet të klasifikohen si Korporata të Tjera Depozituese.

Kompanitë e financimit të kontrolluara mund të angazhohen edhe në aktivitete të tilla si huadhënia konsumatorëve me qëllim promovimin e shitjeve të kompanisë kontrolluese, blerja e llogarive të arkëtueshme të kompanisë kontrolluese ose financimi i inventarëve.

Kompanitë e lizingut financiar⁶.

Kompanitë e lizingut financiar japin hua për blerjen e një mjeti të caktuar. Lizingu financiar është një metodë e përhapur për financimin e investimeve kapitale të kushtueshme si për shembull anijet, aeroplanët, kompjuterat etj.

Kompania e lizingut financiar është pronari ligjor i mallit, por efektivisht pronësia i kalon *huamarrësit* sepse është ai që merr fitimet, shkakton shpenzimet dhe mbart rrezikun që shoqëron pronësinë e mjetit.

Kompanitë e lizingut financiar financojnë përdorimin e mjetit për thuajse të gjithë jetën e tij ekonomike.

Fondet e përbashkëta të investimit.

Fondet e përbashkëta të investimit (të cilat quhen edhe fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv) janë institucione financiare, të cilat konsolidojnë investimet me qëllim blerjen e mjeteve financiare.

Ato mund të jenë të trupëzuara ose të patrupëzuara. Investitorët blejnë aksione të cilat u japin atyre një pjesë përpjestimore në vlerën neto të fondit. Fondet me fund të mbyllur emetojnë një numër fiks aksionesh ndërsa fondet me fund të hapur mund të emetojnë aksione shtesë për të tërhequr më shumë investime.

Fondet e përbashkëta të investimit konsiderohen si ndërmjetës financiare edhe pse mund të jenë në formën e portofoleve të patrupëzuara të mjeteve të administruara nga njësi të tjera financiare. Për shembull nëse fondet e përbashkëta të investimit veprohen nga bankat dhe nga pikëpamja e klientëve ato nuk kanë asnjë dallim nga depozitat.

Likuiditeti i instrumenteve të fondeve të përbashkëta të investimit, ndryshon nga një vend në tjetrin. Tradicionalisht, fondet e përbashkëta të investimit janë parë si mekanizma jolikuidë investimi apo me likuiditet të kufizuar. Përgjithësisht në vendet në zhvillim dhe të pazhvilluara kjo gjë është e vërtetë, ndërsa në vendet e zhvilluara fondet e përbashkëta të investimit konkurojnë me Korporatat Depozituese në ndërmjetësimin financiar dhe detyrimet e tyre përfshihen në agregatët e parasë së gjerë.

Fondet e përbashkëta të investimit, të cilat emetojnë detyrime të përfshira në paranë e gjerë klasifikohen si korporata të tjera depozituese, në rast të kundërt ato klasifikohen si fonde të përbashkëta të investimit brenda kategorisë “Ndërmjetës të Tjerë Financiarë (duke përjashtuar Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e pensionit)”.

Fondet e përbashkëta të investimit investojnë në një rang të gjerë mjetesh, megjithë tendencën për t’u specializuar në një fushë të veçantë. Ato mund të ndahen në:

- Fondet e përbashkëta të investimit që investojnë në instrumente afatshkurtra (fonde të tregut të parasë);
- Fondet e përbashkëta të investimit që investojnë në obligacione;
- Fondet e përbashkëta të investimit që investojnë në kapital apo në instrumente të tjera;
- Fondet e përbashkëta të investimit që investojnë në pasuri të patundëshme;

⁶ Leasing – qiradhënie financiare. Në tekst: *lizing*.

Ndarja mund të jetë e nevojshme në analizën financiare sepse mund të ekzistojë një shkallë e lartë zëvendësimi midis investimeve në fondet e përbashkëta të investimit dhe investimeve në instrumentet e parasë. P.sh, fondet e tregjeve të parasë shpesh janë zëvendësues të afërt të depozitave dhe mund të përfshihen në agregatët monetarë.

Detyrimet e fondeve të përbashkëta të investimit që investojnë në mjete të tjera përfshihen më rrallë në agregatët monetarë. Fondet e përbashkëta të investimit që investojnë në obligacione janë alternativë ndaj bankave si burim për të kredituar bizneset dhe aksionet në fondet e tregut të parasë mund të shihen nga publiku si zëvendësues të afërt të depozitave.

Në disa raste llojet e mjeteve në të cilat fondet e përbashkëta të investimit investojnë, mund të jenë jo të rëndësishme në përcaktimin, nëse ato janë apo jo institucione monetare sepse investitorët mund të fokusohen në likuiditetin dhe në kthimin nga instrumentet dhe të lëvizin lirisht midis llojeve të ndryshme të fondeve të investimit.

Karakteristika të rëndësishme të disa fondeve të përbashkëta të investimit, janë një shkallë e lartë likuiditeti dhe aftësia e tyre për t'u siguruar klientëve investime me karakteristikat e dëshiruara.

Fondet e përbashkëta të investimit, i krijojnë portofolet me qëllim gjetjen e karakteristikave specifike të kërkuara nga klientët dhe mbrojtjen e portofolit nga risku nëpërmjet derivateve financiare. Rreziku i kredisë së portofolit, norma e kthimit, dhe stabiliteti i çmimit të tij mund të jenë të ndryshme nga ato të përbërësve të tij.

Tërheqjet nga nga disa fonde të përbashkëta të investimit nuk lejohen, por në disa të tjera përdorimi për pagesa i bën ato zëvendësues të afërt me depozitat. Për më tepër, fondet e përbashkëta të investimit mund të ofrojnë norma kthimi më të larta se depozitat bankare sepse ato përballen me shpenzime regullative më të ulëta se bankat, mbajnë më pak kapital rezervë dhe kanë një rang më të gjerë mundësisht investimi.

Nënshkruesit dhe tregtarët në letra me vlerë.

Ky nënsektor përmban individë dhe firma të cilat specializohen në transaksione në letra me vlerë të emetuara në treg primar ose në investimin dhe në tregtimin e letrave me vlerë në tregun sekondar. Vetëm njësitë që janë ndërmjetëse klasifikohen këtu; njësitë që kryesisht u sigurojnë shërbime të tretëve apo u lehtësojnë transaksionet janë ndihmës financiarë, dhe njësitë të cilat vetëm sa investojnë kapitalin e tyre nuk janë pjesë e sektorit financiar.

Këta ndërmjetës mund të operojnë si nëpërmjet tregjeve publike ashtu edhe nëpërmjet marrëveshjeve të negociuara privatisht. Ky nënsektor përfshin:

- Nënshkruesit, të cilët përcaktojnë kushtet dhe shesin letrat me vlerë të emetuara për herë të parë në publik kundrejt një pagese dhe sigurojnë garancinë për të blerë dhe rishitur emetimet për llogari të tyre.
- Tregtarët, të cilët blejnë dhe rishesin letrat me vlerë. Shërbimet shtesë të lidhura mund të bëhen kundrejt një pagese.
- Krijuesit e tregut dhe specialistët, të cilët janë njësi profesionale që tregtojnë në letrat me vlerë, sigurojnë likuiditet në treg dhe shpërndajnë letrat me vlerë në mënyrë të tillë që lehtësohet tregtimi.

- Tregtarët, të specializuar në letrat me vlerë të qeverisë, të cilët janë agjentë për emetimin e borxhit qeveritar, operacionet në treg të hapur, marrëveshjet e riblerjes dhe kontratat e rishitjes në letrat me vlerë të qeverisë.

Rastet kufitare midis brokerave dhe dealerave të klasifikohen si ndërmjetës financiarë.

Kompanitë Transportuese dhe trustet.

Kompanitë Transportuese janë njësi financiare të krijuara për të mbledhur mjetet nën titullizim (*securitization*)⁷, që hiqen nga bilanci i korporatave apo i qeverisë. Ato mund të jenë organizuar si korporata më vete, por edhe të organizuara në formën e trusteve apo të njërive të posaçme që krijohen për të mbajtur një portofol të caktuar mjetesh apo detyrimesh.

Titullizimi i mjeteve në shkallë të gjerë është një nga risitë financiare më të rëndësishme dhe kompanitë transportuese janë mjeti që e ka bërë të mundur *titullizimin*.

Një ndërmjetës, si për shembull një bankë, i shet një portofol mjetesh një kompanie transportuese, e cila e riorganizon portofolin dhe ia shet publikut apo investitorëve institucionale.

Kompania transportuese është pronari ligjor i portofolit të mjeteve dhe mund të veprojë si ndërmjetës financiar.

Nëse kompania transportuese shet një instrument të ri financiar duke përfaqësuar një interes në portofol, ai vepron si një ndërmjetës financiar dhe është një njësi institucionale më vete. Instrumenti mund të jetë një letër me vlerë borxhi ose kapitali.

Në të kundërt, nëse kompania transportuese nuk shet një instrument të ri financiar që përfaqëson një interes në portofol, efektivisht nuk e transformon natyrën e portofolit dhe nuk është një njësi institucionale më vete; blerësit e portofolit konsiderohen të jenë pronarët direktë të mjeteve dhe kompania transportuese nuk e kontrollon portofolin. Kompania transportuese konsiderohet si një formë trusti, i cili mban mjetet në mënyrë pasive.

Ndërmjetësit në derivatet financiare.

Ky nënsektor përfshin njësitë që emetojnë, blejnë ose marrin pozicione në ato derivate financiare që njihen si mjete financiare. Njësitë të cilat marrin pozicione në derivate që nuk njihen si mjete financiare klasifikohen si ndihmës financiarë.

Derivatet shiten për një sërë arsyesh, duke përfshirë shitjen nga kompanitë jofinanciare për të mbrojtur transaksionet apo për të garantuar vlerat për pagesa të ardhshme. Bankat, nënshkruesit dhe bursat hyjnë në transaksione në derivate në kushte normale të biznesit të tyre.

Nëse emetimi i derivateve është një aktivitet dytësor, aktiviteti i emetimit të derivateve do të përfshihet në statistikën për nënsektorët e tjerë financiarë apo për sektorët jofinanciarë.

Në këtë nënsektor përfshihen arbitrazhistët, tregtarët dhe dealerat në derivate, firmat specialiste dhe investitorët të cilët shesin dhe blejnë derivate për të fituar. Duke u nisur nga natyra e derivateve, tregtimi aktiv në to shoqërohet zakonisht me emetimin e instrumenteve.

⁷ Riorganizimi i instrumenteve të patregtueshme si për shembull huatë, hipotekat, llogaritë e arkëtueshme etj., në një formë të tregtueshme quhet titullizim (*securitization*).

Ndërmjetës financiarë të specializuar.

Këtu përfshihen të gjithë ndërmjetësit e tjerë financiarë, disa prej të cilëve janë shumë të specializuar. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe ndërmjetësit e tjerë të cilët nuk mund të futen në nënsektorët e tjerë.

- *Korporatat e parasë elektronike* emetojnë paranë elektronike ose mjete të ngjashme pagese kundrejt detyrimeve financiare që marrin përsipër.
- *Firmat e financimit të eksport-importit* ofrojnë një sërë shërbimesh të lidhura me tregtinë ndërkombëtare duke përfshirë blerjen e bonove të këmbimit dhe pranimet.
- *Faktorët* ose kompanitë e faktoringut, janë kompani që marrin nën kontroll arkëtimin e llogarive të arkëtueshme për kompanitë tregtare, riskojnë llogaritë e arkëtueshme ose sigurojnë garanci për pagesat e vonuara.
- *Fondet mbrojtëse* investojnë në derivate financiare, marrin pozicione të shkurtra në letrat me vlerë ose shesin kontrata derivate në tregun mbi banak, kundrejt pagesës ose për fitimet spekulative që lindin për shkak të ndryshimit të çmimit të derivateve.
- *Shoqëritë mbajtëse* janë korporata të cilat nuk angazhohen në prodhim, por krijohen për të mbajtur investimet në korporata të tjera dhe për t'i kontrolluar ato. Klasifikohen si financiare apo jofinanciare në bazë të aktiviteteve të njësive, të cilat kontrollohen prej tyre.

2.3.1.4 Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit.

Ky nënsektor përfshin të gjitha Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit përveç fondit të sigurimeve shoqërore. Karakteristikat e përbashkëta të tyre janë se mbledhin prime nga klientët, të cilat mbahen dhe investohen deri në momentin që klientit i bëhen pagesat.

Kompanitë e Sigurimit.

Kompanitë e Sigurimit u sigurojnë përfitime financiare klientëve dhe personave të mbijetuar në raste aksidentesh, sëmundjesh, vdekjesh katastrofash natyrore, etj.

Bizneset mund të krijojnë degë sigurimi të organizuara më vete për të administruar nevojat e tyre për sigurim, të cilat klasifikohen në këtë sektor.

Këto degë mbledhin prime nga kompania – mëmë dhe i investojnë mjetet e tyre për të mbledhur rezerva për nevojat e ardhshme të korporatës – mëmë. Disa prej tyre mund të marrin përsipër aktivitete sigurimi edhe për njësi të tjera.

Kompanitë e sigurimit të jetës paguajnë shpenzimet e funeralit ose u sigurojnë përfitime financiare të tretëve pas vdekjes së një individi. Përfitimet financohen prej policave që mbledhen nga individët, punonjësit, apo shoqëritë që përfaqësojnë individët, dhe nga fitimet nga investimi i policave.

Kompanitë e sigurimit të jetës, ligjërisht mund të organizohen në një shumëllojshmëri formash; si korporata të pavarura, si kooperativa nën pronësi të mbajtësve të policave

dhe si funksione të ndërmarra nga kisha, nga organizata sociale apo nga njësi jofitimprurëse.

Kompanitë e tjera të sigurimit përfshijnë kompanitë që sigurojnë përfitime financiare në rast aksidentesh, zjarri, përmbytjeje, sëmundjesh etj. Rreziku i marrë përsipër nga këto lloj kompanish është më afatshkurtër se nga kompanitë e sigurimit të jetës.

Kompanitë e risigurimit u sigurojnë një lloj sigurimi vetë kompanive të sigurimit duke pranuar polica nga kompanitë e tjera të sigurimit.

Ato mund të operojnë të pavarura ose si sindikata (konsortiume) që veprojnë në bursë.

Fondet e Pensionit.

Fondet e Pensionit të klasifikuara në këtë nënsektor janë njësi të pavarura institucionale, të cilat mbajnë dhe investojnë mjetet e kontribuesve, me qëllim përfitimin e të ardhurave pas daljes në pension.

Fondet e pensionit mbulojnë grupe specifike individësh. Zakonisht llogaritë e anëtarëve individualë në fondet e pensionit veçohen dhe përfitimet në lidhje me to varen nga shuma e kontributeve. Pjesëmarrja në to, si nga punëdhënësi ashtu edhe nga punëmarrësi, është shpesh vullnetare, por mund të jetë edhe e detyruar.

Qeveria, gjithashtu, mund të ketë fonde pensioni të pavarura nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

Ky nënsektor nuk e përfshin fondin e sigurimit shoqëror i cili është një program i detyrueshëm që imponohet dhe kontrollohet nga qeveria, me qëllim financimin e përfitimeve sociale për të gjithë komunitetin.

Identifikimi i fondeve të pensionit si njësi institucionale varet nga fakti nëse ato janë të financuara apo jo - të financuara.

Planet e pensionit të financuara kanë një grup të veçantë mjetesh dhe rezervash të cilat përdoren për prokurimin e përfitimeve. Planet e pensionit të fondësuara, janë të pavarura nëse ato administrohen nga një njësi e veçantë institucionale që klasifikohet në këtë nënsektor.

Planet e pensionit të financuara janë të varura nëse ato nuk administrohen nga një njësi e veçantë, por llogaritë e tyre mbahen bashkë me llogaritë e prokuruesit të pensionit. Ato klasifikohen në sektorin institucional të punëdhënësit duke krijuar një pretendim të ekonomive familjare në sektorin që ofron planin. Fondi shikohet si pronë e përfituesve dhe jo e punëdhënësit.

Planet e pensionit jo të financuara nuk kanë mjete të identifikueshme, përfitimet paguhen prej të hyrave të kontribuesve dhe duke tërhequr nga burimet e përgjithshme të prokuruesit të pensionit. Planet e pensionit jo të financuara ose që nuk janë të veçuara nga llogari të tjera të punëdhënësit, nuk kanë mjete të identifikueshme të cilat mund të konsiderohen mjete të sektorit të ekonomive familjare mbi fondin e pensionit.

2.3.1.5 Ndihmësit Financiarë.

Ky nënsektor përfshin korporatat financiare, aktivitetet e të cilave janë të lidhura ngushtë me ndërmjetësimin financiar, por që nuk veprojnë si ndërmjetës. Kjo do të thotë që ato nuk krijojnë fonde dhe nuk kreditojnë për llogari të tyre, si aktivitetin e tyre parësor.

Në këtë nënsektor përfshihen:

Bursat dhe tregjet e letrave me vlerë.

Bursat janë vende ose mekanizma tregtarë të formalizuar, ku tregtohen letra me vlerë si obligacionet, aksionet apo derivatet financiare.

Nënsektori përfshin si vetë bursën, ashtu edhe një rang njësisht shërbimesh që kanë lidhje me transaksionet me letrat me vlerë, si kompanitë depozituese të letrave me vlerë, zyrat e kontabilitetit dhe kleringut dhe kompani të tjera të specializuara në shërbimet e lidhura me letrat me vlerë.

Këtu përfshihen edhe organizatat joqeveritare që rregullojnë apo mbikëqyrin bursat dhe tregjet e letrave me vlerë, duke përfshirë organizatat vetërregulluese dhe organizatat ndërkombëtare private.

Bursat organizohen ose si korporata, ose si pronë e përbashkët e anëtarëve të tyre. Bursa është përgjegjëse për të siguruar kualifikimin e anëtarëve të saj, garantimin e përfundimit të transaksioneve, kleringun e transaksioneve dhe rregullimin e pagesave, zgjidhjen e konflikteve dhe sigurimin e kapitalit për të parandaluar mashtrimin dhe humbje të tjera.

Bursat mund të organizohen si sisteme komunikimi të kompjuterizuara të cilat i lejojnë anëtarët të tregtojnë në largësi.

Brokerat dhe agjentët.

Ky nënsektor përfshin individë dhe firma që lehtësojnë shitjen e instrumenteve financiare për klientët. Ato mund të operojnë ose si bursa publike, ose nëpërmjet tregtimeve të negociuara privatisht. Ky nënsektor përfshin:

- Brokerat dhe agjentët të cilët lehtësojnë shitjen e letrave me vlerë për klientët, nëpërmjet tregtimit me klientë individualë ose nëpërmjet tregtimit në dyshtet e bursës.
- Shërbimet këshillimore financiare për brokerat dhe klientët e tyre.

Shumë firma brokerimi marrin pozicione në letrat me vlerë apo në derivatet financiare, gjë që vështirëson ndarjen, dallimin e tyre nga dealerat dhe nënshkruesit të cilët janë ndërmjetës financiarë. Me marrëveshje, ky nënsektor do të përfshijë vetëm rastet e qarta të brokerave dhe agjentëve.

Kompanitë e këmbimit valutor dhe byrotë e këmbimit.

Ky nënsektor përfshin njësitë që shesin dhe blejnë valutë të huaj.

Një pjesë e mirë e tregtimit informal ndërmerret nga individët dhe nga organizatat e vogla, të cilat gjithashtu mund të japin kredi. Në rastin e fundit njësia klasifikohet si "Ndërmjetës të tjerë financiarë".

Kompanitë e garancive financiare.

Kompanitë e garancive financiare, sigurojnë klientët kundrejt humbjes financiare në kontrata apo letra me vlerë specifike, ose sigurojnë klientët kundër falimentimit të institucioneve financiare.

Këtu përfshihen korporatat financiare të specializuara, duke patur parasysh se shumë nga këto shërbime prokurohen nga bankat, nga brokerat e letrave me vlerë dhe nga ndërmjetës të tjerë si aktivitet sekondar.

Ky nënsektor përfshin, gjithashtu, edhe njësitë e specializuara që mbrojnë depozituesit dhe investitorët nga falimentimi i institucioneve financiare. Ato klasifikohen këtu në rast se funksionojnë si njësi të pavarura, veprojnë si njësitë tregtare, vendosin çmime ekonomikisht të rëndësishme dhe mbajnë një grup të plotë llogarish.

Dallimi i kompanive të garancive me kompanitë e sigurimit mund të jetë shpesh i vështirë. Kompanitë e garancive financiare mund të marrin pozicione jashtë bilanci, dhe mund të rregullohen më pak se kompanitë e sigurimit. Rastet kufitare klasifikohen si kompani sigurimi.

Ndihmës të tjerë.

Këtu përfshihen ndihmës të tjerë të paklasifikuar. Të tillë janë:

- Njësi të pavarura të qeverisë, të cilat rregullojnë institucionet financiare
- Korporatat, të cilat veprojnë me mekanizmat e pagesave elektronike por që nuk shkaktojnë detyrime përkundrejt instrumenteve. Këto njësi klasifikohen këtu nëse mund të identifikohen si njësi që e zhvillojnë këtë aktivitet si aktivitetin e tyre primar.
- Zyrat e përfaqësimit të korporatave të huaja depozituese që nuk pranojnë depozita dhe nuk japin kredi, por që lehtësojnë transaksionet me kompaninë e tyre mëmë.

2.3.2 Përkufizimi kombëtar i parasë së gjerë: koncept kyç për identifikimin e korporatave depozituese.

Për identifikimin e korporatave depozituese shërben përkufizimi kombëtar i parasë së gjerë.

Në Shqipëri, agregatët monetarë janë përkufizuar si më poshtë:

- Agregati M1 ose paraja e ngushtë përbëhet nga monedhat dhe kartmonedhat në qarkullim jashtë sistemit bankar, nga llogaritë rrjedhëse në lekë të rezidentëve jobanka (përrjashtuar qeverinë qendrore) dhe depozitat pa afat në lekë të rezidentëve jobanka (përrjashtuar qeverinë qendrore).
- Agregati M2 përbëhet nga agregati M1 plus depozitat me afat në lekë të rezidentëve jobanka (përrjashtuar qeverinë qendrore).
- Agregati M3 ose paraja e gjerë, përbëhet nga agregati M2 plus depozitat pa afat, depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse në valutë të rezidentëve jobanka (përrjashtuar qeverinë qendrore).

Nga ky përkufizim, që një njësi të kualifikohet si korporatë depozituese duhet të pranojë instrumentet e përfshira në M3 nga njësitë e tjera që nuk janë korporata të tjera depozituese, konkretisht: (1) llogari rrjedhëse, (2) depozita pa afat, (3) depozita me afat. Në sektorin e Korporatave Depozituese në Shqipëri përfshihen Banka Qendrore, bankat e nivelit të dytë dhe Shoqëritë e Kursim – Kreditit.

2.4 Mjetet dhe detyrimet financiare; vështrim i përgjithshëm.

Ky kapitull përmban përkufizimin dhe klasifikimin e instrumenteve financiare dhe të mjeteve financiare.

Pjesa e parë përmban karakteristikat e instrumenteve financiare dhe transaksionet financiare.

Pjesa e dytë përmban klasifikimin e instrumenteve financiare.

Koncepti “instrument financiar” në përgjithësi, përfshin një gamë të gjerë të kontratave financiare ndërmjet njësive institucionale. Në kontratë “mjetet financiare” janë një vendosje specifike e instrumenteve financiare që njihen nga SNA e vitit 1993.

Kjo metodikë përdor përkufizimet dhe klasifikimet e SNA të mjeteve financiare me qëllim dhënien e një standardi të përbashkët në statistikat monetare, në llogaritë kombëtare dhe në statistikat e tjera makroekonomike.

Ky kapitull diskuton gjerësisht përkufizimet e instrumenteve financiare të përdorura në sistemin kontabël ose rregullator.

Ky kapitull, gjithashtu trajton dallimet në instrumentet financiare dhe jep marrëdhëniet midis tyre, duke qenë se ndryshimet në tregjet financiare kanë fshirë dallimet ndërmjet instrumenteve tradicionale dhe kanë krijuar një numër të madh instrumentesh të reja.

2.4.1 Karakteristikat e instrumenteve financiare.

Përkufizimi i mjeteve dhe transaksioneve financiare:

2.4.1.1 Mjetet financiare të SNA.

Përkufizimi i mjeteve financiare - Mjeti financiar është një lloj mjeti ekonomik i krijuar nëpërmjet një kontrate apo marrëveshjeje formale apo joformale ndërmjet dy njësive institucionale dhe që përmban një marrëdhënie kreditor/debitor ose marrëdhënie pronësie ndërmjet njësive, duke detyruar palët të paguajnë të ardhurat e pronësisë, të ripaguajnë principalin ose të transferojnë mjetet e tjera financiare.

Mjeti financiar është një lloj i mjetit ekonomik. Një mjet ekonomik zotërohet nga njësia institucionale që siguron përfitime (1) duke prodhuar mallra ose duke kryer shërbime, (2) duke gjeneruar të ardhurat nga pronat e patundshme në formën e rentës ose të fitimit neto, ose (3) duke shërbyer si mbajtëse e vlerës.

Mjetet financiare ndryshojnë nga mjetet e tjera ekonomike sepse (1) pjesa më e madhe krijojnë një marrëdhënie debitor/kreditor ose marrëdhënie pronësie, në të cilën një njësi fiton një të drejtë ndaj burimeve ekonomike të njësisë tjetër, (2) ato nuk prodhojnë mallra dhe shërbime, dhe (3) ato sigurojnë përfitime në formën e të ardhurave nga interesi, sigurojnë një pjesë në të ardhurat neto të një njësisë tjetër institucionale, mbajnë fitime kapitale ose ruajnë vlerë.

Një marrëdhënie kreditor/debitor ndërmjet njësive konsiston në:

Mjetin, i cili është një e drejtë ose pretendim i një njësie (kreditore) për të marrë pagesa në monedhë, një instrument tjetër financiar ose në të ardhura nga prona prej njësisë tjetër.

Detyrimi, është një detyrim i një njësie (debitore) për të paguar në monedhë, në formën e një instrumenti tjetër financiar ose të ardhura nga prona një njësie tjetër.

Kapitalin, në formën e aksioneve ose të dëftesave të pronësisë, i cili krijon një pretendim në të ardhurat neto të njësisë dhe një pretendim në mjetet e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve.

Si raste të veçanta:

SDR-të dhe ari financiar me marrëveshje janë mjete financiare, por nuk janë detyrime financiare të ndonjë njësie.

Mjetet financiare përfshijnë edhe pretendimet dhe detyrimet financiare ndërmjet njësisë të imponuara nga ligji.

Gjithashtu, SNA njeh mjetet financiare “fiktive” që nuk ekzistojnë ndërmjet njësisë institucionale, por që paraqesin kundërpartinë në transaksione speciale brenda strukturës së SNA-së. Këto përfshijnë:

- lizingun financiar;
- pretendimet ndaj jorezidentëve të njësisë rezidente “fiktive” që zotërojnë toka e ndërtesa; dhe
- kapitalin në ndërmarrjet e patrupëzuara jorezidente.

2.4.1.1.1 Përrjashtimi i instrumenteve me natyrë të pasigurtë.

Përkufizimi i SNA-së për instrumentet financiare përjashton instrumentet që janë të pasigurta ose të kushtëzuara nga ndodhja e disa ngjarjeve të caktuara. Si pasojë, përjashtohen një sërë instrumentesh si garancitë financiare, marrëveshjet financiare dhe pozicione të tjera të pasigurta.

Megjithatë, derivatet financiare dhe kontratat e tjera kontingjente për të cilat mund të llogaritet vlera, trajtohen si mjete financiare. Ekzistenca e vlerës së tregut për një instrument, që evidentohet nga tregtimi në bursë ose në tregjet dytësore aktive, është e mjaftueshme për ta quajtur instrumentin një mjet financiar. Vlera e instrumenteve mund të tregohet edhe duke përdorur mënyra të tjera matjeje. Për shembull për opsionet, të cilat edhe pse kanë natyrë kontingjente, vlerën mund ta tregojnë nëpërmjet kuotimit të tyre në treg ose me anë të primit të paguar për blerjen e tyre.

2.4.1.1.2 Përrjashtimi i mjeteve jo-financiare.

Mjetet financiare përjashtojnë kontratat që rezultojnë në lëvrimin e mallrave dhe të shërbimeve, përjashtuar rastet kur kontratat nënshkruhen për një lëvrim të ardhshëm të mallrave ose shërbimeve. Përjashtohen të gjitha mjetet jofinanciare si:

- kontratat tregtare ose të biznesit që rezultojnë në marrjen ose në lëvrimin e mallrave dhe shërbimeve, të cilat janë marrëveshje kontraktuale private dhe jo instrumente financiare.

- mjetet fizike, siç janë mjetet e inventarit, toka dhe burimet natyrore, strukturat dhe pajisjet kapitale.
- mjetet e paprekshme, siç janë patenta, markat ose emri i mirë.
- monedhat e arit, shufrat dhe kallëpet, përveç se kur ato mbahen si rezerva zyrtare nga autoritetet kombëtare.

2.4.1.1.3 Rregulli i dy palëve.

Instrumenti financiar ekziston vetëm ndërmjet dy njësive institucionale. Instrumentet financiare të përbëra, që përfshijnë disa instrumente të kombinuara në një duhen shpërbërë në instrumente të veçanta ku secili prej tyre të përfshijë dy njësi (palë) transaktore⁸.

2.4.1.1.4 Instrumente të tjera financiare.

Përkufizimi i mjeteve financiare në SNA është më i ngushtë se disa përkufizime të instrumenteve financiare të përdorura në standardet rregullatore dhe kontabilitetin financiar. Tabela 1 tregon marrëdhëniet ndërmjet mjeteve financiare të përkufizuara sipas SNA-së dhe një grupi me të gjerë të instrumenteve financiare.

Në SNA-në e vitit 1993 mjetet financiare përkufizohen si grup kontratash që janë të pakushtëzuara nga natyra dhe që u korrespondojnë llojeve të transaksioneve që njihen në strukturën e SNA-së. Mjetet financiare të njohura nga SNA 1993 ndahen nga mjetet e tjera financiare.

Një përkufizim më i gjerë i instrumenteve financiare, që përkufizohet në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të sistemeve rregulluese, përfshin të gjitha kontratat financiare që ekzistojnë midis njësive duke përfshirë garancitë, zotimet (marrëveshjet) dhe pozicionet e tjera jashtë bilancit.

⁸ Për shembull, një ndërmarrje merr një kredi nga një bankë që ka të bashkangjitur një opsion të marrë nga një tregtues valutash. Ekzistojnë dy instrumente financiare të ndryshme; (1) kredia, ndërmjet ndërmarrjes dhe bankës, dhe (2) opsioni ndërmjet ndërmarrjes dhe tregtuesit të valutave.

| | | | |
|----------------------------|---------------------------------------|--|--|
| Instrumentet financiare | Mjete financiare të SNA | Mjetet me kundërparti detyrime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Paraja dhe depozitat. 2. Letra me vlerë përveç aksioneve dhe instrumenteve të tjera të kapitalit. 3. Derivatet financiare. 4. Huatë. 5. Aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit. 6. Rezerva teknike të sigurimit. 7. Kredia tregtare. 8. Llogari të tjera të arkëtueshme/ të pagueshme. |
| | | Mjetet për të cilat nuk ekzistojnë Detyrime si kundërparti | Ari monetar. SDR-ja. |
| | | Mjete financiare “fiktive” | Marrëveshjet e Riblerjes. Lizingu financiar. |
| | Instrumente të tjera financiare | Garancitë | Letërkreditë. Garancitë e huave dhe letrave me vlerë. Garanci të tjera. |
| | | Marrëveshjet | Dokumente tregtare. Marrëveshje nënshkrimi dhe huaje. Zotime të tjera. |

Tabelë 1: Klasifikimi i zgjeruar i instrumenteve financiare.

2.4.1.2 Transaksionet financiare.

SNA 1993 përcakton që: “transaksionet financiare ndërmjet njësive institucionale dhe ndërmjet njësive institucionale dhe jorezidentëve, mbulojnë të gjitha transaksionet që sjellin ndryshimin e pronësisë së mjeteve financiare, duke përfshirë krijimin dhe likuidimin e detyrimeve financiare.”

SNA 1993 dallon midis

(i) transaksioneve në mjetet financiare,

- (ii) ndryshimeve në çmimin e tyre,
- (iii) ndryshimeve të tjera në vëllimin e mjeteve, dhe
- (iv) pozicioneve (gjendjeve).

Është e rëndësishme që të ndahen transaksionet ndërmjet mjeteve financiare nga ndryshimet e tjera në vlerën e tyre. Praktika e përdorimit të ndryshimit të pozicioneve në mjetet financiare për të matur transaksionet mund të jetë e gabuar për arsye të rivlerësimit, të fshirjeve, të riklasifikimeve dhe të ndryshimeve të tjera që nuk rrjedhin nga transaksionet.

Përkufizimi i SNA-së për transaksionet fokusohet në ngjarjet e mëposhtme:

- Akumulimi i mjeteve dhe i detyrimeve financiare që shoqërohet me huadhënie dhe huamarrje neto ndërmjet njësive. Njësitë që shpenzojnë më pak se të ardhurat e tyre korente kanë një tepicë fondesh, që mund t'u jepet hua njësive që shpenzojnë më shumë se të ardhurat e tyre.
- Investimet në mjete kapitali në të cilat një njësi përfiton ose ndryshon interesin e saj të pronësisë.
- Ndryshimet në përbërjen e mjeteve financiare në sajë të transaksioneve me mallrat dhe shërbimet. Transaksionet tregtare rezultojnë në kredi/borxh tregtar ndërmjet njësive, kur pagesa nuk është e menjëhershme ose kur pagesa i paraprin lëvrimit të mallrave dhe shërbimeve.
- Shkëmbimi i mjeteve financiare ndërmjet sektorëve ose krijimi i njëkohshëm i mjeteve dhe detyrimeve që eliminojnë njëri – tjetrin, të cilat ndryshojnë përbërjen e flukseve financiare dhe të pozicioneve financiare, por nuk ndryshojnë huadhënien dhe huamarrjen në përgjithësi.
- Përllogaritjet e pretendimeve dhe detyrimeve të tilla si dividendët dhe interesat e përllogaritur, ose qiratë dhe shpenzime të tjera.
- Ripagimi i një pjese apo e të gjithë principalit.
- Rishitja e instrumenteve monetare në tregjet sekondare.
- Maturimi i një instrumenti.

Në të kundërt, ngjarje të caktuara që rezultojnë në krijimin, në zhdukjen ose në ndryshime të tjera në kushtet e mjeteve dhe detyrimeve financiare nuk klasifikohen si “transaksione” brenda SNA-së 1993. Ato përfshijnë rivlerësimet të cilat janë ndryshime në vlerën e mjeteve financiare ekzistuese në sajë të ndryshimeve të çmimeve të tregut ose kurseve të këmbimit dhe të ndryshimeve të tjera në vëllimin e mjeteve, të cilat mbulojnë një rang situatash në të cilat mjetet hyjnë ose dalin nga sistemi, si dhe ndryshimet në klasifikimin e mjeteve dhe detyrimeve financiare.

2.4.2 Karakteristikat e instrumenteve financiare.

Kjo pjesë diskuton karakteristikat e instrumenteve financiare si një bazë për klasifikimin e tyre.

Instrumentet financiare klasifikohen mbështetur mbi përmbajtjen dhe karakteristikat e tyre dhe jo prej emrit apo prej formës ligjore. Emrat e përgjithshëm për instrumentet si “hua” dhe “depozita” mund të jenë të dyshimtë dhe mund të kenë kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme.

2.4.2.1 Matrica e karakteristikave të instrumenteve financiare.

Kjo pjesë paraqet një matricë të thjeshtë e lidhur me tre karakteristika bazë, të cilat përcaktojnë natyrën e marrëdhënieve financiare midis njësive. Matrica tregon se si tipet kryesore të instrumenteve financiare mund të klasifikohen në tre grupe të rëndësishëm.

(i) *Borxh përkundrejt kapitalit* – A krijon instrumenti një marrëdhënie kreditor/debitor midis njësive (borxh) apo përcakton një marrëdhënie pronësie midis njësive (kapital) ?

Instrumentet e borxhit, kërkojnë pagimin e detyrimeve financiare një njësie nga një njësi tjetër. E ardhura e gjeneruar nga instrumentet e borxhit, është interesi.

Instrumentet e pronësisë sigurojnë pronësi mbi një njësi, i japin të drejtën pronarit mbi një pjesë të fitimit, dhe sigurojnë një pretendim mbi pjesën e mbetur të aktiveve të një ndërmarrjeje pasi janë shlyer detyrimet. Dividentët janë të ardhurat e pronësisë.

(ii) *Instrumente të pagueshme të arkëtueshme përkundrejt instrumenteve të shkëmbimit* - A ekziston një marrëdhënie kreditor/debitor apo marrëdhënie pronësie midis njësive me një drejtim, apo ka shkëmbime reciproke të marrëdhënieve kreditor/debitor ose të pronësisë?

Instrumentet financiare të pagueshme dhe të arkëtueshme përfshijnë një marrëdhënie kreditor/debitor me një drejtim midis njësive, në të cilën një njësi ka një detyrim dhe njësia tjetër ka një mjet. Instrumentet si letrat me vlerë, huatë, depozitat aksionet etj. janë instrumente financiare të pagueshme, të arkëtueshme.

Instrumentet e shkëmbimit përfshijnë një marrëveshje për të tregtuar instrumentet financiare ndërmjet njësive, që nënkupton se çdo njësi ka si aktivin dhe pasivin. E drejta për të marrë një instrument financiar është një mjet, detyrimi për të lënë (hequr dorë) instrumentin tjetër financiar është një detyrim. Derivatet financiare dhe instrumentet jashtë bilancit janë instrumente shkëmbimi.

(iii) *Instrumentet kontingjente (të kushtëzuara) përkundrejt instrumenteve jokontingjente (të pakushtëzuara)* – A është pretendimi i kushtëzuar (që do të thotë i varur nga ndodhja e disa ngjarjeve të jashtme) apo është i sigurtë (jo i kushtëzuar)?

Instrumentet financiare kontingjente (ose të kushtëzuara) varen nga ndodhja e ngjarjeve në të ardhmen të cilat edhe mund të mos ndodhin: rasti përcakton nëse një transaksion do të ndodhë; drejtimin e pagesës dhe kushteve që rrethojnë pagesat dhe shlyerjet e detyrimeve sipas kontratës.

Instrumentet financiare jo të kushtëzuara varen vetëm nga kalimi i kohës.

2.4.2.2 Tregtueshmëria dhe transferueshmëria.

Tregtueshmëria.

Instrumentet e tregtueshme mund të shiten ndërmjet njësive. Ato kanë disa karakteristika:

- sigurojnë likuiditet për mbajtësin (pronarin), i cili mund t'i shesë ato me para në dorë;
- kanë një çmim tregu, i cili mund të matet nga transaksionet aktuale;

- luhatjet në çmimin e tregut ekspozojnë mbajtësin ndaj humbjeve ose fitimeve; dhe
- shumë prej tyre kanë kolateral ose garanci për ripagim për të siguruar që pranohen gjerësisht nga tregu.

Ekzistojnë shumë forma dhe shkallë të tregtueshmërisë, që varen nga tipi i instrumentit, pozicioni kreditor i akorduesit (dhënësit), kushtet teknike, mbështetja me kolateral dhe treguesit institucionalë të tregjeve financiare.

| Tabelë 4-2: Karakteristikat e instrumenteve financiare të përbashkët | | | |
|---|---|---|---|
| Tipi i kontratës | Instrumentet e borxhit | | Instrumentet e Pronësisë |
| | Jo i kushtëzuar (i sigurt) | I kushtëzuar (i pasigurt) | |
| Të arkëtueshme / Të pagueshme | Monedha dhe kartëmonedhat Huatë Obligacionet Depozitat Kreditë tregtare Çertifikatat e depozitave | | Aksionet Instrumentet e tjera të kapitalit |
| Shkëmbimi | Kontratat e ardhshme Kontratat me afat Swaps-et Marrëveshjet e normave Forward (FRA-s) Swaps-et e mallrave | Opsionet e tregtueshme Opsionet e patregtueshme Garancitë e huave | Dëftesat e kapitalit |

Tabela 2: Karakteristikat e instrumenteve financiare të përbashkët i klasifikojnë disa instrumente financiare sipas tre karakteristikave të përgjithshme.

Transferueshmëria.

Transferueshmëria do të thotë që një instrument ose fonde të vendosura në një instrument, mund të shiten ose të mobilizohen për përdorim në transaksionet e tregut ose për të shlyer detyrimet. Mekanizmat e transferimit përfshijnë, midis të tjerave, çeqet, urdhërxhirimet, transferimin elektronik të fondeve etj.

Depozitat pa afat të transferueshme ose mjetet e tjera të transferueshme mund të përdoren në transaksione dhe për të shlyer detyrimet; një transferueshmëri e tillë është një faktor kyç në analizat e parasë.

Depozitat e transferueshme në monedhë kombëtare janë konsideruar gjithmonë si instrumente monetare. Instrumentet e tjera financiare të emetuara nga ndërmjetësit financiarë që janë efektivisht të transferueshme duke përdorur mekanizmat e pagesave të pranuar gjerësisht, gjithashtu, mund të konsiderohen me natyrë monetare.

Risitë teknike kanë tentuar të ngrenë likuiditetin e kursimeve dhe të llogarive të depozitave afatgjata dhe kanë zbutur ndryshimin midis instrumenteve të transferueshme dhe të patransferueshme.

Si rezultat, agregatet e gjerë monetarë që përfshijnë instrumente që nominalisht kanë transferueshmëri të kufizuar, tregojnë lidhje më të mëdha me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik se sa agregatët e instrumenteve shumë të transferueshme.

2.4.2.3 Emërtimi i instrumentit.

Instrumentet e emërtuara në valutë të huaj duhet të identifikohen veçmas brenda secilës kategori instrumentesh. Instrumentet e emërtuara në valutë të huaj mund të sillen ndryshe nga instrumentet në monedhë të vendit, mund të përfshijnë lloje të ndryshme transaksionesh, të kenë ekspozime të ndryshme, të kenë norma interesi të ndryshme, dhe mund të jenë subjekt i rregullimeve të ndryshme.

Emërtimi i një instrumenti mund të mos lidhet me rezidencën e emetuesit të tij, dhe në shumë vende, rezidentët emetojnë instrumente të emërtuara në valutë të huaj. Emërtimi i një instrumenti dhe rezidenca e emetuesit nuk duhet të ngatërrohen për qëllime statistikore.

2.2.2.4 Maturimi i instrumentit.

Maturimi është kohëzgjatja deri sa një instrument financiar të ripaguhet, të maturohet ose të zgjidhet. Maturimi është i rëndësishëm për analizat dhe për vlerësimin e instrumenteve dhe influencën, midis të tjerave, në çështje të tilla si luhatshmëria e çmimeve të mjeteve, rrjedhja e parave, klasifikimi i mjeteve monetare dhe likuiditeti i institucioneve financiare. Informacioni mbi maturitetin mund të ndihmojë, gjithashtu, vlerësimin statistikor sepse institucione financiare të veçanta mund të specializohen në instrumente me maturime specifike.

- Maturimi origjinal është maturimi i një instrumenti që nga koha e emetimit të tij.
- Maturimi i mbetur është koha e mbetur deri në maturimin ose ripagesën e instrumentit.
- Maturimi i sjelljes është maturimi aktual i pritur duke patur parasysh kushtet specifike të instrumentit financiar, i cili mund të ndryshojë nga maturimi i përcaktuar origjinal. Për shembull, një obligacion mund të ketë një skedulë të kuponit me interesa në rritje, i cili efektivisht detyron emetuesin për të riblerë obligacionin përpara maturimit të tij.
- Kohëzgjatja (duration) është një matje statistikore e maturimit mesatar të ponderuar të një instrumenti financiar që merr në konsideratë skedulën për ripagesën e interesit të dhe principalit.

Ndryshimet midis këtyre maturiteteve janë shumë të rëndësishme. Maturimi origjinal përdoret në përkufizimin e mjeteve monetare, maturimi i mbetur përdoret për të analizuar nevojat për financim në të ardhmen dhe likuiditetin e institucioneve financiare.

2.4.2.5 Ripagimi dhe modeli rrjedhës.

Modeli për ripagimin e instrumenteve financiare dhe riinvestimi i të ardhurave në principal ndikojnë në mënyrë domethënëse kohëzgjatjen, sjelljen e tregut, çmimet (përcaktimin) dhe teknikat për të vlerësuar flukset dhe pozicionet. Modelet specifike për ripagimin e

instrumenteve financiare dhe kontabilizimin rrjedhës mund të ndikojnë dukshëm statistikat.

Ekzistojnë shumë modele ripagimi :

- instrumentet me amortizim të principalit gjatë gjithë jetës së instrumentit, në norma të ndryshme,
- instrumentet me një pagesë të vetme, e cila është një pagesë e vetme e principalit dhe e gjithë interesit në maturim,
- instrumentet që përfshijnë ripagesa të rëna dakord të të gjithë principalit të mbetur dhe interesave të akumuluar përpara maturimit të plotë të instrumentit,
- zero-kuponi, i cili është një instrument i shitur me skonto që nuk kryhen pagesa interesi gjatë jetës së tij dhe tërhiqet me vlerën nominale në maturim,
- skonto “e thellë” (deep discount), e cila është një instrument i ngjashëm me instrumentin zero-kupon, por që paguan një kupon të vogël interesi në baza të rregullta,
- instrumentet e përjetshme, në të cilat principalin nuk ripaguhet kurrë,
- opsionet CALL për kreditë, të cilat lejojnë huamarrësin të ripaguajë kredinë pa vendosur kufizim përpara datës së skadencës së nënshkruar,
- huatë që kthehen me kërkesë (call loans), të cilat janë të ripagueshme menjëherë kur e kërkon huadhënësi,
- indeksimi i principalit për të reflektuar inflacionin ose ndryshimet në normën e interesit etj.

2.4.2.6 Kushtet speciale.

Kolateralet dhe garancitë.

Kolaterali përbëhet nga mjetet financiare të cilat mbështesin një instrument financiar në rastin e një mospagese të këtij të fundit. Shumë mjete financiare kanë kushte që u kërkojnë debitorëve të ndryshëm të vendosin mjete financiare ose jofinanciare për të garantuar ripagesën, ose garanci nga të tretët. Kolaterali është i kushtëzuar; vendosja e mjeteve financiare si kolateral nuk është një transaksion financiar dhe nuk regjistrohet në llogaritë financiare.

Megjithëse të dhënat mbi kolateralet dhe garancitë nuk përdoren në llogaritë financiare, disa të dhëna shtesë mbi to janë të rëndësishme për të analizuar kushtet financiare kombëtare, veçanërisht nëse përfshihen garancitë e qeverisë ose të Bankës Qendrore.

Kontrolli.

Kontrolli nënkupton që ekzistojnë disa forma të marrëdhënieve të pronësisë ndërmjet njësive, zakonisht të përcaktuara nga zotërimi 10 për qind ose më shumë i aksioneve. Sjellja financiare mund të ndikohet nga kontrolli sepse transaksionet ndërmjet këtyre njësive, (1) mund të jenë subjekt i ligjeve rregulloreve, ose kërkesave raportuese të veçanta, (2) motivi i transaksioneve ndryshon në rastin e tyre, (3) dallimet ndërmjet borxhit dhe transaksioneve të kapitalit mund të zbehen në transaksionet e ndërmarrjeve të kontrolluara, dhe (5) në falimentim ose në situata financiare të veçanta mund të ekzistojnë të drejta ose detyrime të ndryshme ndërmjet njësive.

Të dhënat mbi bashkimet apo shkrirjet shpesh përdoren për qëllime të mbikëqyrjes bankare me qëllim konsolidimin e aktivitetit të një institucioni financiar kudo që zhvillohet. Të dhëna të veçanta mund të mblidhen për transaksionet dhe pozicionet ndërmjet njësive

që kontrollojnë njëra-tjetrën, veçanërisht në investimet ndërkombëtare, në ndërmarrjet e investimit direkt mbi degët financiare të kompanive jofinanciare dhe në depozitat ndërbankare.

Kufizimet dhe marrëveshjet.

Instrumentet financiare mund të mbartin disa kufizime të veçanta, të tilla që të kufizojnë mbajtjen ose emetimin e tipeve specifike të instrumenteve të bazuara në shtetësinë ose në sektorin ekonomik. Kufizimet mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në sjelljen e ndonjë tipi të veçantë instrumenti dhe përpluesit duhet të dokumentojnë ekzistencën e kufizimeve që ndikojnë interpretimin e serive statistikore.

Dy janë rastet ku informacioni mbi kufizimet ndikon klasifikimet statistikore të përdoura në këtë manual:

- Depozitat e kufizuara në Korporatat Depozituese identifkohen veçmas si një zë në vëmendje në Bilancin Sektorial të Korporatave Depozituese dhe Paraqitjen e Korporatave Depozituese sepse në to mungojnë karakteristikat e likuiditetit të depozitave të tjera.
- Kufizimet mbi përdorimin e mjeteve të huaja të Bankës Qendrore mund të pengojnë klasifikimin e mjeteve në rezervën ndërkombëtare zyrtare.

2.5 Mjetet dhe detyrimet; kategoritë.

2.5.1 Ari monetar dhe SDR.

Ari monetar dhe SDR, janë mjete rezervë të mbajtura nga banka qendrore ose nga autoritete të tjera. Ato nuk janë detyrim i asnjë njësie tjetër.

Ari monetar konsiston në arin bars, lingotë dhe monedhë me një pastërti prej të paktën 995/1000, nën pronësi ose nën kontrollin efektiv të bankës qendrore (qeverisë), që është pjesë e rezervës zyrtare të vendit.

Transaksionet në ar monetar bëhen vetëm ndërmjet autoriteteve monetare apo ndërmjet autoriteteve monetare dhe institucioneve ndërkombëtare.

Monetizimi i arit ndodh kur ari i blerë ose i nxjerrë nga minierat, i shtohet rezervave zyrtare, ndërsa demonetizimi i arit ndodh kur ari i rezervave u shitet subjekteve private.

Nga kjo kategori përjashtohen: ari jo i përdorur si pjesë e rezervës zyrtare, ari i mbajtur nga institucione të tjera financiare përveç bankës qendrore, mbajtjet e sektorëve joqeveritarë, dhe depozitat e emëruara në ar, të cilat trajtohen si depozita në një valutë të huaj çfarëdo. Ari jomonetar klasifikohet si mjet jofinanciar.

SDR janë mjete të rezervave ndërkombëtare të krijuara nga FMN, që u shpërndahen periodikisht vendeve anëtare në raport me kuotat e tyre. SDR mbahen vetëm nga autoritetet monetare dhe nga një numër i kufizuar institucioneve ndërkombëtare financiare dhe janë të transferueshme vetëm brenda për brenda këtij grupi.

SDR përfaqësojnë të drejta të pakushtëzuara për të marrë valutë të huaj ose mjete të tjera rezervë nga anëtarët e tjerë të grupit. SDR nuk janë detyrime të FMN. Vendet të cilave u janë shpërndarë SDR nuk kanë asnjë detyrim të pakushtëzuar për ti ripaguar SDR.

Transaksionet midis vendeve ose midis vendeve dhe FMN trajtohen si transaksione financiare.

Shpërndarjet e reja të SDR ose fshirjet trajtohen si ndryshime në vëllimin e mjeteve dhe jo si transaksione.

Vlera e SDR përcaktohet çdo ditë nga FMN e bazuar mbi një shportë monedhash. Shporta e monedhave dhe peshat e tyre rishikohen periodikisht.

Instrumentet e emetuar në SDR si për shembull depozitat në SDR, huatë apo letrat me vlerë nuk përfshihen këtu.

2.5.2 Monedha dhe depozitat.

Monedhat dhe kartmonedhat.

Në këtë kategori përfshihen mjetet në monedhë apo në kartmonedhë që mbahen si ruajtëse të vlerës dhe qarkullojnë si mjete pagese për të blerë mallrat dhe shërbimet ose për ripagesat e borxhit.

Monedhat dhe kartmonedhat janë detyrime të institucioneve financiare kombëtare si për shembull bankat qendrore. E drejta e bankës qendrore për të emetuar monedha dhe kartmonedha quhet “seigniorage”.

Disa nga arsyet e ndryshimit të stokut të monedhave dhe të kartëmonedhave në qarkullim janë:

- tërheqja e një pjese të kartëmonedhave/ monedhave të dëmtuara për t'i zëvendësuar me të reja;
- autoritetet mund të ndryshojnë stokun e parasë në qarkullim në përgjigje të ndryshimeve afatshkurtra, ose të ndryshimeve ciklike në mbajtjet e parasë nga publiku;
- ndryshime afatgjatë në mbajtjet e publikut mund të ndodhin në rastet e blerjeve ose shitjeve neto nga banka qendrore;
- monedhat dhe kartmonedhat mund të demonetizohen, domethënë të thirren ose të zëvendësohen.

Dallimi në statistikat monetare dhe financiare bëhet ndërmjet monedhave/kartëmonedhave kombëtare që janë detyrim i autoriteteve monetare kombëtare dhe monedhave/kartmonedhave të huaja, të cilat janë detyrime të autoriteteve të huaja monetare.

Monedhat dhe kartëmonedhat të cilat mbahen dhe tregtohen për shkak të vlerës së tyre numizmatike, nuk janë mjete financiare dhe klasifikohen si mjete jofinanciare.

Depozitat.

Depozitat janë fonde të vendosura në një bankë apo në një institucion të ngjashëm dhe janë një detyrim i institucionit financiar.

Depozitat janë të kërkueshme në para në dorë, në vlerë nominale plus interesin rrjedhës. Interesi rrjedhës trajtohet si të ishte riinvestuar në depozitë nga klienti.

Depozitat krijohen për të ruajtur fondet, për të akumuluar kursimet, për të fituar interesin dhe për të përfituar shërbime të tjera nga institucionet financiare si për shembull konvertimi i valutave, nënshkrimi i çqeve etj.

Depozitat e transferueshme.

Depozitat e transferueshme përfshijnë depozitat që janë:

- të këmbyeshme me kërkesë, në vlerë nominale, pa asnjë penalitet apo kufizim;
- të transferueshme lirisht me çek, urdhërpagesë;
- të përdorura gjerësisht si mjete pagese.

Depozitat e transferueshme janë pjesë e parasë së ngushtë pasi ato mund të përdoren si mjete pagese në transaksionet për mallra dhe shërbime. Gjithashtu, bankat kreditojnë duke krijuar një depozitë të transferueshme në emër të huamarrësit, e cila mund të përdoret lirisht për nënshkrimin e çqeve.

Emërimi i depozitës (valuta) duhet identifikuar çdo herë, duke ndarë depozitat e emëruara në monedhë vendase me ato në valutë të huaj.

Fondet e përbashkëta shpesh ofrojnë instrumente që për nga funksionet ngjajnë shumë me depozitat; mbi to mund të nënshkruhen çqe dhe konsiderohen si zëvendësuese të afërta të depozitave nga publiku.

Instrumentet e fondeve të përbashkëta me këto karakteristika, duhet të klasifikohen si depozita të transferueshme dhe të përfshihen në agregatët e parasë.

Në këtë kategori përfshihen gjithashtu çeqet për t'u mbledhur. Çeqet për t'u mbledhur duhet të identifikohen veçmas, me qëllim që të lejohet konsolidimi i bilanceve të korporatave depozituese.

Çeqet e papaguara pas një periudhe të arsyeshme sipas një praktike të caktuar, riklasifikohen si llogari të arkëtueshme.

Depozitat e tjera.

Depozitat e tjera konsistojnë në të gjitha pretendimet, përveç depozitave të transferueshme mbi korporatat financiare që kanë natyrën e depozitave.

Mund të përdoret gjithashtu një kategori e quajtur “depozita likuide” që përmban depozitat e patransferueshme që përfshihen në agregatët e parasë së ngushtë.

Kjo kategori përfshin:

- *Depozitat në të parë*, të cilat zakonisht përdoren për të tërhequr para për transaksionet. Ato mund të kenë likuiditet të lartë dhe të jenë përbërëse të parasë së ngushtë, dhe mund të përfshihen në nënkategorinë opsionale “depozita likuide”.
- Depozitat të cilat mund të përdoren lirisht për të siguruar likuiditet nëpërmjet tërheqjeve ATM. Ato, gjithashtu, mund të jenë pjesë e parasë së ngushtë dhe të përfshihen në nënkategorinë “depozita likuide”.
- Depozitat e kursimit dhe depozitat me afat, të cilat mund të tërhiqen vetëm pas një periudhe të caktuar kohe dhe mund të kenë kufizime që i bëjnë ato më të përshtatshme për kursim, sesa për t'i përdorur për transaksionet tregtare.
- Depozitat e patransferueshme në valutë të huaj.
- Kuotat në institucionet financiare si për shembull shoqëritë e kursim – kreditit që janë të tërheqshme me kërkesë
- Depozitat ndërbankare.
- Marrëveshjet e riblerjes me klientët nëse klasifikohen brenda përkufizimit kombëtar të parasë së gjerë.
- Depozita të tjera të bankave në bankën qendrore.
- Depozita të tjera të klientëve në institucionet financiare. Këtu përfshihen depozitat në formën e llogarive të garancive, të parapagimeve, depozitat për të mbuluar detyrime të pritura etj.

Rekomandohet që të jepet si zë në vëmendje depozitat e kufizuara (bllokuara) të cilat mund të mbahen në bankën qendrore, në bankat e nivelit të dytë etj.

2.5.3 Letrat me vlerë përveç aksioneve.

Letrat me vlerë janë instrumente të tregtueshme të cilat evidentojnë faktin që një njësi ka një detyrim për të paguar në para në dorë, në instrumente të tjera financiare apo në mjete të tjera me vlerë ekonomike.

Letrat me vlerë u sigurojnë likuiditet mbajtësve të tyre, të cilët mund t'i shesin ato në tregun sekondar. Blerësi i letrës me vlerë mund të ketë humbje ose fitime kapitale nga lëvizjet e vlerës së tregut të letrës me vlerë.

Në letrat me vlerë, përfshihen bonot, obligacionet, dëftesat e borxhit, çertifikatat e depozitave të tregtueshme, letrat tregtare, depozitat e tregtueshme, notat, mjetet nën titullizim, notat dhe bondet qeveritare.

Huatë e tregtueshme klasifikohen si letra me vlerë.

Letrat me vlerë mund të jenë:

- me kupon, të cilat bëjnë pagesa periodike të interesit në formën e kuponit;
- me amortizim, të cilat paguajnë pjesë të principalit gjatë jetës së instrumentit;
- me skonto ose me zero-kupon, të cilat shiten me një vlerë tregu më të vogël se vlera e tyre nominale dhe paguhen në vlerë nominale në fund të jetës së instrumentit;
- *deep – discount* (skonto e thellë), të cilat shiten me skonto të lartë, por paguajnë edhe një pjesë të vogël interesi.

Vlera e tregut e një instrumenti me skonto është e barabartë me vlerën prezente të skontuar të vlerës nominale, ku norma e skontos reflekton si normën e interesit të tregut, ashtu edhe aftësinë kredimarrëse të emetuesit. Instrumentet me skonto afatshkurtër quhen bono.

Letrat me vlerë të indeksuara janë instrumente në të cilat kuponi i interesit ose principal, lidhen me normën e inflacionit, me çmimin e një malli ose me indekse të tjera, me objektiv ruajtjen e fuqisë blerëse, ruajtjen e vlerës reale të kapitalit gjatë periudhave inflacioniste dhe fitimin e interesit.

2.5.4 Huatë.

Huatë përfshijnë të gjitha mjetet financiare të cilat :

- krijohen kur kreditorët u japin hua drejtpërsëdrejti debitorëve
- janë të patregtueshme ose për të cilat huadhënësi nuk merr asnjë letër me vlerë që të evidentojë transaksionin.

Kjo kategori përfshin të gjitha huatë dhe paradhëniet përveç kredive tregtare dhe llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme, të cilat klasifikohen në një kategori më vete.

Huatë zakonisht janë të patregtueshme pasi ato kanë karakteristika që ndryshojnë rast pas rasti. Ndërmjetësit financiarë u dedikojnë stafin dhe burimet e tyre vlerësimit të faktorëve të lidhur me huadhënien.

Nga ana tjetër, huatë janë një burim i mirë fondesh për njësitë të cilat nuk mund të emetojnë letra me vlerë, si për shembull individët, bizneset e vogla etj.

Veçantitë e çdo huaje e bëjnë të pamundur tregtimin e huave më pas në tregun sekondar, pasi blerësit potencialë nuk janë në gjendje të vlerësojnë besueshmërinë e kredimarrësit.

Huatë nën *titullizim* klasifikohen si letra me vlerë. Ato mbeten në bilancin e huamarrësit, por natyra e instrumentit ndryshon.

2.5.5 Aksionet dhe instrumentet e tjerë të kapitalit të vet.

Një instrument kapitali⁹ është një titull pronësie dhe i jep mbajtësit një pretendim mbi të ardhurën neto të një ndërmarrjeje dhe pjesën e mbetur në mjetet e saj pasi janë shlyer detyrimet.

⁹ Instrument kapitali ketu është përdorur në kuptimin kontabël për të treguar një titull pronësie dhe nuk i referohet instrumenteve të tregëtuara në tregun e kapitaleve.

Këtu përfshihen:

- aksionet e zakonshme;
- aksionet e preferuara të cilat përbëjnë pretendimet mbi mjetet e mbetura të një ndërmarrjeje me prioritet ndaj aksioneve të zakonshme;
- kapitali i pronarëve në thujse korporatat;
- kapitali i ekonomive familjare në ndërmarrjet e patrupëzuara;
- pjesët në fondet e përbashkëta;
- investimet e jorezidentëve në thujse korporatat rezidente (investimet në toka, në struktura dhe degët e investimit direkt) ,
- fitimi i pashpërndarë;
- rezervat e përgjithshme;
- shpërndarjet e SDR në rastin e bankës qendrore,
- rivlerësimet e mjeteve dhe të detyrimeve.

Investimet e huaja direkte mbulojnë korporatat dhe thujse korporatat në të cilat 10 për qind apo më shumë e kapitalit total është nën pronësinë e një investitori jorezident.

Rezervat teknike të sigurimit.

Rezervat teknike të sigurimit konsistojnë në (1) kapitalin neto të ekonomive familjare në fondet e pensionit dhe në kompanitë e sigurimit dhe (2) parapagimet e primeve dhe rezervat për pretendimet.

Kapitali neto i ekonomive familjare në kompanitë e sigurimit të jetës dhe në fondet e pensionit, konsiston në pretendimet e policëmbajtësve mbi mjetet që së fundi do t'u ripaguhen atyre, në daljen në pension ose me vdekjen e policëmbajtësit. Ato përbëjnë një formë kursimi të sektorit të ekonomive familjare dhe nuk konsiderohen si pjesë e vlerës neto të kompanisë së sigurimit apo fondit të pensionit. Primet dhe kontributet në plan mbahen për periudha të gjata nga kompanitë e sigurimit dhe nga fondet e pensionit dhe riinvestohen.

Parapagimet e primeve paguhen nga klientët në fillim të periudhës së mbuluar nga polica, dhe konsiderohen si të fituara nga kompania në baza rrjedhëse. Parapagimet e primeve janë një paradhënie për kompanitë e sigurimit nga policëmbajtësit.

Rezervat kundrejt pretendimeve janë fonde të lëna mënjanë nga kompanitë e sigurimit me qëllim kryerjen e pagesave të ardhshme klientëve. Deri sa përfitimet të paguhen kompanitë e sigurimit i mbajnë këto rezerva. Ato konsiderohen si detyrim i kompanive të sigurimit mbi mbajtësit e policave.

2.5.6 Derivatet financiare.

Një derivat financiar është një instrument financiar, i cili lidhet me një mjet të caktuar (instrument financiar, tregues ose mall), që ka një vlerë të derivuar nga çmimi i mjetit mbi të cilin nënshkruhet dhe nëpërmjet të cilit, rreziqet financiare specifike mund të tregtohen në tregjet financiare.

Derivatet janë instrumente financiare të veçanta, të cilat nuk kërkojnë patjetër pronësinë mbi mjetin mbi të cilin nënshkruhen dhe nuk gjenerojnë të ardhura interesi.

Derivatet financiare për të cilat mund të tregohet vlera, janë mjete financiare.

Në derivatet financiare përfshihen gjithnjë marrëdhëniet mjete - detyrime midis njësive. Duke qenë se derivatet janë “mjete shkëmbimi” ato lidhen me mjetet dhe me detyrimet e njësive. Vlera neto e pozicioneve në mjete dhe detyrime përfaqëson vlerën e derivatit, i cili ndryshon kur ndryshon vlera e mjetit dhe e detyrimit. Kjo vlerë ekziston pavarësisht nga fakti nëse derivati tregtohet në bursë apo në tregun mbi banak.

Nga ana tjetër, fakti që derivatet tregtohen në bursë apo në tregun mbi banak, tregon që ato kanë një vlerë tregu.

Derivatet financiare ndahen në dy klasa: kontrata *forwards* dhe *opsionet*.

Në një kontratë *forward*, e cila është e pakushtëzuar, dy palë bien dakord të shkëmbejnë një sasi të specifikuar të një mjeti (real ose financiar) me një çmim të caktuar në një datë të caktuar.

Në një opsion, blerësi blen të drejtën (pra ka një të drejtë por jo një detyrim) për të blerë ose për të shitur një mjet të caktuar me një çmim të caktuar, në një datë të caktuar ose përpara saj.

2.5.7 Llogari të tjera të arkëtueshme ose të pagueshme.

Kjo kategori përfshin:

- (1) kreditë tregtare për blerjen e mallrave dhe shërbimeve dhe paradhëniet dhe parapagimet për një punë në proces ose për shërbime, që do të kryhen në të ardhmen.

Shitja e mallrave dhe shërbimeve midis njësive përmban një pagesë nga blerësi tek shitësi, e cila mund të mos jetë e menjëhershme. Në këtë mënyrë, shitësi i akordon një kredi tregtare blerësit.

Kredia tregtare lind si nga vonesat në pagesë ashtu edhe nga politika të veçanta për të nxitur shitjet.

Huamarrja/kredia tregtare është e dallueshme pasi ajo është afatshkurtër, është e lidhur me një mjet të caktuar, dhe shpesh mbi të nuk aplikohet interesi. Nëse kredia tregtare jepet për afate më të gjata si për shembull 180 ditë, ajo ka karakteristikat e një huaje dhe mbi të aplikohet interesi.

Paradhëniet dhe parapagimet për mallrat dhe shërbimet gjithashtu, përfshihen në këtë nënkategori.

- (2) Llogari të tjera.

Kjo kategori përfshin të gjitha llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, të cilat lidhen më detyrimet për taksat, për dividendët, për pagat dhe shpërblimet e të tjera të ngjashme.

2.5.8 Mjetet jofinanciare.

Mjetet jofinanciare përfshijnë të gjitha mjetet e papërmendura më sipër. Ndër të përmenden mjetet e patrupëzuara, mjetet e trupëzuara që përdoren në veprimtarinë e përditshme, mjete të qëndrueshme të mbajtura për investime, mjete të qëndrueshme të mbajtur për operacionet e qiradhënies dhe mjetet e qëndrueshme në proces.

Mjetet e patrupëzuara përfshijnë të drejtën e qirasë, patentat tregtare, licencat, shpenzimet e nisjes së biznesit etj.

Mjetet e trupëzuara që përdoren për veprimtarinë e përditshme përbëhen nga pronat, aparatet dhe pajisjet që përdoren për veprimtarinë e përditshme.

Mjetet e qëndrueshme të cilat nuk janë dorëzuar ende dhe janë në proces ndërtimi, pagesat dhe paradhëniet në vijim për furnitorët lidhur me mjetet e qëndrueshme, të cilat ende nuk janë dorëzuar, përbëjnë kategorinë e fundit.

Ari jomonetar klasifikohet në mjetet jofinanciare.

2.5.9 Mjetet dhe detyrimet; raste të veçanta.

Më poshtë trajtohen disa instrumente të veçanta, të cilat përdoren shpesh nga institucionet financiare.

2.5.9.1 Marrëveshjet e riblerjes.

Marrëveshjet e riblerjes, janë kontrata në të cilat shitësi i një letre me vlerë, angazhohet të blejë të njëjtën letër me vlerë në një datë të caktuar, me një çmim të caktuar. Kjo kontratë përdoret nga shitësi për të siguruar fondet në këmbim të aktiveve gjatë një periudhe të shkurtër kohe, me synim rifitim të pronësisë mbi mjetin.

Nga ana tjetër, ky është një mjet që përdoret nga Banka Qendrore për të ndikuar mbi likuiditetin në sistemin bankar.

Marrëveshjet e riblerjes¹⁰ janë një mjet i Bankës Qendrore për të rritur likuiditetin në sistemin bankar.

Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes përdoren nga Banka Qendrore për të tërhequr likuiditetin nga sistemi bankar.

Ky transaksion nuk konsiderohet si nxjerrje e aktivitet jashtë bilancit, por si një hua e re e kolateralizuar dhënë shitësit nga blerësi.

Letrat me vlerë mbahen në bilancin e shitësit origjinal. Mbi shumën e marrë hua llogaritet interesi, i cili llogaritet si diferencë midis çmimit të transaksionit të dytë me transaksionin fillestar.

2.5.9.2 Huadhëniet e letrave me vlerë.

Huadhënia e letrave me vlerë përfaqëson një transaksion nën të cilin një njësi i jep hua disa letra me vlerë një njësie tjetër. Huadhënia e letrave me vlerë shpesh i lejon brokerat të mbulojnë pozicionet e shkurtra në letrat me vlerë ose të mbrojnë pozicionet në derivatet financiare.

Duke qenë se huadhënia e letrave me vlerë është afatshkurtër, mbajtësi origjinal i letrës me vlerë nuk e heq atë nga bilanci i tij dhe mund të mbajë edhe të drejtat lidhur me letrën me vlerë (interesat, dividendët).

Nga ana tjetër huamarrësi i letrës me vlerë ka detyrimin për të kthyer letrën me vlerë.

Ashtu si dhe në rastin e marrëveshjeve të riblerjes rekomandohen që huadhëniet në letra me vlerë që kolateralizohen me para, të klasifikohen si hua.

Në rastet kur huadhënia në letrat me vlerë kolateralizohet me letra me vlerë të tjera, aktivitetet regjistrohen jashtë bilanci.

¹⁰ Në terminologjinë e përdorur termi “marrëveshje e riblerjes” shikohet nga pikëpamja e bankave Para Depozituese dhe jo nga pikëpamja e Bankës Qendrore.

2.5.9.3 Swaps-et e arit.

Një *swap* në ar midis dy autoriteteve monetare është një shkëmbim i përkohshëm i arit për depozita në valutë të huaj, që do të prapësohet në një datë të caktuar me një çmim të caktuar. Kjo bëhet zakonisht për të rritur rezervat zyrtare.

Në një *swap*, kontrolli efektiv mbi arin mund të mos transferohet dhe mund të shihet si një instrument i ngjashëm me marrëveshjet e riblerjes. Në këtë rast, vendi që ka arin merr një depozitë në valutë të huaj e cila rrit rezervën e tij zyrtare.

Vendi i cili siguron depozitat fiton një pretendim, i cili klasifikohet si hua. Huatë zakonisht nuk trajtohen si pjesë e rezervës, por mund të përfshihen nëse bëhet fjalë për një *swap* afatshkurtër ose nëse fondet mund të jenë të përdorshme në rast nevojë për bilancin e pagesave.

2.5.9.4 Titullizimi.

Titullizim (securitization) quhet transformimi i huave bankare dhe i mjeteve të tjera të patregtueshme, në letra me vlerë të tregtueshme, të cilat mund t'u shiten investitorëve. Letrat me vlerë të ofruara për shitje, mund të riblihen nga institucione të tjera depozituese ose nga investitorë jobankarë. Shitësi nuk mbart asnjë rrezik humbjeje nga mjetet e transferuara dhe nuk ka asnjë detyrim ndaj blerësit nëse huamarrësi nuk paguan apo nëse çmimi në treg i letrës me vlerë ndryshon.

Mund të bëhet ose duke shitur instrumentin origjinal të patregtueshëm me një garanci pagese, ose duke shitur mjetin ose portofolin e mjeteve tek një kompani transportuese e ngritur posaçërisht, e cila më pas shet letrat me vlerë të reja që përfaqësojnë pjesë në portofol.

Për shembull, financimi i korporatave nëpërmjet notave me interes të luhatshëm ose Eurocomercial paper, duke zëvendësuar huatë bankare me një formë tjetër huamarrjeje është një formë e titullizimit (securitization).

Nëpërmjet këtij procesi, në kushte të caktuara, institucionet financiare mund të heqin mjetet financiare nga bilanci, duke rritur normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, ose duke dhënë hua të tjera me mjetet që rezultojnë nga shitja e letrave me vlerë.

Ky proces, efektivisht bashkon tregun e kredisë (si për shembull tregun e kredisë hipotekare) me tregun e kapitalit, duke qenë se huatë bankare riorganizohen në letra me vlerë të kolateralizuara nga hipotekat, kartat e kreditit, mjetet nën "lizing" ose lloje të tjera detyrimesh kredie.

Duke qenë se në këndvështrimin e bankës investitorët janë mbajtësit e fundit të obligacioneve të krijuara nga huaja bankare, industria bankare ka nxitjen të veprave më shumë si shitëse e mjeteve, sesa si huadhënëse portofoli, ku të gjitha huatë e dhëna do të mbaheshin në portofol.

Securization, gjithashtu, rivendos përkufizimin bankar të cilësisë së mjeteve dhe standardet e nënshkrimit të huave, sepse huadhënësit do të jenë të interesuar në cilësinë

e huasë më tepër në terma të tregtueshmërisë së tyre në tregjet e kapitalit, sesa në terma të ripagimit të detyrimeve nga huamarrësit.

2.5.9.5 Transferimi (Defeasance) dhe transferimi në substancë.

Transferimi është një teknikë për të larguar detyrimet financiare nga bilanci i një njësie duke krijuar një trust të veçantë që (1) merr përsipër përgjegjësitë dhe (2) mban një portofol të mjaftueshëm mjetesh për të mbuluar të gjitha detyrimet. Qeveritë dhe ndërmarrjet angazhohen në këtë veprim me qëllim që të ndryshojnë bilancet e publikuara dhe efektivisht të largojnë ndikimin e mjeteve dhe detyrimeve nga flukset e tyre të arkës dhe nga të ardhurat dhe shpenzimet. Për shembull, obligacionet e transferuara dhe mjetet me vlerë të barabartë me to largohen nga bilanci i një ndërmarrjeje dhe vendosen në një trust. Në bilanc nuk regjistrohen më detyrimet dhe shpenzimet e interesit do të reduktohen. Megjithëse këto obligacione vazhdojnë të mbeten si obligacione nominale të ndërmarrjes, ato *de-facto* janë transferuar në llogaritë financiare të trustit dhe nuk kanë më efekt në flukset e arkës, në operacionet e ndërmarrjes apo të qeverisë që i ka emetuar ato.

Transferimi i detyrimeve është një marrëveshje formale midis njësive, për të transferuar mjetet dhe detyrimet në një trust, i cili njihet si një njësi e veçantë institucionale, që klasifikohet në nënsektorin e ndërmjetësve të tjerë financiarë si një "kompani transportuese". Gjithë mjetet dhe detyrimet sipas këtij veprimi formal regjistrohen në bilancin e trustit ose të një njësie tjetër, që mban instrumentin e transferuar. Si rrjedhim, kjo rezulton në transferimin e mjeteve dhe detyrimeve midis njësive dhe jo në një zhdukje të instrumenteve.

Transferimi në substancë, në të kundërt nga transferimi, bëhet vetëm me iniciativën e debitorit që përpiqet të transferojë *de-facto* rreziqet dhe detyrimet që shoqërojnë detyrimet financiare. Mbajtësi i obligacionit mund të mos jetë i ndërgjegjësuar për krijimin e një trusti. Ky veprim, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk largon përgjegjësinë përfundimtare për të plotësuar detyrimet sipas një instrumenti financiar. Kështu, rekomandohet që transferimi në substancë, të mos njihet si transaksion financiar. Si rrjedhim, detyrimet dhe mjetet mbeten në bilancin e ndërmarrjes, të qeverisë ose të një njësie tjetër që përpiqet të transferojë riskun apo ndonjë detyrim tjetër në substancë. Megjithatë, shënimet në fund të fletëve apo në dokumente të tjerë duhet të tregojnë tipet e instrumenteve dhe sasinë e përfshira në veprimin e mësipërm, me qëllim që të lejojnë analizën e llogarive pa mjetet dhe detyrimet e transferuara.

Transferimi krijon probleme në raportimin statistikor, sepse mjetet dhe detyrimet efektivisht largohen nga llogaritë financiare të institucioneve raportuese dhe vendosen në truste që ka të ngjarë të mos ofrojnë raportim statistikor. Gjithashtu, nuk ekziston ndonjë marrëveshje ndërkombëtar për standardet e raportimit.

Rekomandohet që për qëllime statistikore detyrimi për të raportuar mjetet dhe detyrimet e transferuara dhe transferimin e rreziqeve apo ndonjë detyrimi tjetër qëndron në njësinë që i ka larguar detyrimet e saj dhe jo në trustin apo njësinë tjetër, të krijuar për këtë qëllim.

2.6 Gjendjet, flukset dhe rregullat e kontabilizimit; konceptet kyçe.

Ky kapitull përshkruan rregullat e kontabilizimit, të vlerësimit dhe të trajtimit statistikor të transaksioneve dhe pozicioneve financiare.

2.6.1 Gjendjet dhe flukset financiare.

Sipas përkufizimit të SNA 1993:

- Flukset financiare janë veprime ekonomike ose ndryshime që ndodhin brenda një periudhe të caktuar kohe.
- Gjendjet janë pozicionet në mjetet financiare dhe detyrimet në një moment kohe të dhënë.

Ndryshimi në vlerën e gjendjeve midis dy periudhave është i barabartë me shumën e disa lloje fluksesh: transaksionet, rivlerësimet dhe ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve financiare.

| | |
|---|---------------------------------|
| Ndryshimet e pozicioneve në mjetet financiare | |
| Pozicioni në fillim të periudhës | |
| Transaksionet | |
| Rivlerësimet | Ndryshimet në çmim |
| | Ndryshimet në kursin e këmbimit |
| Ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve financiare | |
| Pozicioni në fund të periudhës | |

Pozicionet në fillim të periudhës, përmbajnë vlerën e gjendjeve të mjeteve financiare dhe detyrimeve në fillim të një periudhe kontabile, e cila mund të jetë një vit, një muaj ose një tremujor.

Transaksionet përfshijnë krijimin, shlyerjen, blerjen dhe të gjitha ndryshimet në pronësinë e mjeteve financiare nëpërmjet kontratave të dyanshme.

Rivlerësimet përfshijnë ndryshimin në vlerën e mjeteve financiare, që rrjedhin nga ndryshimet në çmimet e tyre. Rivlerësimet ndahen në:

- ndryshime të çmimit të tregut: ndryshime në çmimin e tregut të mjeteve financiare
- ndryshime në kursin e këmbimit: ndryshime në vlerën e mjeteve të emetuara në valutë të huaj kur shprehen në monedhën vendase, për shkak të kursit të këmbimit.

Ekzistenca e llogarisë së rivlerësimit lehtëson analizën e pasojave ekonomike të ndryshimit në çmimet e instrumenteve financiare, të cilat janë të rëndësishme në shumë kontekste:

- ato përdoren për të matur ndryshimet në vlerën neto të sektorëve;
- ndryshimet relative në çmimet e mjeteve financiare shkaktajnë ndryshime në portofolin e bizneseve dhe të ekonomive familjare;
- ndryshimet në kurset e këmbimit shkaktajnë ndryshime në vlerën neto midis rezidentëve dhe jorezidentëve ose midis grupeve të ndryshme të rezidentëve kur

rezidentët mbajnë valutë të huaj apo mjete financiare të emërtuara në valutë të huaj;

- standardet ndërkombëtare të mbikqyrjes bankare mbulojnë rreziqet e institucioneve financiare të lidhura me ndryshimin në çmimet e tregut të instrumenteve financiare;
- ndryshimet në çmimet e tregut të mjeteve financiare ndikojnë në vlerën e tyre për t'u pëdorur si kolateral.

Ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve financiare regjistrojnë (1) ngjarje të zakonshme ose të jashtëzakonshme që shkaktojnë hyrjen/daljen e mjeteve financiare dhe detyrime nga sistemi dhe (2) riklasifikimet statistikore dhe axhustimet të cilat mund të prekin seritë kohore.

Flukse të rëndësishme financiare në këtë llogari përfshijnë:

- monetizimin dhe demonetizimin e arit;
- alokimin dhe anulimin e SDR;
- humbjet katastrofike të mjeteve financiare;
- migrimin e njerëzve jashtë kufijve kombëtare së bashku me valutën dhe instrumentet e tjera financiare;
- ndryshime në natyrën e institucioneve financiare (privatizime, ndryshime në natyrën e aktivitetit primar, shkrirjet, bashkimet etj.);
- ndryshimet në kufijtë e një vendi;
- riklasifikimet e instrumenteve financiare;
- ndryshimin e mbulimit të statistikave;
- braktisjen e njëanshme të një pretendimi etj.

Pozicioni në fund të periudhës është vlera e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve në fund të një periudhe kontabile, e cila është e barabartë me gjendjen në fillim plus ndryshimet që rrjedhin nga transaksionet, nga rivlerësimet dhe nga ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve.

2.6.2 Vlerësimi i mjeteve financiare dhe detyrimeve.

Gjendjet e mjeteve financiare dhe detyrimeve vlerësohen me vlerën e tregut në datën që raportohet bilanci;

- për mjetet financiare që tregtohen në treg përdoret vlera e tyre e tregut.
- mjetet e tjera financiare zakonisht vlerësohen me vlerën e principalit plus interesat e përlogaritur.

Transaksionet në mjetet financiare dhe detyrimet regjistrohen me çmimin e ekzekutimit të transaksionit.

Të gjitha gjendjet, transaksionet dhe flukset e tjera shprehen në njësi monetare:

- transaksionet, pagesa për të cilat është bërë në *cash*, regjistrohen me shumën e paguar;
- instrumentet financiare të paguara me anë të instrumenteve të tjera financiare, vlerësohen në bazë të çmimit korent të tregut të instrumentit me të cilin është bërë pagesa;
- vlera e gjendjeve përfshin ndryshimet në vlerë për shkak të interesit rrjedhës gjatë periudhës kontabël;

Nëse nuk është e mundur të gjendet vlera e tregut për instrumentet, përdoren disa metoda për llogaritjen e "fair value", e cila përafron vlerën e tregut të instrumentit.

Një mënyrë, është të merren parasysh çmimet në instrumentet me karakteristika të ngjashme (maturiteti, rreziku etj.) dhe mënyra tjetër është të skontohe pagesat e ardhshme. Për skontimin e flukseve të ardhshme përdoret norma e interesit të tregut (norma korente ose e pritur).

Vlera e tregut të instrumentit i referohet vetëm çmimit të vetë instrumentit, duke përfshirë komisione, taksa etj., të cilat në thelb paraqesin tjetër lloj fluksi dhe me tjetër destinacion.

Vlerësimi i detyrimeve financiare duhet të jetë i njëjtë me atë të mjeteve financiare, përndryshe kjo mund të shkaktojë një gabim të lartë konsolidimi, kur konsolidohen sektorët.

Për mjetet e emëruara në valutë të huaj, vlerësimi bëhet me kursin e ditës së raportimit të bilancit për gjendjet dhe me kursin e ditës së kryerjes së transaksioneve për transaksionet.

Për instrumentet financiare, në veçanti letrat me vlerë dhe depozitat, që kanë kuponat e interesit ose principalin të indeksuar me normën e inflacionit, çmimin e një malli apo një indeksi tjetër çfarëdo, pagesat e indeksimit si të principalit ashtu edhe të interesit, trajtohen si interes.

Standardi për vlerësimin e arit monetar është çmimi i tregut. Si element shtese jepet edhe gjendja fizike e arit në onz.

Gjendjet dhe transaksionet në ar jomonetar jepen gjithnjë në çmim tregu. Transaksionet e monetizimit dhe të demonetizimit të arit vlerësohen me çmimin e transaksionit të rënë dakord nga palët.

2.6.3 Koha e regjistrimit të transaksioneve.

Koha e regjistrimit në instrumentet financiare mbështetet në dy parime:

- transaksionet regjistrohen në baza rrjedhëse;
- të dyja palët në një transaksion financiar i regjistrojnë transaksionet në të njëjtën kohë.

Kontabilizimi rrjedhës.

Kontabiliteti rrjedhës i regjistron flukset në momentin që një vlerë ekonomike krijohet, transformohet, shkëmbehet, transferohet apo zhduket.

Kontabilizimi rrjedhës ndjek gjendjen kumulative të mjeteve financiare që janë krijuar, por që nuk janë zhdukur akoma me anë të pagesave në *cash* apo të mjeteve të tjera.

Kontabilizimi rrjedhës është një standard i përgjithshëm për llogaritë kombëtare. Rregullat e kontabilizimit rrjedhës për instrumentet financiare përfshijnë :

- krijimi dhe maturimi i instrumenteve ndodh në momentin që ndodh ndryshimi i pronësisë, që do të thotë, kur të drejtat, detyrimet dhe rreziqet e lidhura me instrumentin trupëzohen apo hiqen nga bilanci kontabël i një njësie;

- blerja dhe shitja në tregun sekondar regjistrohen në momentin e ndërrimit të pronësisë, i cili është momenti kur të drejtat, detyrimet dhe rreziqet e lidhura me instrumentin trupëzohen apo hiqen nga llogaritë financiare të një njësie;
- instrumentet me amortizim, zakonisht bien në vlerë me kalimin e kohës dhe amortizimi njihet në momentin që ndodh;
- interesat e përlllogaritur aktiv dhe pasiv rrjedhin me kalimin e kohës në çdo periudhë kontabël dhe norma me të cilën është llogaritur interesi është norma me të cilën është emetuar instrumenti.
- instrumentet me diskaunt si bonot, letrat tregtare dhe obligacionet zero kupon krijojnë interes të përlllogaritur, të barabartë me diferencën e vlerës së instrumentit mes dy periudhave kontabël;
- kredia dhe borxhi tregtar regjistrohen në kohën kur ndodh transaksioni në mallin e lidhur me të;
- parapagimet e primeve të sigurimit amortizohen gjatë jetës së policës;
- detyrimet për taksat shkaktohen në momentin e kryerjes së transaksioneve të taksueshme të lidhura me to, ose në kohën e rrjedhjes së flukseve që shkaktojnë taksat (si për shembull fitimi i të ardhurave të taksueshme).
- transaksionet financiare të cilat kërkojnë vendime specifike për shpërndarjen e të ardhurave dhe për kryerjen e transfertave, nuk regjistrohen në baza rrjedhëse, por në momentin që deklarohen si të pagueshme;
- Dividentet nuk rrjedhin gjatë periudhës kontabël, por regjistrohen në kohën që deklarohen. Deklarimi krijon një detyrim financiar që përmbushet kur dividendët paguhen.
- Tërheqjet e të ardhurave nga thujse korporatat dhe transfertat e ndryshme vullnetare regjistrohen në momentin e transferimit. Mbi instrumentet e borxhit, të cilat kanë pagesa të vonuara, por që nuk janë hequr nga bilanci si të pambledhshme, llogaritet interesi i përlllogaritur.

Regjistrimi i njëkohshëm i transaksioneve.

Transaksionet në instrumentet financiare duhet të regjistrohen mbi bazën e ndryshimit të pronësisë në të njëjtën kohë në llogaritë e të dyja palëve të përfshira. Kjo parandalon shmangiet ndërmjet llogarive dhe siguron që të drejtat, detyrimet dhe flukset e të ardhurave të pronësisë të lidhura me instrumentin i atribuohen vetëm një grupi njësisish institucionale.

Meqë në praktikë nuk është gjithmonë e mundur që palët të regjistrojnë njëkohësisht transaksionet për shkak të varësisë së postës, të kohës së ndryshme të punës dhe me kontabilizimin në baza arke të disa njësive, nevojitet të bëhen disa axhustime në llogaritë financiare të disa njësive, për të patur të njëjtën datë transaksioni (për rrjedhojë gjendje) në instrumentet financiare.

2.6.4 Agregimi, Konsolidimi, Netimi.

Agregimi është mbledhja e të dhënave për të gjitha njësitë apo instrumentet brenda një grupi.

Konsolidimi eliminon pozicionet dhe transaksionet midis njësive brenda një grupi dhe shumon pozicionet dhe transaksionet e tyre me pjesën e mbetur të ekonomisë dhe me jorezidentët.

Netimi i referohet veprimit të zbritjes së transaksioneve/ pretendimeve të një kategorie me transaksionet me kah të kundërt/ detyrimet e të njëjtës kategori.

Agregimi.

Agregimi është mbledhja e të dhënave për të gjitha instrumentet, duke përfshirë transaksionet dhe pretendimet/detyrimet midis anëtarëve. Të dhënat për sektorët individualë agregohen në industri, në sektorë ekonomikë dhe në ekonomitë kombëtare.

Agregimi i thjeshtë i të dhënave është i përshtatshëm për analizën e sjelljes së grupeve ekonomike, sepse transaksionet brenda për brenda grupit janë të përfshira. Njësitë marrin vendime financiare në lidhje me strukturën e bilanceve të tyre në bazë të të gjitha transaksioneve me njësi të tjera, duke përfshirë edhe ato brenda të njëjtit grup statistikor: agregimi i të dhënave në nivel mikro, mundëson të njëjtën lloj analize në nivel industrie, sektori, apo nivel kombëtar. Agregimi i të dhënave është veçanërisht i rëndësishëm për analizën e sjelljes financiare të ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve të biznesit.

Konsolidimi.

Konsolidimi është eliminimi i pozicioneve dhe transaksioneve midis njësive brenda të njëjtit grup dhe mbledhja e pozicioneve dhe transaksioneve të tyre me pjesën tjetër të ekonomisë dhe jorezidentët.

Konsolidimi eliminon marrëdhëniet debitor–kreditor midis pjesëve të një organizate, midis njësive brenda një sektori apo nënsektori ose midis të gjitha njësive rezidente të një vendi.

- Për shembull, konsolidimi i sektorit financiar rezulton në eliminimin e të gjitha pozicioneve dhe transaksioneve ndërsektoriale midis ndërmjetësve financiarë dhe ndihmësve financiarë, dhe siguron një regjistrim të transaksioneve të sektorit financiar me pjesën e mbetur rezidente të ekonomisë dhe me jorezidentët. Shkalla e konsolidimit ndikon në vëllimin e pozicioneve dhe të transaksioneve financiare në një ekonomi. Statistikat monetare bazohen në konsolidimin e llogarive të njësive brenda nënsektorit të korporatave depozituese.
- Konsolidimi për të gjithë ekonominë siguron një regjistrim të transaksioneve të ekonomisë me jorezidentët. Konsolidimi prokuron bazat për statistikën e bilancit të pagesave.

Konsolidimi i pjesëve të një organizate bashkon llogaritë e njësisë mëmë me llogaritë e degëve të saj. Për qëllime të statistikave monetare dhe financiare konsolidohen vetëm njësitë rezidente.

Konsolidimi i sigurimeve shoqërore.

Sigurimet shoqërore janë shpesh nga mbajtësit më të mëdhenj të mjeteve financiare të një ekonomie. Sigurimet shoqërore janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, por mund të përdoren dy mënyra nënsektorizimi. Trajtimi i tyre ndikon në vëllimin e mjeteve financiare brenda një ekonomie.

Sipas mënyrës së parë, sigurimet shoqërore nënsektorizohen veç Qeverisë Qendrore dhe niveleve të tjera të qeverisë. Transaksionet dhe pozicionet midis qeverisë dhe sigurimeve shoqërore regjistrohen në llogarinë financiare. Për shembull mbajtjet e instrumenteve të borxhit qeveritar nga sigurimet shoqërore nuk netohen në emetimin e borxhit qeveritar. Në mënyrë të ngjashme, kontributet e papaguara të njësive të qeverisë për punonjësit, klasifikohen si pretendime financiare të sigurimeve shoqërore ndaj qeverisë dhe janë pjesë e borxhit qeveritar.

Sipas mënyrës së dytë, sigurimet shoqërore konsolidohen në nivelin e përshtatshëm të qeverisë. Borxhi i qeverisë së përgjithshme reduktohet nga mbajtjet e letrave me vlerë të sigurimeve shoqërore dhe rritet me borxhin e sigurimeve shoqërore. Mbajtjet e instrumenteve të borxhit qeveritar nga sigurimet shoqërore duhen paraqitur si zëra në vëmendje.

Netimi.

Netimi është procesi i zbritjes së pretendimeve të një kategorie nga detyrimet e të njëjtës kategori. Netimi mund të jetë i niveleve të ndryshme:

- të mos ketë netim dhe çdo gjë të regjistrohet në bazë bruto, pra të gjitha blerjet dhe shitjet e mjeteve financiare të regjistrohen në baza bruto;
- netimi për instrumente financiare specifike, i blerjeve dhe gjendjeve të mjeteve dhe shkaktimit apo shlyerjes së detyrimeve ose ndryshe “netimi sipas instrumenteve”;
- netimi për një kategori instrumentesh financiare, i blerjeve dhe gjendjeve të mjeteve dhe shkaktimit apo shlyerjes së detyrimeve ose ndryshe netimi sipas kategorive;
- netimi i transaksioneve në mjete me transaksionet në detyrime me të njëjtin instrument apo kategori, ose ndryshe “transaksionet në baza neto”;
- netimi i një grupi të kategorive të mjeteve kundrejt detyrimeve të të njëjtit grup si për shembull, një industri apo sektor, ose ndryshe “sektorizimi në bazë neto”.

Mbledhja dhe publikimi i të dhënave për qëllime të statistikave monetare dhe financiare bëhet në dy nivelet e para të netimit.

Të dhënat në nivelin e parë të netimit, janë të nevojshme kur emetimet ose shlyerjet e instrumenteve financiare, bëhen në kushte të veçanta (norma interesi të veçanta apo karakteristika të tjera që duhen monitoruar).

Statistikat monetare dhe financiare, si dhe statistikave të qeverisë, përdorin nivelin e dytë të netimit dhe në ndonjë rast nivelin 1 (pa netim). Në paraqitjen e parasë së gjerë përdoret niveli i dytë i netimit. Gjithashtu, në një pasqyrë fluksesh të fondeve do të ishte i përshtatshëm niveli 2 i netimit, pasi ai tregon ndryshimet në përdorimin e instrumenteve financiare specifike, informacioni i cili është i nevojshëm në analizën e evolucionit të tregjeve financiare.

Detyrimet ndërbankare neto (niveli 4), janë një përjashtim i rregullit. Pretendimet dhe detyrimet ndërbankare neto, mund të jenë shumë të luhatshme në varësi të shkallës së gjerë të operacioneve të kliringut dhe të ndryshimeve në pozicionet në mjete dhe detyrime.

2.7 Agregatët monetarë.

Kapitulli mbulon çështje kyçe në lidhje me ndërtimin e agregatëve të parasë, kredisë dhe borxhit. Në pjesën e parë përshkruhen tre dimensione të agregatëve monetarë.

Pjesa e dytë ka të bëjë me përshkrimin e agregatëve si paraja e gjerë, baza monetare dhe agregatet e likuiditetit. Në pjesën e fundit përshkruhen agregatët e kreditit dhe të borxhit.

Tre dimensionet e agregatëve monetarë janë: (1) mjetet financiare, që janë përbërës të agregatëve monetarë, (2) sektorët që mbajnë paranë dhe (3) sektorët që emetojnë paranë. Në të njëjtën mënyrë, agregatët e kredisë dhe borxhit kanë këto tre dimensione: (1) mjetet financiare që janë përbërëse të agregatëve të kredisë, (2) sektorët që japin kredi dhe (3) sektorët që marrin kredi.

Korporatat Depozituese janë të vetmet emetuese të parasë në disa vende, ndërsa në disa të tjera agregatët monetarë mund të përfshijnë detyrime të njëjësive institucionale jashtë sektorit të korporatave financiare, si për shembull nga qeveria.

2.7.1 Tre dimensione të agregatëve monetarë.

Çdo përbërës i agregatëve monetarë pavarësisht nga kontekstet kombëtare ka tre dimensione bazë: (1) llojin e mjetit financiar, (2) sektorin që e mban, (3) sektorin që e emeton.

Llojet e mjeteve financiare.

Paraja ka katër funksione bazë :

- mjet këmbimi – mjeti për të blerë mallra, shërbime dhe mjete financiare,
- ruajtëse e vlerës;
- njësi matjeje – si standard për vendosjen e çmimeve në mallra dhe shërbime dhe mjet për krahasimin e vlerave dhe përgatitjen e pasqyrave financiare;
- standard i pagesave të mëvonshme – mjet për përcaktimin e vlerave të tashme dhe të ardhme në kontratat financiare.

Paraja, në formën e shumë mjeteve financiare mbahet për t'u përdorur si mjet këmbimi, si matëse e vlerës ose për të dyja së bashku. Në ndërtimin e agregatëve të parasë është e nevojshme të vlerësohet *moneyness* (shkalla e të qenurit para) e mjeteve financiare, duke matur shkallën në të cilën një mjet financiar prokuron likuiditet dhe shërben si ruajtës i vlerës.

Likuiditeti i referohet aftësisë së një mjeti financiar për t'u shitur në çdo moment, pa humbje të konsiderueshme të vlerës. Mjetet financiare më likuide janë paratë në dorë dhe depozitat e transferueshme.

Përzgjedhja e mjeteve financiare që duhen përfshirë në agregatët e parasë së gjerë reflekton lidhjen e zhdrejtë midis likuiditetit dhe aftësisë së mjetit për të ruajtur vlerën reale. Megjithatë të gjitha mjetet financiare e ruajnë vlerën nominale, ato ndryshojnë shumë nga shkalla në të cilën vlera e tyre reale u përgjigjet ndryshimeve të çmimeve apo të normave të interesit në ekonomi. Mjetet financiare të cilat rrisin vlerën e tyre nominale nëpërmjet fitimit të interesit, të kuponit etj. mbahen për aftësinë e tyre për të ruajtur vlerën reale.

Paraja në dorë dhe depozitat e transferueshme shpesh përbejnë atë që quhet para e ngushtë. Likuiditeti dhe aftësia e tyre për t'u përdorur si mjet këmbimi lindin nga këto karakteristika:

- *Tender ligjor ose i pranuar gjerësisht.* Paraja në dorë pranohet për pagesa të brendshme për shkak të statusit të saj si tender ligjor, ndërsa depozitat e transferueshme pranohen gjerësisht për transaksione, sepse njerëzit besojnë se ato pranohen si mjet këmbimi.
- *Vlera nominale.* Vlerat nominale të parasë në dorë dhe të depozitave të transferueshme që nuk mbartin interes, janë fikse edhe pse vlerat e tyre reale ndryshojnë me ndryshimin e nivelit të çmimeve.
- *Aftësia për t'u transferuar.* Paraja në dorë dhe depozitat e transferueshme mund të përdoren për të kryer pagesa për të tretët.
- *Kosto e transaksionit.* Pagesat me para në dorë nuk kanë kosto transaksioni, ndërsa ato me depozita të transferueshme kanë komisione të vogla.
- *Ndashmëria.* Paraja në dorë dhe depozitat e transferueshme janë mjetet financiare më të ndashme, të vlefshme për transaksione shumë të vogla.
- *Maturimi.* Maturimi zero i parasë në dorë dhe i depozitave të transferueshme rrjedh nga aftësia e tyre për kryerjen e menjëhershme të pagesave për të tretët.
- *Kthyeshmëria.* Paraja në dorë dhe depozitat e transferueshme nuk fitojnë ose mbartin pak interes, sepse aftësia e tyre për t'u përdorur si mjet i drejtpërdrejtë këmbimi, kompenson mbajtësin për humbjen e interesit që do të fitonte nga mbajtja e mjeteve të tjera financiare.

Kur valuta e huaj përdoret gjerësisht si mjet këmbimi brenda një vendi, mbajtjet e njësive rezidente përveç Korporatave Depozituese duhet të përfshihen në përbërësen e parasë *cash* të parasë së gjerë.

Depozitat e transferueshme përfshijnë të gjitha depozitat që janë (1) të këmbueshme pa penalitet apo kufizim, me kërkesë në vlerë nominale dhe (2) të përdorshme direkt për kryerjen e pagesave për të tretët nëpërmjet çeqeve, urdhërpagesave, urdhërzhirimeve apo lehtësive të tjera të pagesave. *Depozitat e transferueshme me këto karakteristika, nëse mbahen nga sektorët që përcaktohen si mbajtës të parasë përfshihen në paranë e gjerë.*

Depozitat e kursimit shpesh kanë shërbime transferimi automatike (ATS) nëpërmjet të cilave paratë në depozitë i transferohen automatikisht në një llogari rrjedhëse, për të mbuluar tërheqjet në rastet kur llogaria rrjedhëse del zbuluar. Edhe pse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë llogaritë e kursimit bëhen të transferueshme dhe do të përfshihen në depozita të transferueshme.

Depozitat në valutë të huaj që mund të përdoren direkt si mjet këmbimi duhen përfshirë në depozitat e transferueshme.

Çeqet e udhëtarëve, të emetuara nga korporatat financiare dhe jofinanciare kanë karakteristika të ngjashme me paranë në dorë. Nëse çeqet e udhëtarëve përdoren kryesisht në pagesat e brendshme dhe emetohen nga korporatat financiare, ato përfshihen në paranë e gjerë. Çeqet e udhëtarëve, të cilat përdoren kryesisht për pagesat me jashtë, përjashtohen nga para e gjerë.

Aksionet në tregjet e parasë, të cilat mund të përdoren për të kryer pagesa për të tretët nëpërmjet nënshkrimit të çeqeve, normalisht përfshihen në paranë e gjerë.

Me kalimin nga paraja në dorë dhe depozitat e transferueshme tek mjetet e tjera financiare, likuiditeti bie dhe aftësia e mjetit për të ruajtur vlerën bëhet faktor kryesor. Kostot e transaksionit, ndashmëria, maturiteti dhe kthyeshmëria janë karakteristikat bazë në përcaktimin e përfshirjes së një mjeti të caktuar financiar në paranë e gjerë dhe në atë se ku duhet pozicionuar ai në hirearkinë e agregatëve monetarë.

Depozitat e tjera (dhe pjesërisht letrat me vlerë përveç aksioneve) zënë pjesën më të madhe të komponentëve të parasë së gjerë pas parasë në dorë dhe depozitave. Depozitat e tjera mbulojnë të gjitha llojet e depozitave të patransferueshme: depozitat me afat, depozitat e kursimit, depozitat në valutë të huaj, depozitat në të parë, të cilat nuk mund të përdoren drejtpërdrejt për të kryer pagesa për të tretët, depozita të shoqërive të kursim-kreditit dhe lloje të tjera depozitash.

Depozitat me afat me maturim të gjatë, shpesh kërkojnë kosto për t'u tërhequr duke ulur kështu likuiditetin e tyre dhe duke i përjashtuar ato nga paraja e gjerë.

Marrëveshjet e riblerjes klasifikohen tek "depozitat e tjera" nëse ato konsiderohen pjesë e e përkufizimit kombëtar të parasë së gjerë. Në rast të kundërt, marrëveshjet e riblerjes klasifikohen si hua.

Depozitat e kufizuara, për të cilat tërheqjet nuk mund të kryhen për periudha të paracaktuara përjashtohen nga paraja e gjerë.

Depozitat e importit (depozita që importuesi duhet të vendosë si parakusht për hapjen e letërkredive të importit) përfshihen në përkufizimin kombëtar të parasë së gjerë nëse kufizimet mbi to janë afatshkurtra. Çeqet të cilat i kalojnë llogarive të depozituesve, por që nuk mund të përdoren deri me klerimin e tyre nga Banka Qendrore, klasifikohen në "depozitat e përjashtuara nga paraja e gjerë". Përjashtimi i tyre parandalon dublikimin në përfshirjen e tyre në agregatët monetarë.

Një lloj i veçantë i depozitave të kufizuara, lind kur një Korporatë Depozituese është e paafte të kënaqë kërkesat për tërheqje të depozituesve për një periudhë të konsiderueshme, për shkak të fondeve të pamjaftueshme, ose sepse veprimtaria e saj është pezulluar. Në këto raste, depozituesit nuk e dinë se sa duhet të presin për të patur të drejta mbi depozitat e tyre dhe për më tepër, nëse do të kenë mundësi t'i rimarrin ato ose një pjesë të tyre. Në këtë moment depozitat janë plotësisht jolikuide. Megjithatë, për sa kohë ekziston Korporata Depozituese, ekzistojnë edhe detyrimet e saj ndaj depozituesve dhe kreditorëve të tjerë. Detyrimet në formën e depozitave të Korporatave Depozituese që nuk funksionojnë, përjashtohen nga agregatët e parasë. Këto depozita duhet të vazhdojnë të klasifikohen si depozita të kufizuara, për aq kohë sa njësi do të vazhdojë të ekzistojë si njësi ligjore.

Disa lloje letrash me vlerë afatshkurtër (përveç aksioneve), të emetuara nga Korporatat Depozituese, janë të konvertueshme në *cash* apo në depozita të transferueshme me vonesa të arsyeshme dhe pa humbje të konsiderueshme të vlerës dhe shpesh përfshihen në agregatët e parasë së gjerë.

Çertifikatat e depozitave të negociueshme dhe letrat tregtare të emetuara nga Korporatat Depozituese, nëse tregtohen në tregjet sekondare, përfshihen në agregatët monetarë.

Pranimet bankare të emetuara nga Korporatat Depozituese përfshihen në agregatët monetarë kur tregtohen lirisht në tregun sekondar.

Disa letra me vlerë afatshkurtra (si për shembull, ato me maturitet deri në dy vjet) mund të përfshihen në paranë e gjerë.

Letrat me vlerë afatgjata janë shumë më pak likuide edhe pse tregtohen në tregjet sekondare, për shkak të luhatjeve të mëdha të vlerës së tyre kur ndryshojnë normat e interesit. Për këtë arsye ato përjashtohen nga agregatët e parasë.

Kategoritë e tjera të mjeteve financiare – huatë, aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit, derivatet financiare, rezervat e tjera të sigurimit dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme/të pagueshme, përjashtohen nga paraja e gjerë.

Aksionet në fondet e përbashkëta të kapitalit dhe të obligacioneve, kanë luhatshmëri të madhe të çmimeve dhe shitja e tyre kërkon kosto të larta transaksioni dhe vonesa në kohë, duke i përjashtuar ato nga paraja e gjerë.

Aksionet në fondet e tregut të parasë janë një përjashtim pasi këto fonde investojnë vetëm në letra me vlerë të tregut të parasë si për shembull bono thesari, çertifikata depozitash dhe letra tregtare.

Aksionet në disa nga fondet e tregut të parasë janë të transferueshme, dhe në këtë rast, ato kualifikohen si pjesë e parasë së gjerë. Aksionet e patransferueshme në fondet e tregut të parasë, përfshihen gjithashtu në agregatet e parasë së gjerë, meqë ato janë më likuide, kanë më pak luhatje në çmime dhe kosto më të ulëta transaksionesh se aksionet e tjera.

Mbajtësit e parasë.

Agregatët e parasë, zakonisht përfshijnë aktivet financiare vetëm të një rangu të përcaktuar sektorësh në një ekonomi. Edhe pse vihen re disa ndryshime, sektorët mbajtës të parasë në pjesën më të madhe të vendeve, janë të njëjtët.

Mbajtësit e parasë përfshijnë të gjithë sektorët rezidentë me përjashtim të Korporatave Depozituese dhe të Qeverisë Qendrore. Mbajtësit e parasë zakonisht përfshijnë (1) korporatat publike dhe korporatat e tjera jofinanciare (2) njësitë e qeverisë përveç Qeverisë Qendrore, (3) familjet dhe institucionet jofitimprurëse në shërbim të familjeve dhe (4) të gjitha njësitë institucionale në sektorin e korporatave financiare përveç Korporatave Depozituese.

Në parim, depozitat e jorezidentëve përjashtohen nga agregatët e parasë në qarkullim sepse depozitat e tyre përdoren kryesisht për transaksione ndërkombëtare, në vend që të përdoren për transaksione brenda për brenda ekonomisë. Sidoqoftë, depozitat që emigrantët mbajnë në Korporatat Depozituese në vendet e tyre, mund të përdoren lirisht nga anëtarët e familjes, ose nga palë të tjera, për të likuiduar transaksionet në vendin amë. Në këtë situatë, do të ishte e përshtatshme që depozita të tilla të përfshiheshin në paranë e gjerë, në vend që të klasifikoheshin si detyrime ndaj jorezidentëve. Në mënyrë të ngjashme, punëtorët e jashtëkufirit – rezidentë në ekonominë e brendshme - mund të mbajnë depozita në vendet në të cilat punojnë. Nëqoftëse këto depozita janë përdorur në vendet ku ata punojnë, më shumë se në vendin ku banojnë, do të ishte e përshtatshme të përfshiheshin në agregatët monetarë të vendit ku punojnë.

Depozitat e Qeverisë Qendrore zakonisht përjashtohen nga agregatët monetarë.

Justifikimi për këtë përjashtim është empirik. Argumentohet që mbajtja e depozitave të Qeverisë Qendrore nuk i përgjigjet ndikimeve makroekonomike (si për shembull ndryshimet në aktivitetin ekonomik, normat e interesit, kurset e këmbimit, etj.) në të njëjtën mënyrë si depozitat e sektorëve mbajtës të parasë, për shkak të natyrës unike të kufizimeve të financimit, vendimeve për shpenzime dhe teknikave të administrimit të parasë nga qeveria.

Emetuesit e parasë.

Struktura e statistikave monetare, i klasifikon të gjitha korporatat financiare që emetojnë detyrimet e përfshira në përkufizimin kombëtar të parasë së gjerë, si Korporata Depozituese, si dhe tregon në të njëjtin format, detyrimet e parasë së gjerë të Korporatave Depozituese dhe mjetet kundërparti ndaj këtyre detyrimeve.

Korporatat Depozituese në disa vende janë të vetmet emetuese të parasë. Paraja e gjerë në vende të tjera, mund të përfshijë detyrime të emetuara nga njësi institucionale jashtë sektorit të korporatave financiare, si për shembull Ministria e Financave. Në këto raste, emetimi i parasë nga qeveria, nuk përfshihet në Paraqitjen e Korporatave Depozituese, por përfshihet në paranë e gjerë. Në mënyrë të ngjashme, depozitat e transferueshme apo lloje të tjera detyrimesh, të pranuar nga Qeveria Qendrore, përfshihen në agregatët e parasë së gjerë, por nuk paraqiten në Paraqitjen e Korporatave Depozituese.

Gjithashtu, në situatat ku ka bashkëqarkullim të valutës së huaj, vendi që ka emtuar valutën e huaj, duhet konsideruar si emetues jorezident i parasë në ekonominë vendase. Nëse kompilohen të dhëna për dy ose më shumë agregatë monetarë të rangut të ndryshëm, sektorët emetues të parasë ndryshojnë nga njëri agregat në tjetrin. Megjithatë, në Paraqitjen e Korporatave Depozituese, paraqitet vetëm një agregat, i cili është dhe masa më e gjerë e detyrimeve të parasë së gjerë të korporatave depozituese.

2.7.3 Agregatë të tjerë.

Baza monetare.

Baza monetare përfshin detyrimet e Bankës Qendrore që mbështesin ekspansionin e parasë dhe kreditit. Baza monetare njihet ndryshe edhe si para e fuqishme, pasi ndryshimet në bazën monetare çojnë në rritje/ulje të parasë dhe kreditit, të cilat janë më të mëdha se ndryshimi në bazën monetare.

Baza monetare nuk është një agregat monetar, pasi ajo është më tepër një matje e bazës së agregatëve sesa një agregat monetar në vetvete.

Baza monetare përfshin paranë cash në qarkullim të emtuar nga Banka Qendrore, e cila përfshihet në agregatët monetarë, dhe të paktën dy komponentë që përjashtohen nga agregatët monetarë – depozitat e korporatave të tjera depozituese në Bankën Qendrore dhe paranë cash të mbajtur nga korporatat e tjera depozituese.

Vende të ndryshme kanë përkufizime të ndryshme të bazës monetare. Një përkufizim i gjerë i bazës monetare përfshin të gjitha detyrimet e Bankës Qendrore ndaj Korporatave të Tjera Financiare dhe sektorëve të tjerë (përjashtuar pretendimet e Qeverisë Qendrore përveç monedhave dhe kartëmonedhave). Një përkufizim i ngushtë i bazës monetare përjashton disa kategori të detyrimeve të Bankës Qendrore ndaj Korporatave të Tjera Depozituese dhe/ose sektorëve të tjerë. Depozitat e kufizuara për përdorim për periudha të konsiderueshme kohe përjashtohen nga baza monetare.

Depozitat e Bankës Qendrore, që Korporatat e Tjera Depozituese mbajnë si rezervë e detyrueshme dhe llogaritë për qëllime kleringu, përfshihen në bazën monetare.

Megjithatë depozitat e Korporatave të Tjera Depozituese në Bankën Qendrore të cilat (1) nuk mbahen si rezervë e detyrueshme, (2) kufizohen në përdorim për qëllime të tjera, përjashtohen nga paraja e gjerë.

Detyrimet e Bankës Qendrore ndaj Korporatave të Tjera Financiare, Korporatave Jofinanciare dhe sektorëve të tjerë rezidentë përfshihen në bazën monetare, nëse këto detyrime përfshihen në përkufizimin kombëtar të parasë së gjerë.

Agregatët e likuiditetit.

Agreatatët e likuiditetit janë më të gjerë se paraja e gjerë përse i përket llojeve të instrumenteve të përfshira dhe sektorëve emetues. Agregatët e likuiditetit përfshijnë përveç detyrimeve të parasë së gjerë, detyrime të tjera të cilat shihen si likuide, por jo aq likuide sa të përfshihen në paranë e gjerë.

Krediti dhe borxhi.

Krijimi i kredisë përfshin sigurimin e burimeve nga një njësi institucionale (kreditore ose huadhënësi) një njësie tjetër institucionale (debitore ose huamarrësi). Kreditore fiton një pretendim financiar ndërsa debitorit i krijohet një detyrim ripagese. Kredia shikohet nga ana e mjeteve ndërsa borxhi nga ana e detyrimeve.

Krediti.

Krediti ka të njëjtat dimensione si dhe agregatët monetarë. Përkufizimi i kreditit kërkon specifikimin e instrumenteve financiare të përfshira, sektorin emetues (huadhënësit) dhe sektorin mbajtës (huamarrësit). Përbërja dhe mbulimi i kreditit duhen rishikuar periodikisht, për t'u siguruar se ato reflektojnë ndryshimin e instrumenteve të kreditit.

Krediti është një hallkë kryesore në procesin e transmisionit të parasë. Kredia ndaj sektorëve jofinanciarë financon prodhimin, konsumin dhe krijimin e kapitalit.

Krediti mbulon vetëm mjetet financiare dhe përjashton pozicionet kontigjente si për shembull: linjat e kreditit, marrëveshjet e huave etj.

Në rastet kur njësitë qeveritare dhe Banka Qendrore marrin financime nga jashtë për përdorime specifike të brendshme, dallohen 2 raste. Në rastin e parë, qeveria apo Banka Qendrore vepron si palë e drejtpërdrejtë në transaksion, pra merr hua nga jorezidentët dhe pastaj i jep hua përfituesit të fundit. Në këtë rast, regjistrohet një hua nga jorezidentët për Bankën Qendrore/ qeverinë dhe një hua nga Banka Qendrore/ qeveria për përfituesin final.

Në rastin kur Banka Qendrore vepron vetëm si agjent ose garantues, regjistrohet një hua e jorezidentëve ndaj përfituesit të fundit. E njëjta gjë ndodh kur Banka Qendrore ose qeveria i jep hua një korporate financiare për ta lëvruar tek sektorët e tjerë.

Mjetet financiare të përfshira në kredi.

Ashtu si dhe tek paraja, edhe tek kredia ekzistojnë matja e gjerë dhe e ngushtë e saj. Kredia e ngushtë mbulon pretendimet në formën e huave, të letrave me vlerë përveç aksioneve dhe kreditë tregtare dhe paradhëniet.

Këtu përjashtohen depozitat, aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit, derivatet financiare, pretendimet ndaj kompanive të sigurimit të jetës dhe fondeve të pensionit në formën e rezervave teknike të sigurimit dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme, të cilat nuk janë pjesë e kredisë tregtare. Agregati i gjerë i kreditit përfshin pak a shumë të gjitha llojet

e pretendimeve financiare të një njësie ndaj një njësie tjetër, duke përfshirë në disa raste edhe aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit.

Përfshirja në agregatët e kreditit të aksioneve dhe instrumenteve të tjera të kapitalit reflekton preferencat investuese të një ekonomie midis instrumenteve të borxhit apo të kapitalit. Agregatët e kreditit ndahen më tej në varësi të monedhës (në monedhë kombëtare apo valutë të huaj), të maturimit, të sektorit apo të cilësisë së kredisë.

Huadhënësit.

Sektorët huadhënës mund të përkufizohen në mënyrë të gjerë ose të ngushtë. Agregatët e ngushtë të kredisë përfshijnë vetëm pretendimet e Korporatave Depozituese mbi sektorët e tjerë. Agregatët e gjerë të kreditit përfshijnë pretendimet e të gjithë sektorëve financiarë mbi sektorët e tjerë. Huadhënësit brenda sektorit të korporatave financiare, janë një grup shumë më i madh sesa emetuesit e detyrimeve të parasë së gjerë. Korporatat e Tjera Financiare japin kredi duke përdorur instrumente të njëjta ose të ngjashme me ato të Korporatave Depozituese duke ndryshuar vetëm nga mënyra e financimit të tyre. Këto njësi financohen me anë të detyrimeve që nuk përfshihen në paranë e gjerë.

Një pjesë e rëndësishme e kredisë prokurohet edhe nga sektorët jofinanciarë. Kredia tregtare e ofruar nga korporatat jofinanciare është një shembull. Qeveria, gjithashtu, mund të japë kredi.

Huamarrësit.

Nën përkufizimin e gjerë të kreditit, sektorët huamarrës që përfshihen janë të gjithë sektorët jofinanciarë. Statistikat fokusohen edhe mbi kredinë e dhënë sektorëve të veçantë si për shembull kredia për qeverinë, kredia për sektorin publik, kredia e bizneseve dhe kredia për sektorin privat. Flukset e kreditit midis Korporatave Financiare përjashtohen nga agregatët e kredisë së gjerë.

Borxhi.

Ekzistenca e një borxhi, krijon detyrime për kryerjen e pagesave në të ardhmen. Si pasojë, detyrimet e borxhit kanë potencial për ta bërë ekonominë apo sektorë të saj shumë të ndjeshëm ndaj likuiditetit. Për këtë arsye, agregatët e borxhit janë shumë të rëndësishëm.

Depozitat, huatë, letrat me vlerë përveç aksioneve dhe llogarive të tjera të pagueshme, janë instrumente borxhi, pasi ato kërkojnë pagesë të ardhshme principali dhe interesi. Borxhi i Korporatave Depozituese përfshihet në strukturën e Paraqitjes së Korporatave Depozituese. Borxhi i ekonomise totale mund të prezantohet ose si agregim i borxhit të të gjitha njësive rezidente, ose duke konsoliduar pozicionet e rezidentëve. Ky i fundit quhet borxhi i jashtëm.

Një element kyç i analizës së borxhit është maturiteti. Të dhënat për borxhin duhet të ndahen si minimum, në afatgjatë dhe afatshkurtër.

Më poshtë jepen disa nga agregatët e borxhit për sektorë individualë:

- Borxhi i ekonomisë familjare. Borxhi i ekonomisë familjare shkaktohet për arsye si blerja e pajisjeve, e ndërtesave, financimi i shpenzimeve korente etj. Të dhënat për borxhin e ekonomive familjare merren nga kreditorët.
- Borxhi i bizneseve. Bizneset zakonisht marrin borxh afatshkurtër për të financuar prodhimin korent dhe blerjen e inventarëve dhe borxh afatgjatë për të financuar formimin e kapitalit. Korporatat mund të financojnë këto aktivitete nëpërmjet huasë nga Korporatat Financiare, kredisë tregtare dhe emërimit të letrave me vlerë.

- Borxhi i sektorit publik. Të dhënat e borxhit mund të kompilohen për të tërë sektorin publik ose vetëm për sektorin publik jofinanciar. Të dhënat për borxhin qeveritar mund të kompilohen për Qeverinë Qendrore ose për Qeverinë e Përgjithshme.
- Borxhi i jashtëm. Borxhi i jashtëm i referohet detyrimeve të borxhit të një vendi, të një sektori apo të një njësie ndaj jorzidentëve. Statistikat e borxhit të jashtëm përdoren për analizat makroekonomike, për negociimet për riskedulimin e borxhit etj.

3. Statistikat monetare; hallkat përbërëse.

Më poshtë përshkruhet struktura dhe hallkat përbërëse të statistikave monetare. Statistikat monetare mbulojnë gjendjet dhe flukset e mjeteve dhe të detyrimeve të sektorit të Korporatave Financiare.

Në kompilimin e statistikave monetare, sektori financiar ndahet në nënsektorin e Bankës Qendrore, nënsektorin e Korporatave të Tjera Depozituese dhe nënsektorin e Korporatave të Tjera Financiare, i cili përfshin kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit, ndërmjetësit e tjerë financiarë dhe ndihmësit financiarë. Të marra së bashku, Banka Qendrore dhe Korporatat e Tjera Depozituese përbëjnë nënsektorin e Korporatave Depozituese.

Për kompilimin dhe prezantimin e të dhënave në statistikat monetare përdoren dy nivele. Në nivelin e parë të dhënat individuale të njërive institucionale agregohen në bilancin sektorial, i cili përmban të dhënat për nënsektorët e Korporatave Financiare; për Bankën Qendrore, për Korporatat e Tjera Depozituese dhe për Korporatat e Tjera Financiare. Qëllimi i bilancit sektorial është të sigurojë një strukturë për mbledhjen dhe për prezantimin e të dhënave të përshtatshme për (1) kompilimin e Paraqitjeve; dhe (2) kompilimin e flukseve të fondeve. Të dhënat për bilancet sektoriale merren nga njësitë institucionale individuale brenda sektorit të Korporatave Financiare dhe klasifikohen në përbërës standardë në përputhje me sektorizimin, klasifikimin e instrumenteve dhe parimet kontabël të përcaktuara më parë. Të dhënat e balanceve sektoriale përdoren për analiza që kërkojnë të dhëna në nivel nënsektori.

Në nivelin e dytë, të dhënat në bilancet sektoriale përdoren për kompilimin e paraqitjeve monetare.

Statistikat monetare fokusohen në Paraqitjet e Korporatave Depozituese dhe komponentëve të saj: Paraqitja e Bankës Qendrore dhe Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese.

Paraqitja e Korporatave Depozituese përmban të dhëna mbi gjendjet e detyrimeve të Korporatave Depozituese, që janë pjesë e parasë së gjerë sipas përkufizimit kombëtar, si dhe të dhëna mbi mjetet e korporatave depozituese që janë pretendime (hua) ndaj sektorëve të tjerë të ekonomisë.

Paraqitja e Korporatave Depozituese përmban, gjithashtu, të dhëna mbi pretendimet dhe detyrimet e Korporatave Depozituese ndaj jorezidentëve. Paraqitja e Bankës Qendrore dhe Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese tregojnë të dhënat që konsolidohen për të përfutur Paraqitjen e Korporatave Depozituese, dhe që në atë nivel konsolidimi mund të jenë të nevojshme në analizën e parasë dhe të kredisë.

Struktura për statistikat monetare përfshin edhe Paraqitjen e Korporatave Financiare, e cila mbulon të gjithë sektorin e Korporatave Financiare. Në Paraqitjen e Korporatave Financiare, konsolidohen gjendjet dhe flukset e mbuluara në Paraqitjen e Korporatave Depozituese dhe në Paraqitjen e Korporatave të tjera Financiare¹¹.

¹¹ Në to përfshihen të dhënat e konsoliduara mbi gjendjet dhe flukset e kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, ndërmjetësve të tjerë financiarë dhe të ndihmësve financiarë.

Paraqitja e Korporatave Financiare prokuron të dhëna për analizën e mjeteve financiare dhe detyrimeve për të gjithë sektorët e ekonomisë dhe jorezidentët, dhe në mënyrë të veçantë, në të jepet një matje e plotë e kredisë.

3.1 Bilanci Sektorial.

Bilanci sektorial përbën strukturën për organizimin e të dhënave monetare, që përdoren për kompilimin e paraqitjeve të nënsektorëve të sektorit të Korporatave Financiare.

Bilanci Sektorial organizohet në kategori mjetesh dhe detyrimesh të njëjta me ato të SNA 1993. Struktura e bilancit sektorial parashikon klasifikimin e të dhënave sipas sektorit dhe llojit të instrumentit financiar, në një nivel agregimi që mund të prokurojë fleksibilitet në përdorimin e të dhënave për një rang të gjerë analizash.

Të dhënat për bilancin sektorial merren përgjithësisht nga regjistrimet kontabël, dhe klasifikohen në përputhje me sektorizimin, me klasifikimin dhe me vlerësimin e paraqitur në kapitujt e mëparshëm të metodikës.

Mjetet dhe detyrimet financiare klasifikohen sipas instrumenteve dhe sipas sektorit debitor/ kreditor. Klasifikimi i detyrimeve në bilancin sektorial dallon midis atyre detyrimeve që përfshihen në përkufizimin kombëtar të parasë së gjerë dhe atyre detyrimeve, të cilat nuk përfshihen në paranë e gjerë.

Aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit në bilancin sektorial tregohen me vlerën kontabile dhe të disagreguara në komponentët përkatës. Duke qenë se të dhënat e bilancit sektorial përdoren për kompilimin e flukseve të fondeve dhe të dhënat për këtë kategori do të duheshin të vlerësuara me vlerë tregu dhe sipas sektorëve mbajtës, këto të dhëna mund të jepen si zëra në vëmendje.

Në bilancin sektorial *Aksionet dhe instrumentet e tjera të kapitalit* paraqiten sipas këtyre përbërësve:

- *Fondet e pronarëve*, janë fondet që rrjedhin nga shitja e aksioneve aksionerëve.
- *Fitimi i pashpërndarë*, është fitimi pas taksave që rrjedh nga aktiviteti i korporatës financiare duke i zbritur *Rezervat e përgjithshme dhe rezervat specifike*.
- *Rezervat e përgjithshme dhe rezervat specifike*, të cilat përfaqësojnë një akumulim të kapitalit kundrejt rrezikut financiar dhe operacional të korporatës.
- *Rivlerësimi*, i përgjigjet rivlerësimeve të prejardhura nga ndryshimet në vlerat e tregut të mjeteve dhe detyrimeve, që rezultojnë nga ndryshimi në çmimet e instrumenteve dhe ndryshimi në kurset e këmbimit.

Në bilancin sektorial të dhënat për mjetet dhe detyrimet brenda për brenda sektorit paraqiten veçmas. Në kompilimin e paraqitjeve, llogaritë e bilancit sektorial konsolidohen dhe mjetet/ detyrimet e njësive financiare me njësitë e tjera financiare netohen.

Bilanci sektorial hartohet në monedhë kombëtare. Mjetet dhe detyrimet e emëruara në monedhë të huaj konvertohen në monedhë vendase me kursin e ditës së fundit të muajit.

3.2 Paraqitjet e Korporatave Financiare.

Paraqitjet e Korporatave Financiare riklasifikojnë zërat analitikë të Bilanceve Sektoriale. Paraqitjet përpunohen për tre nënsektore të Korporatave Financiare: Korporatat e Tjera Depozituese, Banka Qendrore dhe Korporatat e Tjera Financiare, si dhe për dy nivele të

tjera (Paraqitja e Korporatave Depozituese dhe Paraqitja e Korporatave Financiare), që përftohen nga konsolidimi i këtyre të trejave.

Paraqitja për secilin nga nënsektorët ndërtohet rreth identitetit kontabël dhe është strukturuar për të nënvizuar rolin ndërmjetësues të secilit nënsektor. Për secilën nga paraqitjet, ana e aktiveve fokusohet në kredinë ndaj jorezidentëve dhe sektorëve të tjerë të brendshëm. Në paraqitjen e Bankës Qendrore dhe Korporatave të Tjera Depozituese ana e pasiveve është strukturuar në mënyrë të tillë që të tregojë komponentët e parasë së gjerë dhe bazës monetare (Paraqitja e Bankës Qendrore).

Karakteristikat e përbashkëta të paraqitjeve janë:

- Mjetet e huaja jepen në baza neto dhe bruto, duke i ndarë sipas instrumenteve. Lëvizjet në mjetet valutore neto, sigurojnë një tregues të impaktit të transaksioneve të sektorit monetar me jorezidentët.
- Pretendimet ndaj qeverisë tregohen në baza neto dhe në baza bruto. Prezantimi në bazë neto lehtëson analizën e financiamit të qeverisë nga korporatat financiare.
- Pretendimet ndaj sektorëve të brendshëm përveç qeverisë qendrore, jepen sipas sektorëve: Qeveria rajonale dhe lokale, Korporatat Publike Jofinanciare, Korporatat Jofinanciare Private dhe Sektorë të Tjerë Rezidentë.
- Pretendimet dhe detyrimet ndaj nënsektorëve të tjerë të Korporatave Financiare jepen më vete për të mundësuar kështu konsolidimin e tyre në nivele më të larta (Paraqitja e Korporatave Depozituese, Paraqitja e Korporatave Financiare).
- Ndarja parësore në anën e pasiveve është sipas instrumenteve. Në Paraqitjen e Bankës Qendrore dhe në Paraqitjen e Korporatave të Tjera Depozituese pasivet ndahen në dy grupe kryesore: detyrime të përfshira në paranë e gjerë dhe detyrime të papërfshira në paranë e gjerë, duke i ndarë më tej sipas sektorëve.
- Ndryshe nga instrumentet e tjera të aktivitetit, aksionet dhe instrumenet e tjera të kapitalit nuk ndahen sipas sektorëve dhe nuk netohen në procesin e konsolidimit. Ato formojnë një kategori të veçantë të pasivitetit, e cila tregon bazën e kapitalit të vet në çdo sektor.

Paraqitja e Korporatave Depozituese fokusohet në paranë e gjerë, e cila përfshin paranë jashtë bankave dhe detyrimet e përfshira në paranë e gjerë të Korporatave Depozituese. Paraja jashtë bankave përfshin *Paranë në Qarkullim minus Monedha dhe Kartëmonedha* në lekë të Korporatave të Tjera Depozituese.

Paraqitja e Korporatave Financiare përmban të njëjtat kategori mjetesh si Paraqitja e Korporatave Depozituese, por më pak kategori detyrimesh pasi ajo nuk tregon përbërësit e parasë së gjerë. Disa nga përbërësit e parasë së gjerë (detyrimet e përfshira në paranë e gjerë të institucioneve të tjera financiare), netohen gjatë konsolidimit të nënsektorëve të Korporatave Financiare.

3.3 Lidhja midis sistemeve statistikore makroekonomike.

Paraqitja e Korporatave Depozituese është strukturuar në mënyrë të tillë, që të lehtësojë analizën ekonomike që përdor lidhjet midis statistikave monetare dhe statistikave të tjera makroekonomike.

Struktura e bilancit të Paraqitjes së Korporatave Depozituese lidh detyrimet e Korporatave Depozituese, të përfshira në paranë e gjerë, me mjetet dhe detyrimet e tyre ndaj jorezidentëve dhe qeverisë, duke lidhur kështu statistikën monetare me statistikën e Bilancit të Pagesave dhe me Statistikën e Qeverisë.

Të dhënat e Paraqitjes së Korporatave depozituese mund të riklasifikohen për të arritur në identitetin e mëposhtëm:

$$PG_j = MVN + KB - TTN$$

ku PG_j - Paraja e Gjerë; MVN - Mjetet Valutore Neto; KB - Krediti i Brendshëm; TTN – Të Tjera Neto.

Krediti i Brendshëm përfshin Pretendimet Neto ndaj Qeverisë dhe Pretendimet ndaj Sektorëve të Tjerë.

Të Tjera Neto llogaritet si mbetje ose të gjitha detyrimet e tjera që nuk përfshihen në Paranë e Gjerë minus mjetet e tjera.

Si rrjedhim e njëjta gjë mund të thuhet për flukset:

$$\Delta PG_j = \Delta MVN + \Delta KB - \Delta TTN$$

ku Δ tregon fluksin total ose ndryshimin nga periudha në periudhë. Këto flukse mund të ndahen më tej në transaksione, ndryshime rivlerësimi dhe ndryshime të tjera në vlerën e instrumenteve.

Ndryshimet në paranë e gjerë mund të lindin nga ndryshimet në mjetet ose detyrimet valutore të korporatave depozituese, gjë që mund të shihet edhe nga identiteti që lidh ΔPG_j me ΔMVN .

Komponentët e ΔKB tregohen si më poshtë:

$$\Delta KB = \Delta PQN + \Delta PST$$

ku PQN – Pretendimet ndaj Qeverisë Neto.
dhe PST – Pretendimet ndaj Sektorëve të Tjerë.

Komponenti PQN i Paraqitjes së Korporatave Depozituese, lidhet drejtpërdrejt me statistikën e qeverisë. Të dhënat për flukset e transaksioneve për përbërësit bazë të Pretendimeve Neto ndaj Qeverisë, përdoren për të analizuar efektet ekspansioniste ose shtrënguese mbi Paranë e Gjerë, të prejardhura nga transaksionet financiare midis Qeverisë Qendrore dhe Korporatave Depozituese. Për shembull rritja në Pretendimet Neto ndaj Qeverisë, nëpërmjet një rritjeje në portofolin e letrave me vlerë të qeverisë apo huadhënies direkte dhe/ ose një reduktim në depozitat e qeverisë, do të shkaktojë një efekt ekspansionist në Paranë e Gjerë.

ANEKSE PER TABELAT E STATISTKAVE MONETARE.

Sektorizimi i ekonomisë shqiptare është paraqitur si më poshtë:

| | |
|---------|--|
| 1 | Jorezidentët |
| 2 | Korporata Financiare |
| 2.1 | Korporata Depozituese |
| 2.1.1 | Banka Qendrore |
| 2.1.2 | Korporata të Tjera Depozituese |
| 2.1.2.1 | Bankat Para Depozituese |
| 2.1.2.2 | Shoqëritë e Kursim – Kreditit |
| 2.2 | Korporata të Tjera Financiare |
| 3 | Qeveria Qendrore |
| 4 | Qeveria Lokale dhe Autoritetet Publike |
| 5 | Korporata Jofinanciare Publike |
| 6 | Korporata të Tjera Jofinanciare |
| 7 | Sektorë të Tjerë Rezidentë |

1. Jorezidentët klasifikohen në bazë të parimit të rezidencës të përshkruar në kapitujt e kësaj metodike.
2. Korporatat Financiare që përfshijnë:
 - 2.1. Korporatat Depozituese të cilat përfshijnë:
 - 2.1.1. Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë dhe degët e saj në rrethe.
 - 2.1.2. Korporatat e Tjera Depozituese që përbëhen nga:
 - 2.1.2.1. Bankat Para Depozituese – të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nr. 8365 Dt 02.07.1998.
 - 2.1.2.2. Shoqëritë e Kursim–Kreditit veprimtaria e te cilave rregullohet nga ligji “Për Shoqëritë e Kursim–Kreditit ” nr.8782, datë 03.05.2001 dhe nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Shoqëritë e Kursim -Kreditit janë institucione jo me qëllim fitimi të organizohen si bashkime vullnetare të personave juridike ose fizike. Ato mbledhin fonde nga anëtarët e tyre dhe u japin kredi vetëm anëtarëve të tyre.
 - 2.2. Korporatat e Tjera Financiare janë të gjitha institucionet e tjera financiare rezidente në Republikën e Shqipërisë përveç korporatave të tjera depozituese, duke përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare^{*1}.
3. Qeveria Qendrore – e përfaqësuar nga dikasteret qendrore, si ministritë dhe institucionet e tjera të atij niveli, duke përfshirë sigurimet shoqërore.
4. Qeveria Lokale dhe Administrata Publike – që përfshin autoritetet rajonale si bashkitë si dhe institucione të tjera qeveritare.
5. Korporata jofinanciare publike – që përfshijnë ato njësi jofinanciare ku 50 për qind apo më shumë e kapitalit zotërohet nga shteti.
6. Korporatat e tjera jofinanciare – që përfshijnë kryesisht bizneset.
7. Sektorë të tjerë rezidentë që përfshijnë Individët, organizmat joqeveritare, organizatat fetare etj.

^{*1} Institucionet financiare ndërkombëtare klasifikohen si jorezidentë.

Aneks 1: Bilanci Sektorial – Banka e Shqipërisë.

Të dhënat për kompilimin e Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë merren nga regjistrimet kontabël (bilanci kontabël i Bankës së Shqipërisë, i degëve të Bankës së Shqipërisë dhe librat specialë).

Bilanci Sektorial i Bankës së Shqipërisë paraqitet kryesisht në këta zëra:

| | Aktivi | | Pasivi |
|-------|------------------------------------|----------|---|
| 1 | Ari dhe mbajtjet e SDR-së | 9 | Paraja në qarkullim |
| 2 | Monedha dhe kartëmonedha në valutë | 10 | Depozita të përfshira në paranë e gjerë |
| 3 | Depozita të transferueshme | 10.1 | Depozita të transferueshme në lekë |
| 3.1 | Jorezidentët | 10.1.2 | Individët |
| 4 | Depozita të tjera | 10.1.3 | Institucione të tjera financiare |
| 4.1 | <i>Në lekë</i> | 11 | Depozita të papërfshira në paranë e gjerë |
| 4.1.1 | Jorezidentët | 11.1 | Depozita të transferueshme |
| 4.1.2 | Korporatat e tjera Depozituese | 11.1.1 | <i>Në lekë</i> |
| 4.2 | <i>Në valutë</i> | 11.1.1.1 | Jorezidentët |
| 4.2.1 | Jorezidentët | 11.1.1.2 | Qeveria Qendrore |
| 4.2.2 | Korporatat e tjera Depozituese | 11.1.1.3 | Korporatat e tjera Depozituese |
| 5 | Letrat me vlere | 11.1.2 | <i>Në valutë</i> |
| 5.1 | Jorezidentët | 11.1.2.1 | Jorezidentët |
| 5.2 | Qeveria Qendrore | 11.2.1.2 | Qeveria Qendrore |
| 6 | Huatë | 11.2.1.3 | Korporatat e tjera Depozituese |
| 6.1 | Qeveria Shqiptare | 11.2 | Depozita të tjera |
| 6.2 | Korporatat e tjera Depozituese | 11.2.1 | <i>Në lekë</i> |
| 6.3 | Individët | 11.2.1.1 | Qeveria Qendrore |
| 6.4 | Institucione financiare | 11.2.1.2 | Korporatat e tjera Depozituese |
| 6.5 | Njësi jofinanciare publike | 11.2.1.3 | Institucione të tjera financiare |
| 6.6 | Njësi jofinanciare private | 11.2.1.4 | Njësi jofinanciare publike |
| 7 | Llogari të tjera për t'u marrë | 11.2.1.5 | Njësi jofinanciare private |
| 7.1 | Jorezidentët | 11.2.2 | <i>Në valutë</i> |
| 7.2 | Qeveria Qendrore | 11.2.2.1 | Qeveria Qendrore |
| 7.3 | Korporatat e tjera Depozituese | 11.2.2.2 | Korporatat e tjera Depozituese |
| 7.4 | Individët | 11.2.2.3 | Institucione të tjera financiare |
| 7.5 | Institucione të tjera financiare | 11.2.2.4 | Njësi jofinanciare publike |
| 7.6 | Ndërmarrje jofinanciare private | 11.2.2.5 | Njësi jofinanciare private |
| 7.7 | Ndërmarrje jofinanciare publike | 12 | Huatë |
| 7.8 | Të tjera | 12.1 | Jorezidentët |
| 8 | Mjete jofinanciare | 12.2 | Korporatat e tjera Depozituese |
| | | 12.3 | Qeveria Qendrore |
| | | 13 | Llogari të tjera të pagueshme |
| | | 13.1 | Jorezidentët |
| | | 13.2 | Qeveria Qendrore |
| | | 13.3 | Korporatat e tjera Depozituese |
| | | 13.4 | Individët |
| | | 13.5 | Institucione të tjera financiare |
| | | 13.6 | Ndërmarrje jofinanciare private |
| | | 13.7 | Ndërmarrje jofinanciare publike |
| | | 13.8 | Të tjera |
| | | 14 | Llogaritë kapitale |

Tabelë.1 - Bilanci Sektorial i Bankës së Shqipërisë.

1. Ari dhe mbajtjet në SDR përfshijnë mjetet valutore të bankës së Shqipërisë në ar monetar dhe në SDR.
Ari monetar është ari (a) pjesë e Rezervës Zyrtare dhe (b) që plotëson një standard pastërtie prej 99.5 për qind. Ari monetar vlerësohet dhe paraqitet në bilanc me vlerën e tregut. Si çmim tregu përdoret çmimi i arit sipas fiksit të bursës së Londrës.
SDR-ja është një mjet rezerve ndërkombëtare krijuar nga FMN dhe vendosur për anëtarët e saj për të mbështetur ekzistencën e mbajtjes së rezervës ndërkombëtare. Kjo kategori përfshin llogarinë e Bankës së Shqipërisë në SDR si dhe interesat e përlogaritur të llogarisë në SDR. Në vlerësimin e arit monetar dhe të SDR përdoret kursi i ditës së fundit të muajit i arit dhe i SDR kundrejt lekut. Vlera e SDR në USD ekuivalente vendoset çdo ditë nga FMN dhe konvertohet nëpërmjet USD-së në monedhën vendase.
2. Monedha dhe kartëmonedha në valutë përfshin të gjitha mbajtjet e bankënotave dhe të monedhave të huaja, lirisht të konvertueshme në monedhën vendase. Në vlerësimin e arkës në valutë përdoret kursi i ditës së fundit të muajit i çdo valute kundrejt lekut.
3. Depozitat e transferueshme përfshijnë llogaritë rrjedhëse të Bankës së Shqipërisë të çelura në banka dhe institucione të tjera financiare (llogaritë Tona). Llogaritë rrjedhëse zakonisht përdoren për veprime rrjedhëse me bankat e tjera si klering, transfertat dhe të gjitha shumat që vihen në dispozicion ose paguhen në mënyrë të pandërprerë, në një veprim depozite ose huaje me institucionin. Shuma e mbajtur në llogarinë rrjedhëse është e disponueshme në çdo moment.
Kjo kategori klasifikohet më tej sipas sektorëve për shembull llogaritë rrjedhëse të Bankës së Shqipërisë në bankat e huaja klasifikohen në nënkategorinë “Jorezidente”.
4. Depozita të tjera përfshijnë të gjitha pretendimet ndryshe nga depozitat e transferueshme, në bankat qendrore, në institucionet e tjera depozituese etj. Këtu përfshihen depozitat me afat në lekë dhe në valutë të huaj, depozitat e Bankës së Shqipërisë në ar monetar dhe llojet e tjera të depozitave të patransferueshme. Interesi i përlogaritur përfshihet, gjithashtu, në këtë kategori. Në vlerësimin e depozitave me afat në valutë të huaj dhe në ar, përdoret kursi i ditës së fundit të muajit i çdo valute/ arit kundrejt lekut.
Depozitat në bankat e huaja (Jorezidentët) janë një nga instrumentet e Investimit të Rezervës Valutore të Bankës së Shqipërisë pranë bankave të huaja.
5. Letrat me vlerë përfshijnë investimet e Bankës së Shqipërisë në letra me vlerë të:
 - 5.1. Jorezidentëve – Letrat me vlerë të Jorezidentëve janë pjesë e Rezervës Valutore të Bankës së Shqipërisë. Përfshijnë Bonot e Thesarit të shteteve të huaja, letrat me vlerë të Agjencive të huaja, Notat e Thesarit të shteteve të huaja, MTI- Bis, FIX-Bis, duke përfshirë interesat e përlogaritur përkatës.
Letrat me vlerë të jorezidentëve vlerësohen më kursin e ditës së fundit të muajit të valutës përkatëse kundrejt lekut. Letrat me vlerë vlerësohen me çmimin e tregut për letrat me vlerë të tregtueshme dhe me vlerën kontabile për letrat me vlerë të investimit.

- 5.2. Qeverisë Shqiptare – duke përfshirë Bonot e Thesarit dhe Obligacionet e Qeverisë. Interesat e përlogaritur përfshihen gjithashtu.
6. Huatë përfshijnë huatë e Bankës së Shqipërisë ndaj:
- 6.1. Qeverisë Shqiptare – në formën e huasë aftshkurtër për qeverinë duke përfshirë interesat e përlogaritur. Banka e Shqipërisë, brenda kufijve të përcaktuar në ligj, i jep kredi qeverisë me maturime të cilat nuk i kalojnë 6 muaj. Të gjitha kreditë kolateralizohen me letra me vlerë të borxhit me norma interesi sipas përqindjeve të tregut.
- 6.2 Korporatave të tjera Depozituese – në formën e kredisë njëditore, të kredisë Lombard, të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (kredia në Lekë) dhe të kredisë në valutë. Instrumentet që përdor Banka e Shqipërisë në kredidhënie (ose që parashikohen në planin e llogarive të Bankës së Shqipërisë), janë :
- *Kredia Lombard.* Qëllimi i kredisë Lombard është plotësimi i nevojave afatshkurtra për likuiditete të bankave të nivelit të dytë. Kredia Lombard është kredia më e shtrenjtë në dispozicion të bankave të nivelit të dytë. Kredia Lombard është një kredi plotësisht e garantuar ku si mjet për sigurimin e saj shërbejnë vlerat e përcaktuara si të tilla në rregulloren përkatëse, të pranuar dhe të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Çdo bankë e nivelit të dytë, pasi shfrytëzon të gjitha mundësitë e brendshme të bankës për likuiditete në tregun ndërbankar, përdor kredinë Lombard një herë për çdo tremujor. Çdo bankë e nivelit të dytë për të zgjidhur problemet afatshkurtra të likuiditetit mund të përftojë kredi Lombard për shumën më të madhe midis 20 për qind të kapitalit të paguar dhe 2 për qind të depozitave në lekë sipas bilancit më të fundit të paraqitur në Bankën e Shqipërisë. Interesi i kredisë Lombard është 6 pikë përqindjeje, me bazë vjetore, më i lartë se interesi i marrëveshjeve të anasjellta të riblerjeve që përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë.
 - *Kredia njëditore.* Kredia njëditore përfaqëson një instrument afatshkurtër borxhi në dispozicion të bankave të nivelit të dytë. Ajo është një kredi plotësisht e garantuar, e cila ka për qëllim të shtojë likuiditetin në sistemin bankar dhe të ndihmojë në administrimin e normave afatshkurtra të interesit. Banka e Shqipërisë akordon kredi njëditore për bankat dhe degët e bankave që kanë llogari në Bankën e Shqipërisë. Bankat e nivelit të dytë që vlerësojnë se nga aktiviteti i tyre ditë rezultojnë me mungesë në likuiditete, mund t'i kërkojnë Bankës së Shqipërisë akordimin e një kredie njëditore. Banka e Shqipërisë akordon automatikisht kredi njëditore për bankat e nivelit të dytë, llogaritë rrjedhese të të cilave rezultojnë nën nivelin e lejuar 95% deri në orën 15:00 të ditës së punës. Norma e kredisë njëditore, që aplikon Banka e Shqipërisë, sinjalizon nivelin e dëshirueshem tavan, të normave afatshkurtra të interesit, që aplikohen në tregun ndërbankar. Norma e interesit të kredisë njëditore është 2.5 pikë përqind, me bazë vjetore, më e lartë se interesi i marrëveshjeve të anasjellta të riblerjeve, që përcaktohet me Vendim të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- *Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes* trajtohen si hua të kolateralizuara sipas të cilave blerja e letrave me vlerë nën një marrëveshje riblerjeje është një kontratë për blerjen e letrave me vlerë, me një marrëveshje për ta rishitur të njëjtën letër me vlerë në një datë të rënë dakord me çmimin e shitjes plus interesin. Sipas kësaj marrëveshjeje, bankat e nivelit të dytë kërkojnë kredi për të plotësuar nevojat e tyre për likuiditet. Në këtë rast, Banka e Shqipërisë si huadhënëse zotëron një marrëveshje të anasjelltë, e cila është një aktiv sepse shet një hua të arkëtueshme, huadhënësi fiton interes për paratë e dhëna hua.
 - *Huadhënie bankave si ndërmjetës financiarë*, regjistron të gjitha huatë dhënë bankave të nivelit të dytë që veprojnë si ndërmjetës financiarë. Nëse disa nga institucionet financiare ndërkombëtare si për shembull Banka Botërore ose ndonjë institucion i huaj krediti japin hua për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Banka e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë nga ana tjetër, lidh marrëveshje me një bankë të nivelit të dytë, për të vepruar si ndërmjetës financiar për financimin e fondeve në formën e kredive për përfituesin përfundimtar.
Në këtë rast, regjistrohen veçmas dy veprime (1) Banka e Shqipërisë duhet të njohë detyrimin e saj kundrejt institucionit të huaj të kreditit dhe e kontabilizon atë në pasiv të bilancit, (2) Banka e Shqipërisë regjistron një hua (aktiv) kundrejt klientit të saj, pra bankës me të cilën ka lidhur marrëveshje që kjo e fundit të veprojë si ndërmjetëse për financimin e fondeve të përfituesit përfundimtar.
 - Për çdo bankë subjekt i rezervës së detyrueshme, në librat e Bankës së Shqipërisë krahas llogarisë së rezervës së detyrueshme, çelen edhe llogaritë e *mosplotësimit të rezervës së detyrueshme*, funksioni i të cilave është të pasqyrojnë mungesat në plotësimin e rezervave të detyrueshme dhe të sigurojnë informacionin e nevojshëm për llogaritjen e gjobave për mosplotësim.
- 6.3 Individëve – ku përfshihen huatë e dhëna punonjësve të Bankës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë u jep kredi punonjësve të saj për përmirësimin e kushteve të jetesës në shumat dhe në kriteret e përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- 6.4 Institucioneve të tjera financiare – Këtu përfshihen huatë që Banka e Shqipërisë u jep institucioneve financiare vendase.
- 6.5&6.6 Në planin e llogarive të Bankës së Shqipërisë, parashikohen edhe hua të dhëna institucioneve jofinanciare me të cilat Banka e Shqipërisë nuk operon aktualisht, por gjithësesi, nëse do të ekzistonin ato do të klasifikoheshin këtu.
7. Llogaritë e tjera për t'u marrë janë të gjitha pretendimet e tjera të Bankës së Shqipërisë, të cilat nuk janë klasifikuar më sipër. Llogaritë e tjera për t'u marrë ndahen në:
- Llogaritë e tjera për t'u marrë nga jorzidentët, që përfshijnë kuotizacionet në organizatat e huaja si FMN, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim etj.

Sipas ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë përfaqëson Shtetin Shqiptar në të gjitha marrëdhëniet dhe veprimtaritë bankare me shtetet, me bankat dhe me institucionet e huaja.

Kuotizacioni me FMN pasqyron pagesat fillestare dhe të mëvonshme të kuotës. Deri në 25 për qind e nënshkrimit është e pagueshme nga çdo anëtar i Fondit në SDR ose në rezerva të tjera të pranuar dhe pjesa tjetër në monedhën e vetë anëtarit.

- Mjete të tjera financiare që janë llogari të tjera për t'u marrë nga njësi të tjera rezidente të ekonomisë, përfshijnë të gjitha aktivet e tjera të cilat nuk janë përfshirë në grupet e tjera, si shpenzimet e parapaguara, Llogari në pritje për t'u sistemuar, llogaritë e arkëtueshme etj.
Këto llogari ndahen më tej sipas sektorëve atëherë kur është e mundur dhe pjesa tjetër klasifikohen në nënzërin “Të tjera”.
8. Mjetet jofinanciare përfshijnë mjetet e qëndrueshme të trupëzuara (minus amortizimin) dhe të patrupëzuara të Bankës së Shqipërisë, numizmatikën dhe koleksionet, arin jomonetar dhe metalet e çmuara, si dhe inventarët.
 9. Paraja në Qarkullim përbëhet nga Emisioni i monedhës minus gjendjen në Arkën e Bankës së Shqipërisë në lekë.
Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive dhe është emetuesi i vetëm i kartëmonedhës dhe i monedhës kombëtare, që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 10. Depozitat e transferueshme të përfshira në paranë e gjerë përfshijnë llogaritë rrjedhëse në lekë të (10.1.1) Individëve dhe të (10.1.2) Institucioneve financiare, pranë Bankës së Shqipërisë.
Depozitat e transferueshme të individëve përfshijnë gjendjen e llogarive rrjedhëse të punonjësve të Bankës së Shqipërisë.
Depozitat e transferueshme të Institucioneve të tjera financiare janë llogaritë rrjedhëse të tyre, të çelura pranë Bankës së Shqipërisë.
Këto depozita janë komponentë të Agregatit M1.
 11. Depozitat e papërfshira në paranë e gjerë janë depozitat e transferueshme sektorëve që nuk janë mbajtës të parasë së gjerë (Korporatat e tjera Depozituese, Qeveria Qendrore, Jorezidentët) depozitat e tjera të sektorëve që nuk janë mbajtës të parasë dhe depozitat e tjera të papërfshira në paranë e gjerë të sektorëve të tjerë të ekonomisë. Më analitikisht :
 - 11.1 Depozitat e transferueshme të papërfshira në paranë e gjerë përfshijnë depozitat e transferueshme të Jorezidentëve (11.1.1.1 & 11.1.2.1), Qeverisë Shqiptare (11.1.1.2 & 11.1.2.2), Korporatave të tjera Depozituese (11.1.1.3 & 11.1.2.3).
 - Në depozitat e transferueshme të jorezidentëve përfshihen ndërmjet të tjerash:
 - Llogaria nr.1 me FMN, e cila është një llogari që përdoret për veprimet operative të Fondit (për shembull blerjet, riblerjet, huatë e Fondit).
 - Llogaria nr.2 me FMN, e cila përdoret për veprimet administrative ndërmjet anëtarit dhe Fondit (për shembull pagesat e publikimeve).

- Llogaritë e garancisë me FMN – Anëtarët mund të zëvendësojnë monedhat e tyre nëpërmjet mbajtjes së letrave me vlerë pa interes. Këto letra janë të pagueshme nga FMN me t'u kërkuar dhe reflektohen në Llogaritë e garancisë.
 - Llogaritë e Bankës Botërore si IBRD, IDA, MIGA.
- Në mbështetje të nenit 25, pika 2 e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë vepron si agjent fiskal i qeverisë. Për të kryer funksionet e Arkës së Buxhetit të shtetit, Banka e Shqipërisë çel në librat e saj llogarinë “Depozitë e Qeverisë në lekë”. Në këtë llogari, pasqyrohen në shtesë të gjitha të ardhurat, financimet e tjera në favor të qeverisë dhe në pakësim të gjitha shpenzimet, pagesat e tjera në ngarkim të Qeverisë.
Banka e Shqipërisë kryhen debitimet në llogarinë “Depozitë e Qeverisë në lekë” në bazë të gjendjes së saj. Kjo llogari nuk lejohet të ketë gjendje debitore. Llogaria “Depozitë e Qeverisë në lekë” me marrëveshje është konsideruar si llogari rrjedhëse dhe për të nuk paguhet interes.
 - Bankat e nivelit të dytë si pjesëmarrëse direkte në sistemin e pagesave mbajnë pranë Bankës së Shqipërisë një llogari rregullimi (llogari rezervë). Kjo llogari përdoret si për kryerjen e pagesave ashtu edhe për mbajtjen dhe llogaritjen e rezervës së detyrueshme të bankës. Gjithashtu, këtu klasifikohen dhe llogaritë në valutë të cilat paraqiten veçmas.
- 11.2 Depozita të tjera të papërfshira në paranë e gjerë janë depozitat pranë Bankës së Shqipërisë, në formën e depozitave të patransferueshme si depozitat pa afat depozitat me afat dhe llogarive të tjera të :

- Qeverisë Shqiptare – ku përfshihen depozitat e qeverisë në lekë në ar, argjend metale të çmuara dhe depozitat në valutë. Natyra e tyre përshkruhet në vijim.

Llogaria “Depozita Ari të Qeverisë” është një llogari pasive, e cila kreditohet për arin në dispozicion të qeverisë si dhe për rivlerësimin në rritje të arit dhe debitohet për arin e shitur Bankës së Shqipërisë dhe rivlerësimin në ulje të arit. E njëjta gjë mund të thuhet për depozitat e qeverisë në Argjend dhe Metale të Çmuara.

Llogaria "Depozita të tjera të Qeverisë" pasqyron veprimet që lidhen me projekte, me fonde ose me financime të ndryshme, për të cilat kushtet përcaktohen që në momentin e hapjes së llogarive me Ministrinë e Financave. Llogaritë e këtij grupi kreditohen për disbursimet e fondeve nga donatorët, pra për furnizimet e bëra në favor të projekteve dhe kreditohet për shumën e fondeve të përdorura sipas përkatësisë së projektit. Teprica, gjithmonë kreditore e kësaj llogarie, tregon shumën e fondeve të disbursuara por ende të papërdorura.

- Korporatave të tjera Depozituese – si depozitat njëditore në lekë, rezervat e detyrueshme në valutë, Llogaritë e garancive dhe depozitat e bllokuara për garanci¹².

¹² Duke qenë se Depozitat e bllokuara për garanci nuk janë pjesë e Bazës Monetare, ato duhen identifikuar veçmas në bilancin e Bankës së Shqipërisë.

Gjendja e llogarive të bllokuara për garanci përfaqëson shuma monetare të bllokuara deri në përfundimin e një veprimi ose në mbarimin e veprimit të një rreziku.

Llogaritë e garancisë përfaqësojnë shuma të depozituara në Bankën e Shqipërisë si garanci e veprimit me klientët siç janë bankat e nivelit të dytë apo klientë të tjerë¹³ në pritje për të marrë licencën.

Këto llogari nënkuptojnë transferim parash ndërsa llogaritë, të cilat nuk nënkuptojnë transferim parash regjistronen jashtë bilancit.

- Institucioneve të tjera financiare vendase – ku përfshihen llogari të garancive dhe depozita të bllokuara për garanci të këtyre institucioneve.
- Në 11.2.1.4; 11.2.1.5; 11.2.2.4; 11.2.2.5 klasifikohen depozita të tjera të papërfshira në parane e gjerë të njëjësive jofinanciare në Bankën e Shqipërisë.

12. Huatë përfshijnë huatë e marra nga Banka e Shqipërisë nga:

12.1. Jorezidentët – si qeveritë e huaja, bankat e huaja dhe institucionet ndërkombëtare.

12.2. Korporatat e tjera Depozituese në formën e Marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes.

12.3. Qeveria Shqiptare, si në rastin e marrëveshjes së nënhuasë për sistemin korrier.

13. Llogari të tjera të pagueshme përfshijnë të gjitha llogaritë e detyrimeve të papërfshira më sipër si :

Llogaritë e Jorezidentëve – si llogaritë e FMN-së pranë Bankës së Shqipërisë, të cilat kreditohen me urdhër të FMN-së në kuadrin e programeve ESAF dhe Stand By.

Llogari të tjera të pagueshme si detyrimet për fondet e kontributit të personelit të Bankës së Shqipërisë, detyrimet për tatimet mbi të ardhurat, dividenti për t'u paguar i cili përfaqëson pjesën e fitimit të Bankës së Shqipërisë për t'u derdhur në Buxhetin e Shtetit, furnitorët, shpenzimet e llogaritura dhe të ardhurat e shtyra, llogaritë e marrëdhënieve, llogaritë pezull, llogaritë e pozicionit, llogaritë e kleringut dhe pagesat për t'u kryer si dhe shumat e parashikuara (provigjionet) për borxhet e dyshimta dhe pa shpresë arkëtimi, të cilat krijohen nga zbritja e fitimit të Bankës së Shqipërisë– që janë detyrime të tjera të rezidentëve të paklasifikuara diku tjetër.

14. Llogaritë kapitale përfshijnë kapitalin, fondet rezervë, llogaritë e fitim/ humbjeve, provigjionet e përgjithshme, llogaritë e rivlerësimit të mjeteve dhe fitimin e pashpërndarë.

Fondi i Themelimit të Bankës së Shqipërisë është 750 milionë lekë. Ai mund të rritet me propozimin e Bankës së Shqipërisë dhe me miratimin e Ministrisë së Financave. I tërë Fondi i Themelimit akordohet dhe është në pronësi ekskluzive të Shtetit Shqiptar. Ky fond nuk mund të transferohet ose të hipotekohet.

Rezervat përfaqësojnë pjesën e fitimeve të periudhave të mëparshme, të cilat mbahen nga Banka për një periudhë afatgjatë mbi bazën e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Tipet e rezervave janë:

¹³ Depozitat e garancisë të klientëve të tjerë klasifikohen tek “Institucione të Tjera Financiare”.

- Rezerva ligjore. Sipas ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë krijon fondin e rezervës së përgjithshme. Në fund të çdo viti financiar ky fond shtohet me një shumë prej 25 për qind të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë, derisa fondi i rezervës së përgjithshme të arrijë në 500 për qind të fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë.
- Rezervat e rivlerësimit përfaqësojnë kundërpartinë e rivlerësimit të mjeteve dhe detyrimeve të shprehura në valutë të huaj, si dhe të mjeteve të qëndrueshme.
- Rezerva Speciale dhe Ndihma, përfshijnë ndihmat e akorduara nga institucionet ndërkombëtare amortizimi i të cilave ndodh njëkohësisht me amortizimin e mjetit të qëndrueshëm të dhuruar, si dhe Rezerva Speciale për Bilancin e Pagesave. Fondi i mbështetjes së Bilancit të Pagesave zakonisht jepet për të ndihmuar vendet përfituese, në përmirësimin e pozicionit të tyre. Ai nuk është grant për buxhetin e vendeve përfituese por konsiderohet si një rezervë speciale për Bankën Qendrore, aktivet në valutë të së cilës kanë qenë zvogëluar nga deficieti i vazhdueshëm i bilancit të pagesave siç është rasti i Bankës së Shqipërisë.
- Rezerva statutore, llogari e cila përmban rezerva të përcaktuara në statutet e Bankës së Shqipërisë.
- Rezerva të tjera si për shembull, rezervat për fondin e pensionit.

Fitimet e pashpërndara përfaqësojnë pjesë të fitimeve të akumuluar nga periudhat e mëparshme, të cilat nuk janë shpërndarë në rezerva ose dhënë Qeverisë në formë dividendi. Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor nuk përfshihet në fitimet e pashpërndara.

Provizjonet përfshijnë shumat e parashikuara për zhvlerësimin e aktiveve të Bankës së Shqipërisë.

Aneks 2 : Bilanci Sektorial – Bankat Para Depozituese.

Bankat Para Depozituese ose bankat e nivelit të dytë përfaqësojnë pjesën më të madhe të nënsektorit të Korporatave të Tjera Depozituese në Shqipëri.

Të dhënat për ndërtimin e bilancit sektorial të Bankave Para Depozituese merren nga bilancet kontabël të bankave të nivelit të dytë. Bilanci Sektorial i Bankave Para Depozituese ka formën e paraqitur në tabelën 2 me këta komponentë kryesorë:

| | Aktivi | | Pasivi |
|-------|--|----------|---|
| 1 | Monedha dhe kartëmonedha në lekë | 10 | Depozita të përfshira në paranë e gjerë |
| 2 | Monedha dhe kartëmonedha në valutë | 10.1 | Depozita të transferueshme |
| 3 | Depozita të transferueshme | 10.1.1 | <i>Në lekë</i> |
| 3.1 | <i>Në lekë</i> | 10.1.1.1 | Institucione të tjera financiare |
| 3.1.1 | Jorezidentët | 10.1.1.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 3.1.2 | Banka e Shqipërisë | 10.1.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 3.1.3 | Bankat Para Depozituese | 10.1.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 3.2 | <i>Në valutë</i> | 10.1.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 3.2.1 | Jorezidentët | 10.1.2 | <i>Në valutë</i> |
| 3.2.2 | Banka e Shqipërisë | 10.1.2.1 | Institucione të tjera financiare |
| 3.2.3 | Bankat Para Depozituese | 10.1.2.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 4 | Depozita të tjera | 10.1.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 4.1 | <i>Në lekë</i> | 10.1.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 4.1.1 | Jorezidentët | 10.1.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 4.1.2 | Banka e Shqipërisë | 10.2 | Depozita të tjera |
| 4.1.3 | Bankat Para Depozituese | 10.2.1 | <i>Në lekë</i> |
| 4.2 | <i>Në valutë</i> | 10.2.1.1 | Institucione të tjera financiare |
| 4.2.1 | Jorezidentët | 10.2.1.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 4.2.2 | Banka e Shqipërisë | 10.2.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 4.2.3 | Bankat Para Depozituese | 10.2.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 5 | Letra me vlerë përveç aksioneve | 10.2.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 5.1 | Jorezidentët | 10.2.2 | <i>Në valutë</i> |
| 5.2 | Qeveria Shqiptare | 10.2.2.1 | Institucione të tjera financiare |
| 6 | Huatë | 10.2.2.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 6.1 | Jorezidentët | 10.2.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 6.2 | Banka e Shqipërisë | 10.2.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 6.3 | Bankat Para Depozituese | 10.2.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 6.4 | <i>Institucione jodepozituese financiare</i> | 11 | Depozita të papërfshira në paranë e gjerë |
| 6.5 | Qeveria Qendrore | 11.1 | Depozita të transferueshme |
| 6.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike | 11.1.1 | <i>Në lekë</i> |
| 6.7 | Korporata jofinanciare publike | 11.1.1.1 | Jorezidentët |
| 6.8 | Korporata të tjera jofinanciare | 11.1.1.2 | Banka e Shqipërisë |
| 6.9 | Sektorë të tjerë rezidentë | 11.1.1.3 | Bankat Para Depozituese |
| 7 | Aksionet dhe Kapitali tjetër | 11.1.1.4 | Qeveria Qendrore |
| 8 | Mjete të tjera financiare | 11.1.2 | <i>Në valutë</i> |
| 9 | Mjete jofinanciare | 11.1.2.1 | Jorezidentët |
| | | 11.1.2.2 | Banka e Shqipërisë |
| | | 11.1.2.3 | Bankat Para Depozituese |

| | | |
|--|----------|---|
| | 11.1.2.4 | Qeveria Qendrore |
| | 11.2 | Depozita të tjera |
| | 11.2.1 | Në lekë |
| | 11.2.1.1 | Jorezidentët |
| | 11.2.1.2 | Banka e Shqipërisë |
| | 11.2.1.3 | Bankat Para Depozituese |
| | 11.2.1.4 | Institucione të tjera financiare |
| | 11.2.1.5 | Qeveria Qendrore |
| | 11.2.1.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| | 11.2.1.7 | Korporata jofinanciare publike |
| | 11.2.1.8 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 11.2.1.9 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 11.2.2 | Në valutë |
| | 11.2.2.1 | Jorezidentët |
| | 11.2.2.2 | Banka e Shqipërisë |
| | 11.2.2.3 | Bankat Para Depozituese |
| | 11.2.2.4 | Institucione të tjera financiare |
| | 11.2.2.5 | Qeveria Qendrore |
| | 11.2.2.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| | 11.2.2.7 | Korporata jofinanciare publike |
| | 11.2.2.8 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 11.2.2.9 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 12 | Huatë |
| | 12.1 | Jorezidentët |
| | 12.2 | Banka e Shqipërisë |
| | 12.3 | Bankat Para Depozituese |
| | 12.4 | Institucione të tjera financiare |
| | 12.5 | Qeveria Qendrore |
| | 12.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| | 12.7 | Korporata jofinanciare publike |
| | 12.8 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 12.9 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 13 | Llogari të pagueshme |
| | 14 | Llogaritë kapitale |

Tabelë.2 - Bilanci Sektorial i Bankave Para Depozituese.

1. *Monedha dhe kartëmonedha në lekë* përfshijnë arkën në lekë të Bankave Para Depozituese. Arka përfaqëson banknotat, monedhat metalike dhe çeqet e udhëtarit në lekë të poseduara fizikisht nga banka dhe që janë menjëherë të disponueshme. Numizmatika dhe metalet e çmuara nuk klasifikohen këtu por trajtohen si mjete jofinanciare (inventar).
2. *Monedha dhe kartëmonedha në valutë* përfshijnë arkën e Bankave Para Depozituese në valutë, të konvertuar me kursin e ditës së fundit të muajit.
3. *Depozita të Transferueshme* përfshijnë llogaritë rrjedhëse të Bankave Para Depozituese në institucionet financiare.

Llogaritë rrjedhëse zakonisht përdoren për veprime rrjedhëse (ditore) me bankat e tjera, si pastrimi i marrëdhënieve për çeqet, transfertat dhe të gjitha shumat që vihen në dispozicion ose që paguhen në mënyrë të pandërprerë në një veprim depozite ose huaje me institucionin. Llogaritë rrjedhëse me bankat dhe me institucionet e tjera financiare, përfaqësojnë llogaritë e bankës të çelura në banka dhe në institucione financiare (llogaritë Nostro) ose llogaritë e bankave dhe të institucioneve të tjera të çelura në bankë (llogaritë Loro).

Në këtë grup klasifikohen, gjithashtu, edhe Llogaritë rrjedhëse të parregullta dhe Llogaritë rrjedhëse të dyshimta, të vendosura në bankat dhe institucionet financiare. Këto llogari klasifikohen këtu pasi ato nuk konsiderohen se përfaqësojnë një rrezik apriori, dhe për to nuk regjistrohen fonde rezervë. Interesat e përlllogaritur klasifikohen bashkë me instrumentin që shoqërojnë.

Depozitat e transferueshme ndahen sipas monedhës dhe sipas sektorëve.

4. *Depozita të tjera* përfshijnë depozitat me afat, pa afat dhe llogaritë e tjera të bankave në institucionet financiare.

Depozitat përfaqësojnë shumën e depozituara në bankat e tjera për të cilat është rënë dakord të kenë një datë shlyerjeje dhe një normë interesi.

Depozitat në banka ndahen në dy kategori në varësi të afatit fillestar të tyre:

- Depozita pa afat, kur depozitat kanë një afat maturimi më të vogël se një ditë pune.
- Depozita me afat kur depozitat kanë një afat maturimi më të madh se një ditë pune.

Llogaritë e tjera me bankat, me institucionet e kreditit dhe me Institucionet e Tjera Financiare përfshijnë llogaritë e garancive dhe llogaritë e bllokuara për garanci me bankat, institucionet e kreditit dhe Institucionet e Tjera Financiare.

Gjendja e llogarive të bllokuara për garanci, përfaqëson shumën monetare të bllokuara deri në përfundimin e një veprimi ose në mbarimin e veprimit të një rreziku. Llogaritë e garancisë përfaqësojnë shumën e depozituara në një bankë për të garantuar veprimet me bankën, me institucionin e kreditit ose me institucionin financiar.

Interesat e përlllogaritur klasifikohen bashkë me instrumentin që shoqërojnë.

Depozitat e tjera ndahen sipas monedhës dhe sipas sektorëve.

Në këtë grup klasifikohen, gjithashtu, edhe llogaritë e rezervës së detyrueshme në lekë dhe valutë me bankën qendrore.

5. *Letra me vlerë përveç aksioneve* përfshijnë investimet e bankave në letra me vlerë të jorezidentëve (Jorezidentët) dhe në Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, si bonot e thesarit apo obligacionet e qeverisë.

6. *Huatë* përfshijnë huatë e dhëna nga banka në formën e instrumenteve si huatë direkte, kreditë me llogari zbuluar, marrëveshjet e riblerjes, kredia Lombard (me Bankën Qendrore). Duke qenë se të dhënat për huanë janë veçanërisht të rëndësishme, kjo kategori, përveç se sipas sektorëve, ndahet më tej në bazë të monedhës në të cilën është akorduar dhe të cilësisë së huasë. Në përputhje me parimet e përshkruara në këtë metodikë, huatë paraqiten në vlerën e tyre nominale pa i zbritur provigjonet.

Disa hua jepen nga institucionet financiare ndërkombëtare (p.sh Banka Botërore), nga një institucion i huaj krediti ose qeveria për institucionet tregtare shqiptare. Banka, e cila vepron në emër të institucionit, merr fondin nga institucioni i huaj i kreditit dhe më pas ja jep huanë një institucioni tregtar të caktuar.

Në këtë rast, regjistrohen dy veprime (1) banka njihet detyrimin e saj kundrejt institucionit të huaj të kreditit ose ndaj qeverisë duke e kontabilizuar atë si huamarrje nga jorezidentët dhe nga Qeveria (2) banka regjistron një hua kundrejt klientit.

Huatë për bankat dhe për institucionet e tjera financiare grupohen në tre kategori në varësi të afatit fillestar dhe të karakteristikave fillestare të tyre:

- Huatë pa afat, kur huatë kanë periudhë maturimi më të vogël se një ditë pune.
- Huatë me afat, kur huatë kanë maturim më të madh se një ditë pune.
- Huatë financiare janë hua për të cilat një palë e tretë është një institucion financiar jorezident, por përfituesi përfundimtar i huasë është një institucion tregtar. Kjo llogari zakonisht përdoret për veprimet e eksportit ose të financimit të investimeve nga jashtë. Huatë e pakthyera në afat dhe huatë e dyshimta me bankat dhe me institucionet e tjera financiare, përfaqësojnë hua në të cilat një këst nuk është kthyer plotësisht ose pjesërisht.

Huatë për klientët e tjerë (përveç bankave dhe institucioneve financiare) klasifikohen në këto klasa sipas cilësisë së tyre:

- Huatë Standarde dhe të pakthyera në afat. Huatë standarde janë huatë, të cilat banka i konsideron se janë (1) të garantuara mirë, gjendja financiare e huamarrësit është e shëndoshë dhe pagesa parashikohet të jetë në përputhje me afatet e huasë. Në të njëjtën kohë, ka fakte që gjendja financiare e huamarrësit nuk do të ndryshojë; (2) të garantuara plotësisht nga një palë e tretë, e cila është në gjendje të përmbushë detyrimet nëse lind nevoja. Kjo është e vërtetë për huatë plotësisht të garantuara nga një institucion ndërkombëtar.

Kur një këst nuk paguhet pjesërisht ose plotësisht dhe nuk parashikohet asnjë rrezik për moskthim (huaja është plotësisht e garantuar), shuma e papaguar duhet automatikisht të riklasifikohet në llogarinë e huave standarde të pakthyera në afat. Huatë e pakthyera në afat, a priori, nuk përfaqësojnë rrezik.

- Huatë në ndjekje. Huatë në ndjekje janë huatë për të cilat (1) gjendja financiare e huamarrësit është aktualisht e mjaftueshme për dobësitë potenciale ekzistojnë dhe nëse nuk korrektohen, do të rezultojnë në një dobësim të pozicionit të kreditit të bankës në një datë të ardhme; (2) kryegjëja dhe interesi, - në rastin e huave me këste - janë të pakthyera në afat për 30 - 90 ditë; (3) në rastin e huave jo me këste (kur huatë nuk shlyhen sipas një plani këstesh), shlyerja nuk kryhet në datën e maturimit dhe e tejkalon atë për 31 - 90 ditë.
- Huatë nënstandarde. Huatë nënstandarde janë huatë, të cilat përmbushin një nga kushtet e mëposhtme (1) ato nuk janë të siguruara në mënyrë të mjaftueshme nga vlera e tregut e kolateralit; (2) gjendja financiare e huamarrësit është më pak se e kënaqshme. Në thelb, burimet parësore të shlyerjes janë të pamjaftueshme për të kënaqur borxhin dhe banka duhet të drejtohet tek burimet dytësore për shlyerje; (3)

paaftësia për të shlyer borxhin ka rezultuar në nevojë për ta ristrukturuar atë; (4) në rastin e huave me këste, një këst nuk është paguar në afat për 90-180 ditë.

- Huatë e dyshimta. Mjetet e dyshimta paraqesin të gjitha dobësitë e treguara më sipër për huatë nënstandarde dhe një nga kushtet e mëposhtme (1) një shqyrtim i gjendjes financiare të huamarrësit paraqet një mundësi të dallueshme, që huamarrësi nuk do të jetë i aftë të shlyejë plotësisht detyrimin ndaj një huaje ose nga borxhi tjetër të detyruar nga banka; (2) ekziston një rrezik real për huamarrësin që të deklarohet me paaftësi paguese; (3) në rastin e huave me këste, njëri nga këstet e ka kaluar afatin e kthimit për 180 - 360 ditë; (4) klienti nuk ka paguar huanë në afat për 90 - 180 ditë, në rastin e huave jo me këste; (5) huatë janë ristrukturuar më shumë se dy herë.
- Huatë e humbura. Mjetet e klasifikuara si të humbura, trajtohen si të pambledhshme dhe vazhdimësia e tyre si mjete bankare nuk është e justifikueshme. Përveç pasjes së karakteristikave të huave të dyshimta, ekzistojnë dhe kushtet e mëposhtme (1) gjendja financiare e huamarrësit tregon në mënyrë të qartë paaftësi për të përmbushur plotësisht afatet e borxhit ndaj bankës; (2) huamarrësi përfshihet në një proces likuidimi dhe ekziston një rrezik real për disa kreditorë që të mbeten të pakënaqur; (3) në rastin e huave me këste, një nga këstet e ka kaluar afatin e kthimit për më shumë se 360 ditë; (4) klienti nuk ka paguar huanë në afat për 90 - 180 ditë, në rastin e huave jo me këste.
Huatë e klasifikuara si të humbura trajtohen të pambledhshme dhe me kaq pak vlerë saqë vazhdimi i mbajtjes së tyre si mjete bankare nuk është i justifikuar. Klasifikimi si të humbura nuk do të thotë që mjete nuk ka absolutisht vlerë të mbetur ose kthimi. Deri sa të jenë kaluar të gjitha procedurat ligjore, kjo hua klasifikohet e humbur.

Në grupin e huave klasifikohen edhe llogaritë rrjedhëse debitore të klientëve të bankës, si dhe marrëveshjet e riblerjes.

7. *Aksione dhe kapitali tjetër* përfshijnë interesat pjesëmarrëse dhe filialet. Filialet përfaqësojnë pjesë pronësie (aksione etj.) në kapitalin e shoqërive, të cilat banka ka për qëllim t'i mbajë për një periudhë të gjatë kohe dhe të cilat gjykohen si të dobishme për veprimtarinë e bankës. Në parim pjesa e kapitalit të poseduar duhet të kalojë 10 për qind.
Kur një bankë posedon më shumë se 50 për qind të filialit, filiali konsiderohet në varësi të bankës. Interesat pjesëmarrës janë një investim në kapital ku pjesa e pronësisë përfaqëson më pak se 10 për qind të kapitalit të shoqërisë.
8. *Mjete të tjera financiare* përfshijnë të gjitha mjetet e tjera të bilancit të bankave, të cilat nuk janë klasifikuar diku tjetër. Ky grup llogarish përfaqëson mjetet dhe detyrimet të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me transaksionet ndërbankare, me huatë për klientët, me letrat me vlerë dhe mjetet e qëndrueshme. Në përgjithësi ato përfshijnë llogaritë e të tretëve me të cilët banka ka lidhje për mbështetjen e llogarive të saj si: furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të përgjithshme, debitorë të ndryshëm, llogaritë e pagave.
Në këtë grup, hyjnë llogaritë që lidhen me:
 - TVSH.

- Furnitorë për t'u arkëtuar; ka të bëjë me shumat që i detyrohen furnitorët (siç janë paradhëniet e paguara nga banka për furnitorët). Kjo situatë shpesh rezulton nga fakti që banka mund të kërkojë depozitë garancie.
- Depozita garancie të paguara; ka të bëjë me depozitat e garancisë të lidhura me veprimtaritë jobankare siç janë një depozitë garancie për një qira.
- Taksa për t'u arkëtuar; janë parapagesat për taksat mbi të ardhurat të bëra gjatë periudhës. Në datën e mbylljes gjendja (teprica) e kësaj llogarie duhet të paraqitet për neto kundrejt tepricës kreditore të llogarisë me qëllim që të përfaqësojë shumën për t'u marrë nga administrata taksore në lidhje me periudhën.
- Debitorë të tjerë; çdo llogari tjetër për t'u arkëtuar, e cila nuk mund të klasifikohet dhe të regjistrohet në llogaritë e përcaktuara në Planin e Llogarive, përgjithësisht regjistrohet në këtë llogari.
- Shpenzimet e parapaguara; shpenzimet e parapaguara përfaqësojnë shpenzime që janë paguar paradhënie për furnitorët dhe që i përkasin një periudhe të ardhme. Në këtë rast, për shembull, për pjesën e qirasë paguar paradhënie për periudhën pasuese të datës së bilancit.
- Shpenzime për t'u amortizuar për disa vite. Disa shpenzime të kryera nga banka mund t'i përkasin transaksioneve, të cilat sjellin përfitime për disa vite. Në këto rrethana këto shpenzime mund të amortizohen përgjatë gjithë kohës së kryerjes së transaksionit nëse mund të përcaktohet rentabiliteti total i transaksionit. Shpenzime të tilla përfshijnë midis të tjerash komisionet e blerjes së mjeteve të qëndrueshme të pakapitalizuara, primet për emetimin e borxhit ose primet për shlyerjen e borxhit.

9. *Mjetet jofinanciare* përfshijnë mjetet e qëndrueshme si toka, ndërtesa dhe llogaritë e magazinave.

10. Depozitat e përfshira në paranë e gjerë, përbëhen nga depozitat e transferueshme dhe depozitat e tjera të përfshira në paranë e gjerë të sektorëve rezidentë jobankarë (duke përjashtuar qeverinë Qendrore).

Në bazë të këtij klasifikimi qëndron përkufizimi kombëtar i agregatit M3 të parasë.

10.1 Depozitat e transferueshme përfshijnë llogaritë rrjedhëse të institucioneve të tjera financiare, të Qeverisë lokale dhe të Administratës publike, të Korporatave Jofinanciare Publike, të Korporatave të Tjera Jofinanciare dhe të Sektorëve të Tjerë Rezidentë pranë bankave të nivelit të dytë.

Llogaritë rrjedhëse të klientëve regjistrojnë depozitimet dhe tërheqjet, çeqet e mbledhura ose të lëshuara, transfertat e marra ose të bëra dhe të gjitha transaksionet në para, të kryera me çdo mjet në përfitim të klientit dhe në ngarkim të tij. Gjendja e llogarisë rrjedhëse është e disponueshme ose e prekshme brenda 24 orëve nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe.

Kur për llogaritë rrjedhëse paguhet interes, llogaritja e interesit bazohet në kushtet e kontratës në lidhje me datën e fillimit dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, me normën e interesit dhe me shumën emërore që do të merret parasysh. Llogaritja e interesave për llogaritë rrjedhëse për të cilat paguhet interes zakonisht bazohet në gjendjen ditore mbi të cilën zbatohet norma e ndryshueshme pa afat (gjatë natës) në shitje.

Interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë.

10.2 Depozita të tjera përfshijnë depozitat me afat, depozitat pa afat, çertifikatat e depozitave të Institucioneve të tjera financiare, të Qeverisë lokale dhe të Administratës publike, të Njësive jofinanciare publike, të Njësive të tjera jofinanciare dhe të Sektorëve të tjerë rezidentë pranë bankave të nivelit të dytë në lekë dhe në valutë, si dhe depozitat e transferueshme të këtyre sektorëve në valutë.

Duke qenë se depozitat pa afat dhe llogaritë rrjedhëse në lekë të sektorëve rezidentë jobanka (duke përjashtuar qeverinë qendrore) bashkë me paranë jashtë bankave formojnë agregatin M1 të parasë, depozitat pa afat në lekë identifikohen veçmas depozitave me afat.

Duke i shtuar agregatit M1 depozitat e tjera në lekë të sektorëve rezidentë jobanka (duke përjashtuar qeverinë qendrore) formohet agregati M2. Duke i shtuar agregatit M2 depozitat e transferueshme dhe depozitat e tjera në valutë të sektorëve rezidentë jobanka (përjashtuar qeverinë qendrore) formohet agregati M3 i parasë.

Depozitat përfaqësojnë shumat e depozituara në “Bankë” nga klienti me një datë shlyerjeje dhe me një normë interesi të pranuar.

Depozitat kontabilizohen në datën fillestare të tyre si detyrim. Në datën e maturimit depozitat shlyhen ose (zakonisht nëpërmjet llogarisë rrjedhëse) rinovohen për një tjetër periudhë të pranuar.

Llogaritja e interesit bazohet në kushtet e kontratës në lidhje me datën e fillimit dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, me normën e interesit dhe me shumën emërore që do të merret parasysh.

Depozitat nuk mund të disponohen ose të preken para datës së maturimit nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe.

11. Depozita të papërfshira në paranë e gjerë përfshijnë të gjitha llogaritë në formën e depozitave, të llogarive rrjedhëse, të çeqeve për arkëtim dhe të llogarive të tjera të Jorezidentëve, të Bankës Qendrore, të Bankave Para Depozituese, të Qeverisë Qendrore si dhe të llogaritë e tjera të klientëve.

Llogaritë e tjera të klientëve janë:

- Llogaritë për mbulimin e çeqeve.
Llogaritë për mbulimin e çeqeve përdoren për të mbuluar çeqet e lëshuara nga klienti ose nga banka, në favor të përfituesit të përcaktuar nga klienti. Kjo shumë përdoret kundrejt pagesës kur çeku paraqitet për kompensim.
- Llogari garancie.
Llogaritë e garancisë përfaqësojnë shumat të depozituara në “bankë” si garanci e veprimeve të klientit. Garancitë, të cilat nuk nënkuptojnë transferim parash (garanci e nënshkruar) regjistrohen jashtë bilancit.
- Llogari të bllokuara për garanci.
Gjendja e llogarive të bllokuara për garanci përfaqëson shumat të bllokuara momentalisht deri në përfundimin e një veprimi ose të një rreziku. Sasitë që lidhen me to regjistrohen në këtë llogari.
- Llogaritë e mbulimit të letërkredive.
Llogaritë e mbulimit të letërkredive përfaqësojnë shumat të bllokuara momentalisht deri në përfundimin e veprimit midis klientit dhe furnitorit të tij. Kjo

shumë përdoret për t'i shlyer "Bankës" shumën që është paguar nëpërmjet letërkredisë për bankën korresponduese ku furnitori është klient.

Në depozitat e papërfshira në paranë e gjerë përfshihen edhe çeqet për arkëtim të janë çeqe të dhëna institucioneve pastruese të marrëdhënieve gjatë periudhës midis datës kur çeqet u janë dorëzuar këtyre institucioneve dhe datës kontraktore për pagesë.

12. *Huatë* janë detyrimet e Bankave Para Depozituese në formën e kredisë direkte, të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (nga Banka Qendrore), dhe Borxhi i varur më pak se 5 vjet.

Borxhi i varur ka të bëjë me huamarrjet e bankës të cilat, në rast likuidimi, janë të dorës së dytë kundrejt shlyerjes (rimbursimit) së kreditorëve të tjerë (domethënë, huadhënësi nuk mund të shlyhet derisa të mos jenë shlyer kreditorët e tjerë). Këto "hua" shpesh u jepen aksionerëve të bankës. Nëse për to paguhet interes, interesat e përlogaritur duhet të llogariten mbi huamarrjet.

13. *Detyrime të tjera* përfshijnë të gjitha detyrimet e tjera që nuk janë klasifikuar në kategoritë e mësipërme. Në këtë zë klasifikohen:

- Furnitorët. Furnitorët përfaqësojnë detyrimin për furnizimet e përdorura për veprimet e ditës të bankës (energji elektrike, mjete të qëndrueshme etj.).
- Depozita garancie të marra. Kjo llogari ka të bëjë me depozitat e garancisë të lidhura me veprimtaritë jobankare. Garancia e marrë nga klientët ose nga bankat e tjera në lidhje me transaksionet bankare regjistrohet në llogaritë përkatëse të klientëve ose të transaksioneve ndërbankare.
- Taksat për t'u paguar. Fondi rezervë për taksat mbi të ardhurat për periudhën regjistrohet në këtë llogari. Të gjitha taksat e ndryshme nga taksat mbi të ardhurat të cilat nuk janë paguar përlogariten dhe regjistrohen në këtë llogari.
- Dividendët për t'u paguar. Dividentët e miratuar nga asambleja e aksionerëve duhet të regjistrohen në këtë llogari për sa kohë që nuk u paguhen aksionerëve.
- Të ardhura të shtyra dhe shpenzime të tjera të përlogaritura. Shpenzimet e llogaritura përfaqësojnë shpenzimet e shkaktuara gjatë periudhës por të papaguara faktikisht në datën e hartimit të bilancit dhe regjistrohen si detyrim në bilanc.
Shpenzimet e llogaritura përfshijnë përgjithësisht pagat për t'u paguar punonjësve dhe shpenzimet shoqërore për t'u paguar.
Në përgjithësi, të ardhurat e shtyra përfaqësojnë fonde (ose para) të marra gjatë vitit, por të cilat i përkasin periudhave të ardhme.
- Veprime si agjent neto. Këto llogari përdoren kur banka vepron si agjent për sigurimet shoqërore, për fondin e asistencës, për llotaritë, për administrimin fiskal, doganat dhe për çdo organizatë tjetër publike ose parapublike. Ato mund të përdoren vetëm për transaksione ndërmjetëse.
- Llogaritë e marrëdhënieve neto. Kjo llogari ka të bëjë me veprimet midis drejtorive të përgjithshme dhe degëve, agjencive dhe zyrave bankare, midis vetë degëve, midis degëve dhe agjencive etj.

- Pagesat për t'u kryer, e cila përdoret për të regjistruar pagesat e bëra por, për të cilat nuk është marrë konfirmimi i palës tjetër për transaksionin ose pagesa është marrë por nuk njihet përfituesi.
- Llogaritë e pastrimit të marrëdhënies.
- Pagesat me bankomat - llogari tranzitore – e cila regjistron paranë e paguar nëpërmjet një bankomati një klienti nga një bankë tjetër gjatë periudhës midis datës kur paraja i jepet fizikisht klientit dhe rimbursimit kontraktor të parasë fizike nga banka debitore.
- Llogaritë e pozicioneve.
- TVSH për t'u mbledhur; kjo është sasia që i detyrohet shtetit për shkak të faturimit të TVSH-së klientëve.
- Fondet rezervë për kryegjënë për mbulimin e humbjeve nga huatë kërkohen me qëllim që të mbahet një gjendje minimale e rezervës. Fondet rezervë në bazë të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë llogariten sipas normave minimale të mëposhtme:

| | |
|----------------------|--------------|
| Huatë nënstandarde : | 20 për qind |
| Huatë e dyshimta : | 50 për qind |
| Huatë e humbura : | 100 për qind |

Për interesat e përlogaritur të huave nënstandard, të dyshimta dhe të humbura, duhet të krijohet fond rezervë në masën 100 për qind.

Fonde rezervë për amortizimin e debitorëve të ndryshëm.

Kur ekziston rreziku që një llogari aktive të mos arkëtohet duhet regjistruar një fond rezervë për amortizimin. Banka duhet të kryejë të paktën një herë në vit një inspektim të debitorëve të tjerë për të vlerësuar mundësinë e arkëtueshmërisë së tyre dhe nëse gjykohet e nevojshme, për të vlerësuar fondet rezervë për amortizim të cilat duhen regjistruar.

14. *Llogaritë kapitale* përfshijnë kapitalin aksionar, fondet rezervë, llogaritë e fitim/humbjeve, provigjonet e përgjithshme (për shembull provigjone për rrezikun statistikor) dhe llogaritë e rivlerësimit të mjeteve, dhe fitimin e pashpërndarë.

Kapitali aksionar, përfaqëson fondet e investuara në bankë nga aksionerët për periudhë kohore të pakufizuar. Përgjithësisht, ky kapital është i pakthyeshem po qe se nuk vendoset nga asambleja e aksionerëve.

Kapitali i paguar përfaqëson vlerën emërore të aksioneve të emetuara dhe të paguara faktikisht nga aksionerët.

Primet e aksioneve, përfaqësojnë shumën e paguar nga aksionerët në tejkalim të vlerës emërore të aksioneve të emetuara nga banka.

Rezervat, përfaqësojnë fitimet e pashpërndara të periudhave të mëparshme, të cilat mbahen nga banka për periudhë afatgjatë dhe të cilat rezultojnë nga vendimet e organizmave kompetentë (siç janë asamblatë e aksionerëve) ose nga zbatimi i rregullave specifike statutores dhe ligjore.

Diferenca e llogarisë së rivlerësimit, ka të bëjë me kapitalin në valutë. Në mbyllje, kapitali në valutë do të vlerësohet me kursin fiks të mbylljes, por do të mbahet me

vlërën fillestare në bilanc. Diferenca midis vlerës fillestare dhe vlerës aktuale regjistrohesh si diferencë në llogarinë e rivlerësimeve.

Fitimet e pashpërndara, përfaqësojnë pjesë të fitimeve të akumuluar nga periudhat e mëparshme, të cilat nuk janë shpërndarë në rezerva ose nuk janë shpërndarë aksionerëve në formë dividendësh. Fitimi (humbja) e vitit ushtrimor nuk përfshihet në fitimet e pashpërndara.

Ndihmat dhe financimi publik, përfshijn dhuratat e marra nga një bankë prej shtetit ose prej një organizate tjetër. Kur një ndihmë i korrespondon një mjeti (për shembull, ndërtesë, bono thesari), mjeti regjistrohesh në bilanc me vlerën e tij të tregut në kohën e dhënies së ndihmës, kundrejt kreditimit të një llogarie detyrimi të quajtur "Ndhma". Kjo llogari amortizohesh në mënyrë të njëjtë me mjetin e qëndrueshëm.

Fondet rezervë për rreziqe dhe shpenzime, janë çdo shumë e mbajtur (ruajtur) e gjykuar si e nevojshme për qëllime të sigurimit të çdo detyrimi ose humbjeje, i cili ose ka të ngjarë të shkaktohet ose është e sigurt se do të shkaktohet por nuk është e sigurt se në çfarë shume ose në çfarë date.

Fondi rezervë për rrezikun statistikor, llogaritet për huatë standarde dhe për huatë në ndjekje. Fondi rezervë dokumentohesh dhe llogaritet në bazë të statistikave të cilat përcaktojnë shumën e humbjeve të mundshme që do të shkaktohet në popullsinë e këtyre huave, e cila në tërësi mund të trajtohet si përfaqësuese e rrezikut.

Fondet rezervë për humbjet nga huatë kërkohen me qëllim që të mbahet një gjendje minimale e rezervës me një shumë të barabartë me :

* Huatë standarde (përfshi huatë e pakthyera në afat) : 1 për qind

* Huatë në ndjekje : 5 për qind

Fondi rezervë minimal i përcaktuar më sipër llogaritet si për kryegjënë dhe për interesin e përlllogaritur.

Fonde rezervë për amortizim të huave nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura.

Fonde rezervë për amortizimin kontabilizohen çdo herë që banka sheh se ka rrezik lidhur me arkëtimin tërësor ose pjesor të një huaje. Norma e përcaktuar për fondin rezervë do të mbulojë të gjitha humbjet e identifikuar potenciale aktuale dhe të ardhme. Ajo bazohesh në vlerësimin e rrezikut, në historinë e kredisë së klientit, në gjendjen e tij financiare aktuale dhe të parashikuar, në vlerën dhe në mundësinë për të vënë dorë mbi garancinë dhe kolateralin dhe në çdo fakt tjetër që mund të merret në konsideratë në vlerësimin e rrezikut të mospagimit.

Vlerësimi i nivelit të mjaftueshëm të nevojshëm të fondeve rezervë duhet të kryhet në çdo datë mbylljeje.

Aneks 3 : Bilanci Sektorial – Shoqëritë e Kursim – Kreditit.

Shoqëritë e Kursim-Kreditit janë kategoria e dytë e Sektorit të Korporatave të Tjera Depozituese në Shqipëri. Bilanci sektorial i tyre paraqitet në këtë formë të përmbledhur.

| | Aktivi | | Pasivi |
|-------|------------------------------------|--------|--|
| 1 | Monedha dhe kartëmonedha në lekë | 9 | Depozita të tjera të përfshira në paranë e gjerë |
| 2 | Monedha dhe kartëmonedha në valutë | 9.1 | Në lekë |
| 3 | Depozita të transferueshme | 9.1.1 | Individët |
| 3.1 | Në lekë | 9.1.2 | Korporatat e tjera jofinanciare |
| 3.1.1 | Institucione të tjera financiare | 9.2 | Në valutë |
| 3.1.2 | Bankat Para Depozituese | 9.2.1 | Individët |
| 3.2 | Në valutë | 9.2.2 | Korporatat e tjera jofinanciare |
| 3.2.1 | Institucione të tjera financiare | 10 | Depozita të papërfshira në paranë e gjerë |
| 3.2.2 | Bankat Para Depozituese | 10.1 | Në lekë |
| 4 | Depozita të tjera | 10.1.1 | Individët |
| 4.1 | Në lekë | 10.1.2 | Korporatat e tjera jofinanciare |
| 4.1.1 | Institucione të tjera financiare | 10.2 | Në valutë |
| 4.1.2 | Bankat Para Depozituese | 10.2.1 | Individët |
| 4.2 | Në valutë | 10.2.2 | Korporatat e tjera jofinanciare |
| 4.2.1 | Institucione të tjera financiare | 11 | Huatë |
| 4.2.2 | Bankat Para Depozituese | 11.1 | <i>Institucione të tjera jofinanciare</i> |
| 5 | Letra me vlerë | 11.2 | <i>Bankat Para Depozituese</i> |
| 5.1 | Jorezidentët | 11.3 | Qeveria |
| 5.2 | Qeveria Shqiptare | 12 | Llogari të pagueshme |
| 6. | Huatë | 13 | Llogaritë Kapitale |
| 6.1 | Individët | | |
| 6.2 | Korporatat e tjera jofinanciare | | |
| 7 | Mjete të tjera | | |
| 8 | Mjete jofinanciare | | |

Tabelë. 3 Bilanci Sektorial i Shoqërive të Kursim –Kreditit.

1. Monedha dhe kartëmonedha në lekë, përfshijnë gjendjen e arkës së Shoqërive të Kursim -Kreditit në monedhë vendase.
2. Monedha dhe kartëmonedha në valutë, përfshijnë gjendjen e arkës në valutë të konvertuar me kursin zyrtar të ditës së fundit të punës së muajit.
3. Depozita të transferueshme, përfshijnë llogaritë rrjedhëse të Shoqërive të Kursim – Kreditit në Banka (Bankat Para Depozituese) dhe në Unionet e Shoqërive të Kursim – Kreditit (Institucione të tjera financiare).
4. Depozita të tjera, përfshijnë depozitat me afat në banka dhe në unione, si dhe depozitat e bllokuara pranë unionit të SHKK-ve.

5. Letrat me vlerë, përfshijnë investimet në letra me vlerë të SHKK-ve.
6. Huatë, janë kreditë që shoqëritë e kursim – kreditit u japin anëtarëve të tyre.
7. Mjete të tjera, përfshijnë mjete të tjera të bilancit kontabël të SHKK-ve të paklasifikuara në kategoritë e mësipërme.
8. Mjete jofinanciare, përfshijnë mjetet e qëndrueshme të SHKK-ve dhe llogaritë e inventarëve.
9. Depozita të tjera të përfshira në paranë e gjerë, përfshijnë depozitat me afat me interes dhe pa interes të anëtarëve të SHKK-ve.
10. Huatë përfshijnë huatë e marra të SHKK-ve nga unionet e SHKK-ve (institucione të tjera financiare), nga bankat dhe nga qeveria.
11. Depozitat e papërfshira në paranë e gjerë, përfshijnë depozitat e bllokuara si garanci për huatë e anëtarëve të SHKK-ve.
12. Llogari të pagueshme, përfshijnë të gjitha detyrimet e tjera të paklasifikuara më lart, si dhe provigjonet për huatë me probleme.
13. Llogaritë kapitale përfshijnë kapitalin e paguar, fondet e donatorëve, rezervat e krijuara, provigjonet e përgjithshme për huatë standarde, fitimin e pashpërndarë dhe llogaritë e fitim/ humbjeve.

Aneks 4: Bilanci Sektorial – Korporatat e Tjera Depozituese

Sektori i Korporatave të Tjera Depozituese në Shqipëri përbëhet nga Shoqëritë e Kursim – Kreditit dhe nga Bankat e nivelit të dytë.

Bilanci sektorial përftohet nga agregimi i zërave korrespondues të bilanceve sektorialë të Bankave Para Depozituese dhe Shoqërive të Kursim – Kreditit.

| | Aktivi | | Pasivi |
|-------|--|----------|--|
| 1 | Monedha dhe kartëmonedha në lekë | 10 | Depozita të të përfshira në paranë e gjerë |
| 2 | Monedha dhe kartëmonedha në valutë | 10.1 | Depozita të transferueshme |
| 3 | Depozita të transferueshme | 10.1.1 | <i>Në lekë</i> |
| 3.1 | <i>Në lekë</i> | 10.1.1.1 | Institucione të tjera financiare |
| 3.1.1 | Jorzidentët | 10.1.1.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 3.1.2 | Banka e Shqipërisë | 10.1.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 3.1.3 | Korporatat e tjera depozituese | 10.1.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 3.2 | <i>Në valutë</i> | 10.1.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 3.2.1 | Jorzidentët | 10.1.2 | <i>Në valutë</i> |
| 3.2.2 | Banka e Shqipërisë | 10.1.2.1 | Institucione të tjera financiare |
| 3.2.3 | Korporatat e tjera depozituese | 10.1.2.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 4 | Depozita të tjera | 10.1.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 4.1 | <i>Në lekë</i> | 10.1.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 4.1.1 | Jorzidentët | 10.1.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 4.1.2 | Banka e Shqipërisë | 10.2 | Depozita të tjera |
| 4.1.3 | Korporatat e tjera depozituese | 10.2.1 | <i>Në lekë</i> |
| 4.2 | <i>Në valutë</i> | 10.2.1.1 | Institucione të tjera financiare |
| 4.2.1 | Jorzidentët | 10.2.1.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 4.2.2 | Banka e Shqipërisë | 10.2.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 4.2.3 | Korporatat e tjera depozituese | 10.2.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 5 | Letra me vlerë | 10.2.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 5.1 | Jorzidentët | 10.2.2 | <i>Në valutë</i> |
| 5.2 | Qeveria Shqiptare | 10.2.2.1 | Institucione të tjera financiare |
| 6 | Huatë | 10.2.2.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 6.1 | Jorzidentët | 10.2.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 6.2 | Banka e Shqipërisë | 10.2.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 6.3 | Korporatat e tjera depozituese | 10.2.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 6.4 | <i>Institucione jodepozituese financiare</i> | 11 | Depozita të papërfshira në paranë e gjerë |
| 6.5 | Qeveria Qendrore | 11.1 | Depozita të transferueshme |
| 6.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike | 11.1.1 | <i>Në lekë</i> |
| 6.7 | Korporata jofinanciare publike | 11.1.1.1 | Jorzidentët |
| 6.8 | Korporata të tjera jofinanciare | 11.1.1.2 | Banka e Shqipërisë |
| 6.9 | Sektorë të tjerë rezidentë | 11.1.1.3 | Korporatat e tjera depozituese |
| 7 | Aksionet dhe kapitali tjetër | 11.1.1.4 | Qeveria Qendrore |
| 8 | Mjete të tjera financiare | 11.1.2 | <i>Në valutë</i> |
| 9 | Mjete jofinanciare | 11.1.2.1 | Jorzidentët |
| | | 11.1.2.2 | Banka e Shqipërisë |
| | | 11.1.2.3 | Korporatat e tjera depozituese |
| | | 11.1.2.4 | Qeveria Qendrore |
| | | 11.2 | Depozita të tjera |

| | | |
|--|----------|---|
| | 11.2.1 | <i>Në lekë</i> |
| | 11.2.1.1 | Jorzidentët |
| | 11.2.1.2 | Banka e Shqipërisë |
| | 11.2.1.3 | Korporatat e tjera depozituese |
| | 11.2.1.4 | Institucione të tjera financiare |
| | 11.2.1.5 | Qeveria Qendrore |
| | 11.2.1.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike |
| | 11.2.1.7 | Korporata jofinanciare publike |
| | 11.2.1.8 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 11.2.1.9 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 11.2.2 | <i>Në valutë</i> |
| | 11.2.2.1 | Jorzidentët |
| | 11.2.2.2 | Banka e Shqipërisë |
| | 11.2.2.3 | Korporatat e tjera depozituese |
| | 11.2.2.4 | Institucione të tjera financiare |
| | 11.2.2.5 | Qeveria Qendrore |
| | 11.2.2.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| | 11.2.2.7 | Korporata jofinanciare publike |
| | 11.2.2.8 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 11.2.2.9 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 12 | Huatë |
| | 12.1 | Jorzidentët |
| | 12.2 | Banka e Shqipërisë |
| | 12.3 | Korporatat e tjera depozituese |
| | 12.4 | Institucione të tjera financiare |
| | 12.5 | Qeveria Qendrore |
| | 12.6 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| | 12.7 | Korporata jofinanciare publike |
| | 12.8 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 12.9 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 13 | Llogari të pagueshme |
| | 14 | Llogaritë kapitale |
| | | |

Tabelë 4. Bilanci Sektorial i Korporatave të tjera depozituese.

Në Bilancin sektorial të Korporatave të Tjera Depozituese nuk bëhet asnjë konsolidim i llogarive të Shoqërive të Kursim – Kreditit me Bankat Para Depozituese, por ndryshon emërtesa në “Korporata të Tjera Depozituese” nga “Shoqëri të Kursim – Kreditit” dhe Banka Para Depozituese.

Aneks 5: Paraqitja e Bankës së Shqipërisë.

Paraqitja e Bankës së Shqipërisë përfitohet nga konsolidimi i zërave të Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë dhe paraqitet kryesisht në këto zëra:

| | | | |
|---------|--|---------|--|
| 1 | Mjete Valutare Neto | 3 | Baza Monetare |
| 1.1 | Të drejta ndaj jorezidentëve | 3.1 | Paraja në qarkullim |
| 1.1.1 | Ari monetar dhe SDR | 3.2 | Detyrime ndaj korporatave të tjera depozituese |
| 1.1.2 | Monedha dhe kartëmonedha në valutë | 3.2.1 | Depozita të transferueshme |
| 1.1.3 | Depozita | 3.2.2 | Depozita të tjera |
| 1.1.4 | Letra me vlerë të jorezidentëve | 3.3 | Depozita të përfshira në paranë e gjerë |
| 1.1.5 | Llogari të tjera | 3.3.1 | Depozita të transferueshme në lekë |
| 1.2 | Minus Detyrime të jorezidentëve | 3.3.1.1 | Individët |
| 1.2.1 | Depozita | 3.3.1.2 | Institucione të tjera financiare |
| 1.2.2 | Hua | 4 | Depozita të papërfshira në paranë e gjerë |
| 1.2.3 | Llogari të tjera | 4.1 | Institucione të tjera financiare |
| 2 | Mjetet e brendshme | 4.2 | Njësi jofinanciare publike |
| 2.1 | Pretendimet neto ndaj qeverisë shqiptare | 4.3 | Njësi të tjera jofinanciare |
| 2.1.1 | Të drejta ndaj qeverisë qendrore | 5 | Huatë |
| 2.1.1.1 | Letra me vlerë | 5.1 | Korporata e tjera Depozituese |
| 2.1.1.2 | Hua | 6 | Llogari të pagueshme |
| 2.1.1.3 | Llogari të tjera | 6.1 | Institucione të tjera financiare |
| 2.1.2 | Minus: Detyrime ndaj qeverisë | 6.2 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.1.2.1 | Depozita | 6.3 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.1.2.2 | Llogari të tjera | 6.4 | Individët |
| 2.2 | Pretendime ndaj Korporatave të tjera Depozituese | 6.5 | Korporatat e tjera Depozituese |
| 2.2.1 | Depozita | 7 | Të tjera neto |
| 2.2.2 | Hua | 7.1 | Detyrime të tjera |
| 2.2.3 | Llogari të tjera | 7.2 | Minus Mjete të tjera |
| 2.3 | Pretendime ndaj individëve | 8 | Llogaritë kapitale |
| 2.4 | Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare | | |
| 2.5 | Pretendime ndaj Korporatave publike jofinanciare | | |
| 2.6 | Pretendime ndaj Korporatave të tjera jofinanciare | | |

Tabelë 5. Paraqitja e Bankës së Shqipërisë.

1. Mjetet Valutore Neto llogariten si diferencë e të gjitha mjeteve valutore (zërat e Bilancit Sektorial në lidhje me jorzidentët) me të gjitha detyrimet valutore.
2. Mjetet e brendshme përbëhen nga:
 - 2.1. Pretendimet Neto ndaj Qeverisë të cilat llogariten si diferencë e të gjitha pretendimeve ndaj qeverisë (zërat e Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë në lidhje me qeverinë) me detyrimet ndaj qeverisë.
 - 2.2. Pretendimet ndaj Korporatave të tjera Depozituese grupojnë të gjitha zërat e Bilancit Sektorial që përfaqësojnë pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj Bankave Para Depozituese.
 - 2.3. Pretendime ndaj individëve.
 - 2.4. Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare.
 - 2.5. Pretendime ndaj Korporatave publike jofinanciare.
 - 2.6. Pretendime ndaj Korporatave të tjera jofinanciare.

Zërat 2.3 deri në 2.6 të Paraqitjes së Bankës së Shqipërisë përmbajnë pretendimet e Bankës së Shqipërisë në formën e huave dhe të llogarive të arkëtueshme, përkatësisht për çdo sektor.

3. Baza Monetare përbëhet nga:
 - Paraja në qarkullim (shiko zëri 9 i Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë).
 - Detyrimet e Bankës së Shqipërisë ndaj Korporatave të tjera Depozituese si depozita e transferueshme dhe depozitat e tjera.
 - Depozitat e përfshira në paranë e gjerë si depozitat e transferueshme në lekë të sektorëve rezidentë jobankarë përjashtuar Qeverinë Qendrore.
4. Depozitat e papërfshira në paranë e gjerë përfshijnë llogaritë e tjera pranë Bankës së Shqipërisë të sektorëve rezidentë jobankarë përjashtuar Qeverinë Qendrore. (Shiko zëri 11 i Bilancit sektorial të Bankës së Shqipërisë).
5. Huatë janë llogaritur si zëri 12 i Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë duke përjashtuar huatë nga Jorzidentët.
6. Llogaritë e pagueshme janë llogaritur si zëri 13 i Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë duke përjashtuar detyrimet e tjera të Jorzidentëve dhe të Qeverisë Qendrore.
7. Të Tjera Neto llogaritet si diferencë e zërit Llogari të pagueshme/ Të tjera (zëri 13.8 i Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë) me Mjete Jofinanciare dhe Llogari të tjera për t'u marrë/ Të tjera (zëri 7.8 i Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë).
8. Llogaritë kapitale janë zëri 14 i Bilancit Sektorial të Bankës së Shqipërisë.

Aneks 6: Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese.

Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese përftohet nga riklasifikimi i zërave të Bilancit Sektorial të Korporatave Depozituese dhe paraqitet kryesisht në këtë formë:

| | | | |
|---------|--|---------|---|
| 1 | Mjetet Valutore Neto | 3 | Detyrime ndaj Bankës Qendrore |
| 1.1 | Të drejta ndaj Jorezidentëve | 3.1 | Depozita |
| 1.1.1 | Monedha dhe Kartëmonedha në Valutë | 3.2 | Hua |
| 1.1.2 | Depozita | 4 | Depozita të përfshira në parinë e gjerë |
| 1.1.3 | Letra me vlerë | 4.1 | Depozita të transferueshme |
| | | 4.1.1 | Në lekë |
| 1.1.4 | Hua | 4.1.1.1 | Institucione të tjera financiare |
| 1.2 | Minus Detyrime ndaj Jorezidentëve | 4.1.1.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 1.2.1 | Depozita | 4.1.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 1.2.2 | Hua | 4.1.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2 | Mjetet e Brendshme | 4.1.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.1 | Pretendime ndaj Bankës së Shqipërisë | 4.1.2 | Në valutë |
| 2.1.1 | Monedha dhe kartëmonedha në lekë | 4.1.2.1 | Institucione të tjera financiare |
| 2.1.2 | Depozita | 4.1.2.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 2.1.3 | Hua | 4.1.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.2 | Pretendimet Neto ndaj Qeverisë | 4.1.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.2.1 | Pretendimet ndaj Qeverisë | 4.1.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.2.1.1 | Letra me vlerë | 4.2 | Depozita të tjera |
| 2.2.1.2 | Hua | 4.2.1 | Në lekë |
| 2.2.1.3 | Llogari të tjera | 4.2.1.1 | Institucione të tjera financiare |
| | | 4.2.1.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 2.2.2 | Detyrimet ndaj Qeverisë | 4.2.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.2.2.1 | Depozita | 4.2.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.2.2.2 | Hua | 4.2.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.2.2.3 | Llogari të tjera | 4.2.2 | Në valutë |
| 2.3 | Pretendime ndaj Institucioneve të tjera financiare | 4.2.2.1 | Institucione të tjera financiare |
| 2.4 | Pretendimet ndaj Qeverisë Lokale dhe Administratës Publike | 4.2.2.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| 2.5 | Pretendimet ndaj Korporatave jofinanciare Publike | 4.2.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.6 | Pretendimet ndaj Korporatave të tjera jofinanciare | 4.2.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.7 | Pretendime ndaj Sektorëve të tjerë Rezidentë | 4.2.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | | 5 | Depozita të papërfshira në parinë e gjerë |
| | | 5.1 | Institucione të tjera financiare |
| | | 5.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |
| | | 5.3 | Korporata jofinanciare publike |
| | | 5.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | | 5.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | | 6 | Huatë |
| | | 6.1 | Institucione të tjera financiare |
| | | 6.2 | Qeveria Lokale dhe Administrata publike |

| | | |
|--|-----|---------------------------------|
| | 6.3 | Korporata jofinanciare publike |
| | 6.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | 6.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | 7 | Llogaritë kapitale |
| | 8 | Detyrime të tjera neto |
| | 8.1 | Detyrime të tjera |
| | 8.2 | Minus Mjete të tjera |
| | 9 | Axhustimi i konsolidimit |
| | | |
| | | |

Tabelë 6. Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese.

1. Mjetet Valutore neto llogariten si diferencë e:
 - 1.1 Pretendimeve ndaj Jorezidentëve – që përfaqësojnë të gjitha pretendimet e korporatave të tjera depozituese ndaj Jorezidentëve, dhe
 - 1.2 Detyrimeve ndaj Jorezidentëve.
2. Mjetet e Brendshme përbëhen nga:
 - 2.1 Pretendimet ndaj bankës qendrore, që përfshijnë monedhat dhe kartëmonedhat në lekë, depozitat pranë bankës qendrore dhe huatë.
 - 2.2 Pretendimet neto ndaj qeverisë llogariten si diferencë e Pretendimeve të Qeverisë (ose zërave të Aktivit të Bilancit Sektorial në lidhje me Qeverinë) me Detyrimet ndaj qeverisë (ose zërat e Pasivit të Bilancit Sektorial në lidhje me Qeverinë).
 - 2.3 Pretendimet (huatë) ndaj institucioneve të tjera financiare.
 - 2.4 Pretendimet (huatë) ndaj Korporatave jofinanciare publike – zëri 6.7 i Bilancit Sektorial.
 - 2.5 Pretendimet ndaj Korporatave të tjera jofinanciare – zëri 6.8 i Bilancit Sektorial.
 - 2.6 Pretendimet ndaj Sektorëve të tjerë rezidentë – zëri 6.9 i Bilancit Sektorial.
 - 2.7 Pretendimet ndaj Qeverisë Lokale dhe Administratës Publike – zëri 6.6 i Bilancit Sektorial.
3. Detyrime ndaj Bankës Qendrore përfshijnë detyrimet në formën e depozitave (zërat 11.1.1.2; 11.1.2.2; 11.2.1.2; 11.2.2.2 të Bilancit Sektorial të Korporatave të tjera Depozituese) dhe huave (zëri 12.2 i Bilancit Sektorial).
4. Depozitat e përfshira në paranë e gjerë përbëhen nga:
 - 4.1 Depozita të transferueshme në lekë dhe në valutë, të përfshira në paranë e gjerë të sektorëve mbajtës të parasë së gjerë ose ndryshe zëri 10.1 i Bilancit sektorial të Korporatave të Tjera Depozituese.

- 4.2 Depozita të tjera në lekë dhe valutë të përfshira në paranë e gjerë të sektorëve mbajtës të parasë së gjerë ose ndryshe zëri 10.2 i Bilancit sektorial të Korporatave Depozituese. Në këtë grup, brenda çdo sektori duhen identifikuar veçmas depozitat pa afat të rezidentëve në lekë, me qëllim që të mundësohet leximi i Agregatit M1.
5. Depozita të tjera të papërfshira në paranë e gjerë të sektorëve mbajtës të parasë së gjerë (shiko zëri 11 i Bilancit sektorial të Korporatave Depozituese).
6. Huatë llogariten si zëri 12 i Bilancit Sektorial pa përfshirë huatë nga Jorezidentët, nga Qeveria, nga Korporatat e Tjera Depozituese dhe nga Banka Qendrore.
7. Llogaritë kapitale janë zëri 15 i Bilancit Sektorial të Korporatave të Tjera Depozituese.
8. Detyrime të tjera neto llogariten si diferencë e zërave të mbetur të pasivit me llogaritë e arkëtueshme dhe mjetet jofinanciare.
9. Axhustimi i konsolidimit përftohet nga netimi i llogarive ndërmjet Korporatave të Tjera Depozituese

Aneks 7 : Paraqitja e Korporatave Depozituese.

Paraqitja e Korporatave Depozituese ka kryesisht formën e treguar në tabelën 7 dhe përftohet nga konsolidimi i Paraqitjes së Bankës së Shqipërisë dhe Paraqitjes së Korporatave të Tjera Depozituese.

| | | | |
|---------|---|---------|---|
| 1 | Mjete Valutore Neto | 3 | Detyrimet e Parasë së Gjerë |
| 1.1 | Të drejta ndaj jorezidentëve | 3.1 | Paraja jashtë Bankave |
| 1.1.1 | Të drejta ndaj jorezidentëve-BSh | 3.2 | Depozita të transferueshme |
| 1.1.2 | Të drejta ndaj jorezidentëve-KTD | 3.2.1 | Në lekë |
| 1.2 | Minus Detyrime të jorezidentëve | 3.2.1.1 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike |
| 1.2.1 | Detyrime ndaj jorezidentëve-BSh | 3.2.1.2 | Institucione të tjera financiare |
| 1.2.2 | Detyrime ndaj jorezidentëve-KTD | 3.2.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2 | Mjetet e brendshme | 3.2.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.1 | Pretendimet neto ndaj Qeverisë Shqiptare | 3.2.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.1.1 | Të drejta ndaj qeverisë qendrore | 3.2.2 | Në valutë |
| 2.1.1.1 | Të drejta ndaj qeverisë qendrore-BSh | 3.2.2.1 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike |
| 2.1.1.2 | Të drejta ndaj qeverisë qendrore-KTD | 3.2.2.2 | Institucione të tjera financiare |
| 2.1.2 | Minus: Detyrime ndaj qeverisë | 3.2.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.1.2.1 | Detyrime ndaj qeverisë-BSh | 3.2.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.1.2.2 | Detyrime ndaj qeverisë-KTD | 3.2.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.2 | Pretendime ndaj Sektorëve të tjerë | 3.3 | Depozita të tjera |
| 2.2.1 | Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare | 3.3.1 | Në lekë |
| | | 3.3.1.1 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike |
| 2.2.1.1 | Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare-BSh | 3.3.1.2 | Institucione të tjera financiare |
| 2.2.1.2 | Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare-KTD | 3.3.1.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.2.2 | Pretendime ndaj Qeverisë Lokale dhe Administratës Publike | 3.3.1.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.2.2.1 | Pretendime ndaj Qeverisë Lokale dhe Administratës Publike-BSh | 3.3.1.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.2.2.2 | Pretendime ndaj Qeverisë Lokale dhe Administratës Publike-KTD | 3.3.2 | Depozita në valutë |
| 2.2.3 | Pretendime ndaj Korporatave publike jofinanciare | 3.3.2.1 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike |
| 2.2.3.1 | Pretendime ndaj Korporatave publike jofinanciare-BSh | 3.3.2.2 | Institucione të tjera financiare |
| 2.2.3.2 | Pretendime ndaj Korporatave publike jofinanciare-KTD | 3.3.2.3 | Korporata jofinanciare publike |
| 2.2.4 | Pretendime ndaj Korporatave të tjera jofinanciare | 3.3.2.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| 2.2.4.1 | Pretendime ndaj Korporatave të tjera jofinanciare-BSh | 3.3.2.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| 2.2.4.2 | Pretendime ndaj Korporatave të tjera jofinanciare-KTD | 4 | Depozita të papërfshira në parinë e gjerë |
| 2.2.5 | Pretendime ndaj Sektorëve të tjerë | 4.1 | Qeveria Lokale dhe Administrata |

| | | | |
|---------|--|-----|---|
| | rezidentë | | Publike |
| 2.2.5.1 | Pretendime ndaj Sektorëve të tjerë rezidentë-BSh | 4.2 | Institucione të tjera financiare |
| 2.2.5.2 | Pretendime ndaj Sektorëve të tjerë rezidentë-KTD | 4.3 | Korporata jofinanciare publike |
| | | 4.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | | 4.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | | 5 | Huatë |
| | | 5.1 | Qeveria Lokale dhe Administrata Publike |
| | | 5.2 | Institucione të tjera financiare |
| | | 5.3 | Korporata jofinanciare publike |
| | | 5.4 | Korporata të tjera jofinanciare |
| | | 5.5 | Sektorë të tjerë rezidentë |
| | | 6 | Llogaritë kapitale |
| | | 7 | Të tjera neto |
| | | 7.1 | Detyrime të tjera |
| | | 7.2 | Minus: Mjete të tjera |
| | | 7.3 | Axhustimi i konsolidimit |
| | | | |

Mjete Valutore Neto përftohen nga diferenca e:

Mjeteve Valutore – që llogariten si shumë e mjeteve Valutore të Korporatave të Tjera Depozituese dhe Mjeteve Valutore të Bankës Qendrore.

Detyrimeve Valutore – që llogariten si shumë e Detyrimeve Valutore të Korporatave të Tjera Depozituese dhe Detyrimet Valutore të Bankës Qendrore.

Mjetet e Brendshme llogariten si:

Pretendimet ndaj Qeverisë Neto, që llogariten si diferencë e shumës së Pretendimeve ndaj qeverisë së Korporatave të Tjera Depozituese dhe Bankës Qendrore me shumën e Detyrimeve ndaj qeverisë së Korporatave të Tjera Depozituese dhe Bankës Qendrore.

Pretendimet ndaj sektorëve të tjerë të ekonomisë si:

Institucioneve të tjera financiare;

Qeverisë lokale dhe Administratës publike;

Pretendime ndaj Korporatave publike jofinanciare;

Pretendime ndaj Korporatave të tjera jofinanciare;

Pretendime ndaj Sektorëve të tjerë rezidentë;

Detyrimet e Parasë së Gjerë përbëhen nga:

Paraja jashtë bankave që llogaritet si diferencë e parasë në qarkullim (BSh) dhe komponentit Monedha dhe Kartëmonedha në lekë të rezervës monetare tek Paraqitja e Korporatave të Tjera Depozituese.

Depozita të transferueshme në lekë, pjesë e parasë së gjerë të sektorëve mbajtës të parasë, që përftohet nga agregimi i të njëjtëve zëra në Paraqitjen e Bankës Qendrore dhe në paraqitjen e Korporatave të Tjera Depozituese.

Depozita të tjera në lekë, pjesë e parasë së gjerë të sektorëve mbajtës të parasë, që janë të njëjtët zëra në Paraqitjen e Korporatave të Tjera Depozituese.

Depozita në valutë pjesë e parasë së gjerë të sektorëve mbajtës të parasë që janë të njëjtët zëra në Paraqitjen e të Korporatave të Tjera Depozituese.

Depozita të papërfshira në paranë e gjerë të sektorëve mbajtës të parasë që përftohet nga agregimi i të njëjtëve zëra në Paraqitjen e Bankës Qendrore dhe në Paraqitjen e Korporatave të Tjera Depozituese.

Huatë që përftohen nga agregimi i zërave të njëjtë në Paraqitjen e Bankës Qendrore dhe në Paraqitjen e Korporatave të Tjera Depozituese.

Llogari të pagueshme përftohen nga agregimi i zërave të njëjtë në Paraqitjen e Bankës Qendrore dhe në Paraqitjen e Korporatave të Tjera Depozituese.

Llogaritë Kapitale përftohen duke agreguar Llogaritë Kapitale të Korporatave të Tjera Depozituese dhe Llogaritë Kapitale të Bankës Qendrore.

Të tjera neto llogariten si Detyrime të tjera të Bankës së Shqipërisë dhe të Korporatave të tjera Depozituese me mjetet e tjera të Bankës së Shqipërisë dhe të Korporatave të tjera Depozituese.

Axhustimi i konsolidimit llogaritet si diferencë e shumës së mjeteve të Bankës së Shqipërisë ndaj Korporatave të Tjera Depozituese dhe mjeteve të Korporatave të tjera Depozituese ndaj Bankës së Shqipërisë me shumën e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj Korporatave të Tjera Depozituese dhe të Korporatave të Tjera Depozituese ndaj Bankës së Shqipërisë.

Literatura:

- IMF, *Monetary and Financial Statistics Manual – Washington DC, USA: International Monetary Fund, © 2000.*
- IMF, *Manual on Monetary and Financial Statistics, Revised Draft – STA/IMF, October 1997.*
- Banka e Shqipërisë, *Manuali Kontabilitetit Bankar, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të RSh, Nr.820, datë 30.12.1998, përgatitur nga Ernst & Young, Projekt i financuar nga Komuniteti Europian. Botuar nga Banka e Shqipërisë.*
- Banka e Shqipërisë, *Banka e Shqipërisë Manuali Kontabël, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të RSh, Nr.50, datë 26.01.2001, përgatitur nga I.Buharaja Departamenti i Kontabilitetit të Bankës së Shqipërisë.*
- Rregullore mbi kredinë njëditore, *Banka e Shqipërisë, Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.08, datë 07.02.2001.*
- Rregullore mbi kredinë lombard, *Banka e Shqipërisë, Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.08, dateë 07.02.2001.*
- IMF, *Albania: Report on Money and Banking Statistics Mission, November 24, 1999. Confidential.*
- IMF, *Government Finance Statistics Manual 2001/ Statistics Department [2nd ed.], International Monetary Fund, 2001.*
- Seminar on Monetary and Financial Statistics, *R. Krueger, J Kucera, JVI, Vienna, August, 2002.*
- Kuvendi Popullor, *Ligj Nr. 8782, date 3.5.2001, “Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit”.*
- Kuvendi Popullor, *Ligji për Bankën e Shqipërisë, Nr. 8269, datë 23.12.1997.*
- Kuvendi Popullor, *Ligji për Bankat në Republikën e Shqipërisë, Nr. 8365, date 2.7.1998.*